Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 3 (83). MARS 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394



Mësuesi i mijëra mësuesve

Lidhja e Intelektualëve Dibranë organizon me rastin e 7 Marsit, një pasdite festive kushtuar Mësuesit të Popullit, Prof.dr. Nuri Abdiu

Me datën 7 mars 2013 pasdite, në Hotel Tirana International, shoqata e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, organizoi një pasdite festive, me rastin e festës së mësuesit, kushtuar "Mësuesit të Popullit", Prof . Nuri Abdiu. Kishin ardhur në këtë evinement të rëndësishëm miq e shokë të Profesor Nuriut, kolegë e ish-studentë të tij, arsimtarë e veteranë të arsimit.

Sekretari i përgjithshëm i shoqatës LID, zoti Shpëtim Cami, në fjalën e hapjes përshëndeti të pranishmit, prezantoi qëllimin e këtij aktiviteti dhe uroi profesorin jo vetëm për 7 Marsin, Ditën e Mësuesit, por edhe për përvjetorin e lindjes së tij.

Mbi jetën dhe veprimtarinë e Prof. Nuri Abdiut ndër vite foli Prof.dr.Edlira Haxhiymeri. "Nuk e kisha aspak të lehtë, - tha ajo - të qëmtoja e të radhisja këto fjalë zemre, që edhe kështu mund të jenë të varfëra përpara jetës dhe kontributit të Prof. Nuriut. Jeta e tij tepër aktive, kontributet e vyera, personaliteti i tij shumëdimensional, rrethi i gjërë i bashkëpunëtorëve, numri i madh i studentëve, fisi i madh dhe lidhjet e shumëfishta për arësye njerëzore, e bëjnë figurën e profesor Nuriut të dëshirueshme për ta hulumtuar, por edhe të vështirë për ta prezantuar në një mbrëmje si kjo".

(Vijon në faqen 11)

Peticioni për Rrugën e Arbërit

FIRMOSIN MBI 1000 QYTETARË



INTERVISTË ME GËZIM ALPION, NISMËTARIN E PETICIONIT ONLINE QË I KËRKON QEVERISË QË DO DALË PAS ZGJEDHJEVE TË QERSHORIT, NDËRTIMIN SA MË SHPEJT DHE ME STANDARDE TË RRUGËS SË ARBËRIT

TË GJITHË SHQIPTARËT JANË DIBRANË

Dibra më në fund flet: mbi një mijë shqiptarë dhe të huaj, nga të katër anët e globit nënshkruajnë peticionin për ndërtimin e Rrugës së Arbërit.

Krahina si Dibra janë zemra e Shqipërisë dhe, po qe se vazhdojmë t'i lëmë në prapambetje këta "zona të largëta" , siç ka ndodhur në historinë njëshekullore të shtetit shqiptar, atëherë kemi frenuar verbërisht zhvillimin e atdheut. Përpara se të shkojmë në Evropë, le të shkojmë në Dibër dhe krahina të tjera të Shqipërisë, dhe nuk e kam fjalën vetëm për rrugën.

Edhe me këtë peticion të thjeshtë Dibra po bën atë që ka bërë gjithmonë – bashkon Shqipërinë në një identitet të vetëm. Ky peticion ka tretur ndasitë krahinore, duke bërë të gjithë shqiptarët të jenë dibranë.

SPECIALE NE FAQE 2-3-4-5-6


Ne kemi një popull të mrekullueshëm dhe sa më shpejt që klasa politike ta kuptojë këtë dhe të vihet në shërbim të tij, aq më mirë do të jetë për të gjithë ne. Partitë politike shkojnë dhe vijnë, ndërsa Shqipëria dhe Dibra do të mbeten. Problemi është se çfarë Shqipërie dhe Dibre do t'u lëmë brezave të ardhshëm. Ky peticion është fillimi i përgjigjes së kësaj pyetje.

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 3 (83). 1 - 31 Mars 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë Faik Xhani, Haki Pernezha, Abdurahim Ashiku, Mustafa Tola, Islam Çenga, Dali Tërshalla, se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Gëzim ALPION
Edlira HAXHIYMERI
Shpetim Cami
Xhafer MARTINI
Tefta CAMI
Shemsi MANJANI
Fejzulla GJABRI
Abdurahim ASHIKU
Rexhep TORTE
Sakip CAMI
Destan RAMA
Ramadan NDREKA
Mevlud BUCI
Halil RAMA
Afrim KAROSHI
Zabit LLESHI
Ilmi DERVISHI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Peticioni për Rrugën e Arbërit

FIRMOSIN MBI 1000 QYTETARË

Peticioni do qëndrojë i hapur në faqen *Change.org* deri në zgjidhjen përfundimtare të ndërtimit të Rrugës së Arbërit. Firmos dhe shpërndaje te miqtë në rrjetet sociale. Së bashku do ta afrojmë ditën e përurimit të rrugës me standarde bashkëkohore

Që prej 18 marsit 2013, me nismën e profesorit të Universitetit të Birmingamit, dibranit Gëzim Alpion, në faqen e internetit "Change.org" është i hapur për të firmosur nga qytetarët një peticion, i cili do t'i dorëzohet qeverisë që do dalë pas zjedhjeve të 23 qershorit, për ndërtimin dhe përfundimin sa më shpejt të Rrugës së Arbërit, me cilësi dhe më standarde europiane.

Rruga e Arbërit është një projekt që po bëhen dy dekada që po përmendet çdo ditë, por është zvarritur pambarim.

Peticioni tashmë është nënshkruar mbi 1000 vetë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe nga një numër i madh vendesh ku është shtrirë diaspora shqiptare.

Peticioni është nënshkruar edhe nga numër akdemikësh të huaj me reputacion ndërkombëtar dhe qytetarë të thjeshtë dashamirës të kombit shqiptar.

Ky nuk është peticion politik dhe nuk do të përdoret nga asnjë forcë politike në Shqipëri për qëllime fushate. Peticioni përfaqëson zërin e dibranëve të thjeshtë, të cilët do t'i kërkojnë qeverisë që do të dalë nga zgjedhjet e qershorit përfundimin sa më shpejt dhe me standarde të Rrugës së Arbërit.

Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri.

Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale.

Rruga do përmirësoj ndjeshëm infrastrukturën midis Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe për pasojë do të jetë një korridor shumë i rëndësishëm komunikimi për një numër shtetesh në këtë pjesë të Ballkanit.

- **Dibranët janë njerëz me sedër, mikpritës, bestarë, fjalëpakë dhe tepër të zgjuar. Mbi të gjitha, dibranët nga natyra janë të duruar. Por edhe durimi i dibranëve ka një kufi.**
- **Dibranët kudo që janë të punojë në "mënyrë vullnetare" për Rrugën e Arbërit, të paktën një orë, të harxhojnë një orë duke u dërguar mesazhe personale miqve në rrjetet sociale. Le të sigurojë çdo dibran të paktën 10 nënshkrime për këtë peticion.**
- **Ky peticion nuk do të mbyllet në qershor; qershori do të jetë në fakt koha kur ky peticion do të fillojë në kuptimin e vërtetë të fjalës.**
- **Nënshkruesit e peticionit, si bashkëatdhetarët apo të huajt, në komentet e tyre me të drejtë theksojnë njëkohësisht rëndësinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit jo vetëm për Dibrën, por dhe për infrastrukturën në këtë rajon të Ballkanit.**
- **Ne kemi një popull të mrekullueshëm dhe sa më shpejt që klasa politike ta kuptojë këtë dhe të vihet në shërbim të tij, aq më mirë do të jetë për të gjithë ne. Partitë politike shkojnë dhe vijnë, ndërsa Shqipëria dhe Dibra do të mbeten. Problemi është se çfarë Shqipërie dhe Dibre do t'u lëmë brezave të ardhshëm. Ky peticion është fillimi i përgjigjes së kësaj pyetje.**

Ishte shumë vështirë të firmosnin njëqind të parët, u bë më e lehte të firmosnin pesëqind dhe po shumë e lehte të firmosnin njëmijë! Tani, të gjithë së bashku do ta kemi më të lehtë t'i shtojmë firmëtarët, sepse nuk bëhet fjalë për çështje personale, por për një çështje që na përket të gjithëve! Jo vetëm për të sotmen, por edhe për të shkuarën me ëndërra dhe për të ardhmen me shpresë.

Të gjithe ata që nuk e kanë shënuar emrin e tyre, mund ta bëjnë tani! Asnjëherë nuk është vonë. Sa më shumë që të bëhemi, aq më shumë do dëgjohet zëri yt.

B.KAROSHI

NDIQ HAPAT E MËPOSHTËME PËR TË FIRMOSUR SAKTË:

1 - KLIKO NË FAQEN E WEB SI MË POSHTË:
http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

2- Lart, djathtas shfaqen kuadratet bosh.
Shkruaj Emrin, Mbiemrin, Adresën e emailit dhe Qyetitn tuaj. Pastaj klikon "**Sign**".
Pas kësaj, ju do të merrni një mesazh falënderimi dhe konfirmimi që emri juaj u rregjistrua.


Për hollësi mund të vizitoni faqen e gazetës në Web: <**www.rrugaearberit.com**>
ose në Facebook <**facebook.com/gezim.alpion**> ose <**facebook.com/rruga.arberit**>

intervista

Ka ardhur koha që, të jesh krenar për Dibrën, nuk është e mjaftueshme. Si shumë krahina të tjera në veri dhe jug, Dibra kërkon me të drejtë që të mos lihet më në harresë. Por, për të bërë Dibrën në radhë të parë, duhet të lëvizim vetë ne dibranët.

Ky peticion është zëri i dibranëve të thjeshtë, të cilët janë të ndërgjegjshëm për vlerat unike njerëzore, historike dhe kulturore që Dibra përfaqëson në plan kombëtar.





Në foto: Gëzim Alpion (marrë nga facebook.com/gezim.alpion).
Sipër: Faqja e parë e peticionit në change.org në mesditën e datës 31 Mars 2013, ora: 12:00

INTERVISTË ME GËZIM ALPION, NISMËTARIN E PETICIONIT ONLINE QË I KËRKON QEVERISË QË DO DALË PAS ZGJEDHJEVE TË QERSHORIT, NDËRTIMIN SA MË SHPEJT DHE ME STANDARDE TË RRUGËS SË ARBËRIT

Të gjithë shqiptarët janë dibranë

Dibra më në fund flet: mbi një mijë shqiptarë dhe të huaj, nga të katër anët e globit nënshkruajnë peticionin për ndërtimin e Rrugës së Arbërit

- Prej gati dy javësh ju keni përcjellë për publikun një peticion mbi përfundimin e Rrugës së Arbërit, e cila do t'i dorëzohet qeverisë së ardhshme. Ky peticion deri më tani ka marrë një numër të konsiderueshëm nënshkrimesh, gjë që tregoi se Ju keni prekur një çështje të ndjeshme për njerëzit. Si lindi ideja e peticionit?

Zvarritja e ndërtimit të Rrugës së Arbërit ka vite që më shqetëson si dibran. Rruga është një çështje që unë e diskutoj sa herë që kthehem në Shqipëri, veçanërisht me intelektualët dibranë në Tiranë.

Jam treguar i përmbajtur, që të mos komentoj në media për këtë çështje, me shpresë se, me gjithë vonesat, rruga do të përfundohej. Po ashtu, në një farë mënyre, nuk kam dashur që shqetësimi im të keqkuptohet apo më saktë, të keqinterpretohet, si përpjekje për të "mbajtur anën" e krahinës time. Por, siç thonë anglezët, "bamirësia fillon në shtëpi" (charity begins at home), dhe Dibra është "shtëpia" ime.

Për herë të parë e kam shprehur publikisht shqetësimin për vonesat në ndërtimin në kohë të Rrugës së Arbërit në korrik të vitit 2012, kur u ndala në këtë temë gjatë intervistës televizive në studio me z. Roland Qafoku.

Dibranët janë njerëz me sedër, mikëpritës, bestarë, fjalëpakë dhe tepër të zgjuar. Mbi të gjitha, dibranët nga natyra janë të duruar. Por edhe durimi i dibranëve ka një kufi.

Ne dibranët kemi një lidhje shpirtërore me Dibrën, që është e një natyre mitologjike. Si shumë dibranë të tjerë që janë larguar nga Dibra apo Shqipëria, edhe unë Dibrën e kam marrë me vete që kur u largova nga Peshkopia në moshën 14 vjeç për të studiuar në Tiranë. Në Peshkopi kam kaluar një fëmijëri të mrekullueshme dhe, në një farë mënyre, fëmijëria është atdheu.

Megjithatë, ka ardhur koha që, të jesh krenar për Dibrën, nuk është e mjaftueshme. Si shumë krahina të tjera në veri dhe jug, Dibra kërkon me të drejtë që të mos lihet më në harresë. Por për të bërë Dibrën në radhë të parë duhet të lëvizim vetë ne dibranët. Dhe për Dibrën mund të kontribohet jo vetëm duke jetuar në Dibër apo në Shqipëri.

Unë do t'ju bëja thirrje të gjithë dibranëve kudo që janë të punojë në "mënyrë vullnetare" për Rrugën e Arbërit të paktën një orë. Nuk them të shkojmë të punojmë fizikisht për ndërtimin e rrugës, por të harxhojmë një orë duke u dërguar mesazhe personale me Email, Facebook, Linkedin dhe Twitter miqve. Mesazhet personale janë gjithmonë të efektshme. Le të sigurojë çdo dibran të paktën 10 nënshkrime për këtë peticion.

Nënshkruesit e peticionit, si bashkëatdhetarët apo të huajt, në komentet e tyre me të drejtë theksojnë njëkohësisht rëndësinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit jo vetëm për Dibrën, por dhe për infrastrukturën në këtë rajon të Ballkanit.

Krahina si Dibra janë zemra e Shqipërisë dhe, po qe se vazhdojmë t'i lëmë në prapambetje këta "zona të largëta" , siç ka ndodhur në historinë njëshekullore të shtetit shqiptar, atëherë kemi frenuar verbërisht zhvillimin e atdheut. Përpara se të shkojmë në Evropë, le të shkojmë në Dibër dhe krahina të tjera të Shqipërisë, dhe nuk e kam fjalën vetëm për rrugën.

Edhe me këtë peticion të thjeshtë Dibra po bën atë që ka bërë gjithmonë – bashkon Shqipërinë në një identitet të vetëm. Ky peticion ka tretur ndasitë krahinore, duke bërë të gjithë shqiptarët të jenë dibranë.

Krahina si Dibra janë zemra e Shqipërisë dhe, po qe se vazhdojmë t'i lëmë në prapambetje këta "zona të largëta" (për një vend të vogël si Shqipëria, një shprehje e tillë nuk tregon distancë në kuptimin gjeografik, por prapambetje në zhvillim), siç ka ndodhur në historinë një shekullore të shtetit shqiptar, atëherë kemi frenuar verbërisht zhvillimin e atdheut. Përpara se të shkojmë në Evropë, le të shkojmë në Dibër dhe krahina të tjera të Shqipërisë, dhe nuk e kam fjalën vetëm për rrugën.

Dibra ka qenë gjithmonë e gatshme të sakrifikohet e para për çështjen kombëtare si në luftë kundër agresorëve turq e serb, ashtu edhe ndaj pushtuesve fashistë e nazistë. Po Dibra që gjithmonë ka dhënë, tani edhe duhet të kërkojë. Dibra dhe dibranët duhet të flasin dhe ky peticion është zëri i ne dibranëve të thjeshtë që jemi të ndërgjegjshëm për vlerat unike njerëzore, historike dhe kulturore që Dibra përfaqëson në plan kombëtar.

- Çfarë qëllimi ka dhe kujt i drejtohet?

Qëllimi i peticioni është që t'ia bëjë të qartë qeverisë së re që do të rezultojë nga zgjedhjet në qershor të këtij viti se Dibra do ta kërkojë me ngulm përfundimin e Rrugës së Arbërit.

Ky peticion nuk do të mbyllet në qershor; qershori do të jetë, në fakt, koha kur ky peticion do të fillojë në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Unë do të jem i angazhuar me peticionin derisa të inagurohet rruga Peshkopi-Tiranë. Në këtë drejtim nuk do të ketë kompromis. Ky është edhe mendimi i dhjetëra e qindra dibranëve që unë njoh personalisht apo që nuk i kam takuar ndonjëherë, të cilët më shkruajnë çdo ditë për të ndarë mendimet e tyre me mua.

Peticioni nuk ka natyrë politike. Unë, personalisht, nuk kam qenë kurrë dhe nuk jam i aderuar në ndonjë parti politike në Shqipëri. Peticioni nuk do të përdoret nga asnjë forcë politike. Se si do të votojnë dibranët në qershor, ajo është mes tyre dhe ndërgjegjes së tyre.

- Nga mesazhet që merrni nga nënshkruesit, cila është përshtypja juaj mbi efektin që po jep peticioni në publik?

Mesazhet e shumta që kam marrë këto ditë nga miq dhe shokë jo vetëm bashkëkombas, por edhe të huaj më kanë prekur shumë. Po ju përmend vetëm dy mesazhe: një mik i vjetër nga Gjirokastra më shkroi se do ta nënshkruajë peticionin "pasi jam shqiptar dhe e di mirë se nuk ka vetëm Shqipëri të Veriut dhe të Jugut, por edhe Dibër të Shqipërisë!"; ndërsa një mik i vjetër nga Berati më shkroi se nënshkrimin e peticionit e shikon si "detyrë".

Mesazhe përkrahëse kam marrë edhe nga miq dhe njerëz të panjohur nga Vlora, Shkodra, Gramshi, Prishtina, Tepelena, Puka, Mirdita, Tetova, Tirana, Lezha, Durrësi, Shkupi, Mitrovica, Kukësi, Dibra e Madhe, si dhe pothuajse nga të gjitha vendet ku është shtrirë diaspora shqiptare nga Australia në Amerikë, nga Emiratet e Bashkuara Arabe në Itali. Më ka bërë përshtypje edhe interesimi që një numër redaktorësh si në Tirane dhe diasporë kanë treguar që në fillim për peticionin.

Një numër mesazhesh kam marrë nga kolegë dhe akademikë të huaj nga India, Hollanda, Anglia dhe vende të tjera.

Nënshkruesit e peticionit, si bashkatdhetarët apo të huajt, në komentet e tyre me të drejtë theksojnë njëkohësisht rëndësinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit jo vetëm për Dibrën, por dhe për infrastrukturën në këtë rajon të Ballkanit.

Edhe me këtë peticion të thjeshtë, Dibra po bën atë që ka bërë gjithmonë – bashkon Shqipërinë në një identitet të vetëm. Ky peticion ka tretur ndasitë krahinore, duke bërë të gjithë shqiptarët të jenë dibranë.

Ne kemi një popull të mrekullueshëm dhe, sa më shpejt që klasa politike ta kuptojë këtë dhe të vihet në shërbim të tij, aq më mirë do të jetë për të gjithë ne. Partitë politike shkojnë dhe vijnë, ndërsa Shqipëria dhe Dibra do të mbeten. Problemi është se çfarë Shqipërie dhe Dibre do t'u lëmë brezave të ardhshëm. Ky peticion është fillimi i përgjigjes së kësaj pyetje.

Bisedoi: **BUJAR KAROSHI**

BIOGRAFI E SHKURTËR:

Gëzim Alpion u lind në Peshkopi më 10 tetor 1962. Ai ka një BA nga Universiteti i Kajros dhe Doktoratën nga Universiteti i Durhamit. Aktualisht është Sociolog në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Drejtor i Programeve të Kombinuara në Shkollën e Qeverisë dhe Shoqërisë në Universitetin e Birminghamit në Angli. Alpion është cilësuar nga kritika perëndimore si studiuesi më i mirë i Nënë Terezës në gjuhën angleze. Librat e Dr.Alpion janë botuar në Angli, Amerikë, Kanada, Itali dhe Indi. Dy dramat e Dr.Alpion, ku shtjellohet trajtimi i emigrantëve nga Kosova dhe Shqipëria në Perëndim, janë shfaqur me sukses në disa qytete të Anglisë.

Zhvillimi i balancuar rajonal është një kusht për një shoqëri më të mirë.
PATRICE RIEMENS, AMSTERDAM, NETHERLANDS:

Rruga e Arbërit, jetike për Shqipërinë,

Mjaft qytetarë që kanë firmosur peticionin për rrugën e Arbërit, kanë nënshkruar edhe mendimet e tyre se pse ndërtimi i saj është i rëndësishëm për ta. Opinionet janë ta hapura në faqen e web "change.org" dhe shumë prej tyre janë në gjuhën angleze. Opinionet do bëhen publike numër pas numri, duke mbledhur kështu argumentat që do botohen në një botim të posaçëm, që do t'i bashkëngjitet peticionit.

Redaksia do të mirëpresë në vazhdim edhe opinione e studime specialistësh, me argumenta të tjera "Pro" ndërtimit të rrugës dhe avantazhet që ajo sjell për ekonominë kombëtare.

Ledio Baboci, OLNEY, MD: E njoh vetë gjithë zonën, vende të bukura dhe njerëz të mrekullueshëm që jetojnë aty. Ata meritojnë më shumë.

Helen Sali, MELBOURNE, AUSTRALIA: Familje!

Naim Mucaj, MELBOURNE, AUSTRALIA: Është shumë me rëndësi që kjo pjesë e Shqipërisë të mos mbetet në humnerën e shekullit të kaluar. Shpresoj se zona e Dibrës të mund të inkuadrohet në sistemin infrastrukturës në Shqipëri sa më shpejt.

Lenka Sali, MELBOURNE, AUSTRALIA: Njerëzit nga ana e babait tim janë nga Shqipëria.

Agron Mataj, AUSTRALIA :Sepse do të përmirësohet ekonomia dhe me përmirësimin e ekonomisë do të përmirësohet edhe jeta e atyre njerëzve që banojnë në atë pjesë të Shqipërisë.

Sezar Jakupi, MELBOURNE, AUSTRALIA: Që të përmirësohet infrastruktura ekonomike e qytetarëve të Dibrës, që të përfitojnë ekonomikisht dhe jeta e tyre të jetë më e mirë.

Ramadan Jashari, BRUXELLES, BELGIUM: Mbështet zhvillimin e Dibrës dhe përmirëson marrëdhëniet ekonomike dhe sociale me popullsinë shqiptare të Maqedonisë, që në fakt janë të shtypura dukshëm nga autoritetet maqedonase.

Besnik Alku, TIRANA, ALBANIA: Jam nga Dibra.

Armela Panajoti, VLORË, ALBANIA: Përmirëson lidhjet dhe lidhjet sjellin zhvillim.

Bashkim Pitarka, BOCA RATON, FL: Do të ndihmojë njerëzit e mi në Shqipëri dhe Maqedoni.

Flutura Açka, TIRANA, NETHERLANDS: Paraardhësit e mi janë nga Dibra dhe do të më pëlqente të shkoj më shpesh andej.

Nexhi Saliu, TIRANA, ALBANIA: E dua Dibrën.

Stephanie Apps, AUSTRALIA: Shqipëria është një vend në zhvillim dhe ka nevojë për infrastrukturë për të tërhequr investitorë në vend. Rrugë të tilla janë thelbësore për këtë process.

Hajrulla Nikolli, PESHKOPI, ALBANIA: Rruga është e rëndësishme për komunitetin.

Malvina Plaku, TIRANA, ALBANIA: Është shumë e rëndësishme për të gjithë ne.

Lisa Lissy, TACOMA, WA: Origjina.

Tina Hoxha, TORONTO, CANADA: Vende të bukura, njerëz bujarë, të mençur e punëtorë. Kjo është më e pakta që mund të bëjë qeveria për të përmirësuar ekonominë lokale dhe të ndihmojë këta njerëz të mrekullueshëm.

Patrice Riemens, AMSTERDAM, NETHERLANDS: Zhvillimi i balancuar rajonal është një kusht për një shoqëri më të mirë.

Andi Lala, SKOPJE, MACEDONIA: Jam nga ai rajon dhe do të doja të shikoja ekonominë e asaj zone që të zhvillohej. Gjithashtu meqë po punoj në Shkup, do të ishte shumë ndihmë për lidhjen mes shqiptarëve në Maqedoni dhe Shqipëri.

Audrey Toptani, GUILDFORD, UNITED KINGDOM: Ky do të ishte një përmirësim mjaft i mirë për ekonominë e një zone që deri më tash ka qenë një nga zonat më të izoluara të Shqipërisë.

Abdulla Diku, TIRANA, ALBANIA: Sepse është rruga më e rëndësishme e vendit.

Ervin Lisaku, TIRANA, ALBANIA: Ndihmon zhvillimin e rajonit të Dibrës dhe shkurton distancën me Maqedoninë.

Gjergj Kote, TIRANA, ALBANIA: Të bëhet sa me shpejt të jetë e mundur

Hamit Salkurti, PESHKOPI, ALBANIA: Do ta bëjë jetën më të lëhtë për 294000 njerëzit e rajonit të Dibrës. Do të motivojë bujqit dibranë për të prodhura më shumë nga toka. Do të krijojë më shumë mundësira për fermerët ruralë. Do të krijojë mundësira për turistët që duan të vizitojnë Dibrën. Më shumë produkte të freskëta do të arrijnë në kryeqytetin shqiptar dhe në qytete të tjera si Durrës, Elbasan, Lezhë, Krujë etj. Shumë të papunë që jetojnë në Tiranë dhe janë me origjinë nga Dibra, do të kthehen të punojnë tokën e tyre dhe do të ketë më pak presion në Tiranë për papunësinë. Vlera e çdo gjëje në Dibër do të rritet. Dhe shumë të tjera...

Shpetim Cami, TIRANE, ALBANIA: Jam nga Dibra

Marjeta Rroshi, TIRANA, ALBANIA: Sepse është zona e prindërve të mi.

Geron Kamberi, TIRANA, ALBANIA: Sepse lidh Tiranën me pjesën verilindore të Shqipërisë dhe sjell në tregun kryeqytetas më shumë produktet e freskëta bujqësore.

Safet Hoxha, BERAT, ALBANIA: Per qef

Ana Salkurti, PESHKOPI, ALBANIA: Është vendlindja ime.

Kadri Skera, TIRANA, ALBANIA: Për shkak të origjinës sime Dibrane, të njerëzve dhe pasurive që janë në atë treve dhe në trevat Shqiptare të Maqedonisë. Për nga rëndësia, është rruga e dytë e Kombit pas rrugës Durrës-Kukes-Prishtinë. Jo pa shkak mban dhe emrin "Rruga e Arbërit". Mirë do të ishte që të planifikohej dhe kalimi i rrjetit hekurudhor, i cili modernizon përfundimisht këto zona .

Blerin Kuçuku, TIRANA, ALBANIA: Sepse është.

Alban Taraneshi, DEBAR, MACEDONIA: Për të lidhur më shpesh dhe më shpejt vendlindjen time me vëllezërit dhe motrat shqiptarë.

Mirlinda Chiche, DEBAR, MACEDONIA: E sjell Dibrën më afër me Tiranën dhe pjesën tjetër të Shqipërisë.

Bardhyl Marku, SKOPJE, MACEDONIA: Do të shkurtojë ndjeshëm rrugën nga Dibra e Maqedonisë për në Tiranë.

Klevis Perleka, TIRANE, ALBANIA: Për të ardhmen e qytetit.

Besian Kojku, ANSONIA, CT: Për më të mirën e qytetit tim dhe për të gjithë ata që jetojnë atje...

Andi Gjeci, TIRANA, ALBANIA: Mund të shkoj më rehat në Dibër .

Fisnik Kërliu, ДебАр, MACEDONIA: Do të ishte me shumë domethënie për ne!!!

Dritan Lleshi, DIBËR, MACEDONIA: Ardhmëria e qytetit tim

Alban Hysenaj, TIRANE, ALBANIA: Kjo rrugë do të shkurtojë udhëtimin me 2 orë. Dibranët kanë 22 vite që e ëndërrojnë këtë rrugë. Imagjinoni, një rrugë që do të jetë vetëm 100 km. Do të ringjallë ekonominë më të dobët të Shqipërisë.

Preng Llusku, TIRANA, ALBANIA: Kam kaluar pjesën më të bukur të jetës time në Bulqizë - Zerqan me detyrën e oficerit. Plot 11 vjet. Nga këto 9 vite kam jetuar me familje në Bulqizë. Jam dhe do të jem gjithmonë i lidhur me njerëzit e mrekullueshëm Dibranë. Dibra është një zonë që do ta frekuentoja shpesh nëse përfundon "Rruga e Arbrit" . Do të shfrytëzoja çdo vit dhe llixhat e mrekullueshme të Peshkopisë. Ndaj bashkohem fuqishëm në këtë Peticion.

Eduard Ilnica, MAQELLARË, ALBANIA: Do investoj edhe unë me gjithë resurset e mia për realizimin e kësaj rruge strategjike jo vetëm për dibranët

Holta Koci, TIRANA, ALBANIA: Përveç se është e rëndësishme për të lidhur trevat shqiptare, kjo është një rrugë historike dhe nëse planifikohen ndërhyrjet nga Klosi në Shëngjergj mund të jetë dhe zonë turistike.

Ermira Durici, BULQIZË, ALBANIA: Sepse do ti japi një zhvillim zonës se Dibrës dhe mundësi më të mira për punë popullit.

Muhamet Shehi, TIRANA, ALBANIA: Se meritojnë të jetojnë më mirë se dje.

Eduart Tola, PESHKOPI, ALBANIA: Premtimet e dhëna duhet të mbahen.

Jeta Beqiraj, ALBANY, NY: Lidhje rajonale dhe ndërshtetërore dhe shtytje e zhvillimit ekonomik.

Fred Wsterink, TIRANA, ALBANIA: Ne udhetojme per pune dhe per argetim ne zonen e Dibres, dhe rruga do te na e shkurtohe kohen e udhetimit jashtezokonisht

Hajri Mandri, TIRANA, ALBANIA: Kërkojme që të jetë prioritet ndërtimi i Rrugës së Arbërit.

José Igor Prieto Arranz, PALMA DE MALLORCA, SPAIN: nga nje burim i besuar mesoj se Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Klodjan Lami, PESHKOPI, ALBANIA: Për të mirën e komunitetit tim!

Nita Shquti, TIRANA, ALBANIA: Unë mbështes Rrugën e Arbërit!

Blerina Memushi, BERAT, ALBANIA: Sepse unë punoj e jetoj në Shkup prej një viti dhe udhëtoj 8 orë për t'u kthyer në familje. Shumë gjatë dhe udhëtim i lodhshem. Rruga e Arberit do ishte zgjidhje e përsosur për mua.

Artur POCESTI, PESHKOPI, ALBANIA: Kemi dhe ne të drejta...

Etlira Neli, PESHKOPI, ALBANIA: Për udhëtim më të shpejtë.

Wael Mohamed, MENOUFIYA, EGYPT: Bashkohet me vendet në zhvillim.

Dionis Xhafa, TIRANA, ALBANIA: Për të përfunduar ndërtimin e Rrugës së Arbrit.

Scott Lucas, BIRMINGHAM, UNITED KINGDOM: Për të mirën e shqiptarëve.

Sam Whimster, LONDON, UNITED KINGDOM: Duke parë gjendjen e tanishme gjeopolitike, është e patoleruеshme që komunikimi përmes transportit të jetë në këto kushte jo zhvillimi në Ballkan.

Nexhi SALIU, TIRANA, ALBANIA: Sepse Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të vendit dhe do ti japë hov zhvillimit të ekonomisë.

Azem Dani, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo është e rëndësishme për mua sepse jam një student dhe dua të shkoj në shtëpi më shpejt e më shpesh. Dua të nisem e të fle në shtëpi jo në hotele rrugës. Shpresoj që mund të bëni diçka për vendin tim. Faleminderit.

Leonard Sallahi, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo është shumë e rëndësishme për të ardhmen e njerëzve këtu. Të gjithë e duan këtë rrugë.

Maksim Zotaj, TIRANA, ALBANIA: Sepse jam shqiptar dhe ndihmon zhvillimin e ekonomisë së vendit.

Besjana Sturce, PESHKOPI, ALBANIA: Po kemi nevojë për këtë rrugë.

Olienton Sturce, PESHKOPI, ALBANIA: Si mund të zhvillohen njerëzit pa gjërat kryesore. Dhe kjo duhet bërë shpejt dhe shumë mirë.

Alketa Jata, TIRANA, ALBANIA: Është vendlindja ime dhe e meriton që të vihet dorë mbi të e të zhvillohet, e jo të mbetet me e varfëra në Republikë

Sokol Tomcini, Αθήνα, GREECE: Sepse jam Dibran por edhe Shqiptar.

Indrit Kamberi, PESHKOPI, ALBANIA: Kemi nevojë për këtë rrugë.

Ariana Pacrami, WALTHAMSTOW, UNITED KINGDOM: Është vendi im dhe njerëzit e mi për të cilët kujdesem.

Sokol Cahani, LONDON, UNITED KINGDOM: Mendoj që është e rëndësishme për të përmirësuar jetën e banorëve.

Arben Cokaj, SHKODRA, ALBANIA: Sepse i jep një mundësi zonës së Dibrës të zhvillohet.

Alime Nako, LERICI (SP), ITALY: Për të mbajtur gjallë historinë, traditat dhe kulturën e Shqipërisë së shumvuajtur!

Ilir KRASHI, PESHKOPI, ALBANIA: Ndikon zhvillimin e rajonit.

Vera Held, TORONTO, CANADA: Shqipëria është një vend në zhvillim dhe kam mbështetur dy projekte të tilla deri tani.

Nikolin Mane, TIRANA, ALBANIA: Shqipëria duhet të jetë pjesë e Bashkimit Europian.

N.S., BROOKLYN, NY: Lidhja e të gjitha trojeve shqiptare.

Alban Merdini, COLCHESTER, UNITED

Është e rëndësishme të ndihmohen njerëzit andej sepse infrastruktura është shumë e keqe. Për patriotët e mi do të jetë më e lehtë të udhëtojnë. Në vend të katër orëve do të udhëtojnë dy orë. Përdorimi i mirë i kohës është i rëndësishëm për njerëzit sepse kushtet e tyre të jetesës janë të vështira. Kështu, pse të mos ndihmohen rreth kushteve të jetesës? Është një gjë që duhej bërë tashmë por ndonjëherë qeveria i harxho paratë në gjëra më pak të rëndësishme sesa nevojat e njerëzve të asaj zone...

VLORA KRASNIQI, BRUSSELS, BELGIUM:

Ndërtimi i rrugës së Arbrit do të bëhet një rrugë e shkelur, shumë e rëndësishme për ekonominë lokale dhe do të përmirësojë infrastrukturën e asaj pjese të Europës.

AGRON MATAJ, MELBOURNE, AUSTRALIA

Sepse do të sjellë zhvillimin e rajonit që sot është shumë pak i zhvilluar. Ndaj shumë të rinj po largohen. Ky rajon dhe ata njerëz meritojnë kushte më të mira jetese. Kjo është arsyeja pse e mbështes këtë iniciativë.

AVNI DERVISHI, KOSOVA, ALBANIA:

koment

Sepse është një premtim që nuk është mbajtur. Është një ëndërr e pambaruar. Është një komb akoma i ndarë dhe me këtë rrugë do të bashkohet.
ALTIN CENGA, GÖTEBORG, SWDEN:

zgjon ëndrrat dhe rrit shpresat!



© Foto: Bujar Karoshi

Rruga është jeta... është përgjegjësia e qeverisë shqiptare që t'ju japë një mundësi atyre njerëzve për të jetuar.
RAIMONDA NELKU
TIRANA, ALBANIA

Vende të bukura, njerëz bujarë, të mençur e punëtorë. Kjo është më e pakta që mund të bëjë qeveria për të përmirësuar ekonominë lokale dhe të ndihmojë këta njerëz të mrekullueshëm.
TINA HOXHA
TORONTO, CANADA

Shqipëria është një vend në zhvillim dhe ka nevojë për infrastrukturë për të tërhequr investitorë në vend. Rrugë të tilla janë thelbësore për këtë process.
Stephanie Apps, AUSTRALIA

E njoh vetë gjithë zonën, vende të bukura dhe njerëz të mrekullueshëm që jetojnë aty. Ata meritojnë më shumë.
LEDIO BABOCI
OLNEY, MD:

KINGDOM: Është e rëndësishme për mua dhe gjithë zonën e Dibrës. Dibra duhet të jetë e lidhur me Tiranën dhe pjesë të tjera të Shqipërisë dhe ka shumë kontribut për të sjellë në ekonomi.

Rob Edge, BIRMINGHAM, UNITED KINGDOM: Pjesë e rëndësisë së përmirësimit të infrastrukturës dhe do të sjellë lidhjen e ndërsjellë mes qyteteve kryesore.

Enver Halili, AUSTRALIA: Sipas mendimit tim, Rruga e Arbërit është e një rëndësie të veçantë për popullin shqiptar në përgjithësi. Kjo rëndësi shtrihet jo vetëm në fushën ekonomike por edhe në atë kulturore, strategjike e humanitare. Aspekti ekonomik i saj qëndron në atë sepse ul shpenzimet e transportit dhe shkurton kohën e udhëtimit të qindra mijëra banorëve të kësaj ane. Rëndësia e veçantë është sepse kjo rrugë jo vetëm që i ndërlidh ekonomitë asaj ane me metropolin kryesor Shqiptar e Ballkanik, por gjithashtu e lidh me portin kryesor- Durrësin dhe vendet tjera europiane. Po ashtu e një rëndësie të veçantë është mundësia e zhvillimit të ekonomisë së turizmit malor. Ajo anë disponon me resurse të mrekullueshme të turizmit malor (veror dhe dimëror). Të ardhurat nga ekonomia turizmit të kësaj ane do të ndikojnë në mënyrë signifikante (pozitive) në buxhetin e shtetëror e kombëtar. Aspekti kulturor dhe humanitar qëndron në lehtësimin e jetës së banorëve të kësaj ane. Dihet se kjo anë deri tash ka qenë një zonë më pak sa e izoluar për shkak të terrenit të vështirë malor. Ky aks rrugor lirisht mund të thuhet se ka shume tipare të Rrugës së Kombit Durrës-Prishtinë. Jam shumë i sigurt se kostoja e rrugës do të mbulohet për një afat shumë të shkurtër. Të ardhurat (beneficionet) e saj do të jenë të shumëfishta dhe ekonomikisht të pa kontestueshme. Andaj, mund të përfundojë se nuk ka nevojë të vizitohet, por duhet të fillohet sa më shpejtë që të jetë e mundur. Me rrespekt, Enver Halili, Ligjerues i Finances, Melburn

Albion Ndreka, DURRËS, ALBANIA: Kjo rrugë nuk është çelësi magjik dhe i vetëm i

Pse është e rëndësishme? Sigurisht që është e rëndësishme, sepse jam 21 vjeç dhe kam të paktën që kur isha 9 vjeç që e dëgjoj dhe stërdëgjoj si çështje, por aha pa rezultat. (me herët duhet të jetë folur patjetër po nuk mbaj mend, dhe këtë e mbaj mend sepse në 9-vjetorin tim dëgjoja që shpërngulja në Tiranë po vinte sepse "Ato nuk kanë ndërmend ta bëjnë rrugën e Arbërit") dhe mesa duket të drejte paska pasur im atë që e thoshte gjithnjë. Në fakt, ku do kish më bukur sesa realizimi i një vepre të tillë me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare. Sa larg ish Kosova, sa afër është tani pas rrugës. Nuk thonë kot, që rrugët dhe infrastuktura janë hapi i parë në zhvillimin e një vendi. Dhe rruga e Arbërit, do ishte hapi i parë në zhvillimin e Veriut të Shqipërisë!! Ja pse është e rëndësishme
Dorieta Gjura, POTSDAM, GERMANY

zhvillimit të kësaj zone, por është një ndër faktorët kryesorë që do të sjellë më shumë zhvillim për rajonin Veri-Lindor të Shqipërisë dhe do të sjellë më shumë lidhje dhe bashkëpunim me Dibrën e Madhe dhe shqiptarët e trevat shqiptare në IRJ-Maqedonisë.

Laidon Shapo, LONDON, UNITED KINGDOM: Çdo projekt që tregon potencial për zhvillimin ekonomiko-social të vendit tim të origjinës është i rëndësishëm për mua dhe rruga e propozuar e Arbrit duket ky lloj propozimi për mua që jo thjesht përmirëson infrastrukturën por do të sjellë një bum për gjithë ekonominë dhe do ta sjellë Shqipërinë një hap më afër bashkimit me Europën.

Ermal Osmani, ALTAMONTE SPRINGS, FL: Sepse jam nga Dibra.

Irena Nikaj, KORÇË, ALBANIA: Është e rëndësishme për Shqipërinë dhe shqiptarët, duhet mbështetur

Dhimiter Shtambari, LUSHNJË, ALBANIA: Kjo rrugë duhej të ishte ndërtuar shumë kohë më parë. Tani është shumë vonë, por siç thotë populli, më mirë vonë se kurrë!

Drilon Cenga, PESHKOPI, ALBANIA: Rruga e Arbrit.

Atila Gjuladin, OHRID, MACEDONIA: Paraardhësit e mi janë nga kjo zonë. Vij nga një familje e njohur e Dibrës. Gjyshi im Jusuf-bej Agolli (Dibra) ishte një nga qytetarët më të rëndësishëm të qytetit. Më vonë u bë ministër. Kështu që do të doja të shikoja qytetin dhe zonën të zhvilluar siç e meriton.

ETLEVA HAKA ,TIRANA, ALBANIA: Çelësi i suksesit të zhvillimit të turizmit në veri të vendit tim.

Shpresa Spahiu, TIRANA, ALBANIA: Do të ndihmojë rritjen ekonomike dhe sociale të rajonit. Do të përmirësojë lidhjet me pjesët e tjera të vendit për ndërveprim zhvillimi.

Hyrijeta Kolari, PRISHTINA, KOSOVO: Dibra është një nga zonat më pak të zhvilluara të Shqipërisë. Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të vendit për të nxitur zhvillimin ekonomik. Rruga do të jetë edhe një lidhje e rëndësishme mes Tiranës dhe Maqedonisë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën e kësaj pjese të Ballkanit.

INDRIT CENGA, PESHKOPI, ALBANIA: Për jetesën. Rruga është e rëndësishme për ne.

Sokol Kallaverja, TIRANA, ALBANIA: Kjo ndoshta duhet të ishte ndër rrugët e para në Shqipëri për t'u ndërtuar, përveç atraksioneve turistike dhe burimeve natyrore ajo do kishte një rëndësi të veçantë për zhvillimin e rajonit në Ballkan duke qenë si një urë lidhëse dhe shumë e shkurtër për shumë shtete, ku si për pasojë Lezha (porti i Shëngjinit dhe ai i Durrësit do ti shtoheshin listës së porteve më të mëdha në Europë. Një arsye tjetër është dhe se komuniteti Dibran është i konsiderushem në Tiranë e për pasojë shkëmbimet dhe udhëtimet drejt Dibrës ose Tiranës janë shumë të shpeshta dhe me volum të madh si në transport udhëtarësh si dhe në ato të mallrave, ku një rëndësi të madhe kap minerali i kromit në Bulqizë një pasuri e madhe e vendit tonë.

Nick Gjuravcaj, NEW CITY, NY: Për t'u lidhur me pjesën tjetër të vendit.

Peter Peci, TORONTO, CANADA: Është një rrugë e rëndësishme dhe strategjike që do të sjellë zhvillim për këtë zonë të izoluar të Shqipërisë.

Jenny Money, LEWS, UNITED KINGDOM: Sepse e dua Shqiperine dhe dua qe te lulezoje por per kete duhet nje infrastrukture qe te inkurajoje zhillim dhe terheqe turiste te cilet do te harxhoje parate ne kete zone.

Altin Cenga, GÖTEBORG, SWDEN: Sepse është një premtim që nuk është mbajtur. Është një ëndërr e pambaruar. Është një komb akoma i ndarë dhe me këtë rrugë do të bashkohet.

Ajrina Hysaj, TIRANA, ALBANIA: E dua Shqipërinë nga thellësia e zemrës dhe ndjehem shumë keq që nuk e vizitoj dot Peshkopinë. Ndjehem në siklet gjithashtu që nuk mund t'ju tregoj miqve të mi të huaj për vlerat e Peshkopisë.

Agim Picaku, TIRANA, ALBANIA: Kjo është e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të atyre zonave të lëna në harresë dhe jashtë mundësisë integruese.

Astrit Luzi, BRUXELLES, BELGIUM: Rrugët janë arteriet e ekonomisë së një kombi dhe përfitojnë të gjithë


Gjura Memli, DIBER, MACEDONIA: Jetoj këtu. Prandaj.

Adrian Dizdari, BELLEVILLE, NJ: Kjo është shumë e rëndësishme për të ardhmen e vendit tonë. Mezi po pres të bëhet gati.

Ardit Shima, TIRANA, ALBANIA: Jam i interesuar.

SUZANA GJURRA, BURREL, ALBANIA: Do të jetë e rëndësishme për vendlindjen time, Burrelin. Do të rrisë tregtinë dhe ekonominë.

(Vijon në faqen 6)



Rruga e Arbërit, jetike për Shqipërinë, zgjon ëndrrat dhe rrit shpresat!

(Vijon nga faqja 5)

Eduart Gjurra, DIBER, UNITED KINGDOM: Duhet të ketë një investim për Dibrën sepse asnjë qeveri nuk ka përmirësuar asnjë gjë për qytetin dhe zonën përreth.

Endrit Mertiri, TIRANA, ALBANIA: Për shumë arsye.

Aldi Hoxha, TIRANA, ALBANIA: Sepse nëna ime është nga Dibra.

Agron Sharkaj, TIRANE, ALBANIA: Është rrugë që lidh rajone shumë të rëndësishme me prespektivë zhvillimi në fushën e mineralogjisë dhe zhvillimin e turizmit

Mirjana Hoxha, TIRANA, ALBANIA: Është mirë për zhvillimin e Shqipërisë.

Xhelil Cibaku, TIRANE, ALBANIA: Po shumë e rëndësishme.

HAJREDIN TOCA, TIRANA, ALBANIA: Është jeta ime.

Gjon Jaku, TIRANA, ALBANIA: Është një nga arteriet kyçe e zhvillimit të kombit shqiptar.

Agron Mataj, MELBOURNE, AUSTRALIA: Ndërtimi i rrugës së Arbrit do të bëhet një rrugë e shkelur, shumë e rëndësishme për ekonominë lokale dhe do të përmirësojë infrastrukturën e asaj pjese të Europës.

Vlora Krasniqi, BRUSSELS, BELGIUM: Është e rëndësishme të ndihmohen njerëzit andej sepse infrastruktura është shumë e keqe. Për patriotët e mi do të jetë më e lehtë të udhëtojnë. Në vend të katër orëve do të udhëtojnë dy orë. Përdorimi i mirë i kohës është i rëndësishëm për njerëzit sepse kushtet e tyre të jetesës janë të vështira. Kështu, pse të mos ndihmohen rreth kushteve të jetesës? Është një gjë që duhej bërë tashmë por ndonjëherë qeveria i harxho paratë në gjëra më pak të rëndësishme sesa nevojat e njerëzve të asaj zone…

Igli Gudo, LONDON, UNITED KINGDOM: Që të sigurojmë hyrje më të shpejtë dhe më të mirë për tregtinë dhe të përmirësojmë mirëqënien e njerëzve.

Artan T, ALBANIA: Është rruga e dytë e Kombit!!! Bashkon Shqipërinë me Maqedoninë, siç u bashkuam me Kosovën! Duam ndërtimin e Rrugës së Arbërit!

E.S, GERMANY: Rruga e Arbërit është një nga rrugët më të vjetra shqiptare, e rëndësisë së madhe pas asaj të "Egnatias". Lidh Tiranën më Dibrën, më tej me Maqedoninë. Për rëndësinë e ndërtimit të kësaj rruge është diskutuar shumë dhe përfitimet njihen tashme që do ishin të mëdha.

Janë bërë dhe po bëhen punime çapitëse - sa rregullohet një segment prishet një tjetër e për disa nga pjesët më të rëndësishme nuk janë gjetur ende fondet. Ka që në 1998 që është nisur puna për këtë rrugë dhe vetëm po zvarritet, pavarësisht së cili krah politik është në pushtet. Prandaj shpresoj që ky peticion të firmoset nga të gjithë shqiptarët e Dibrës, të qyteteve përreth dhe të Maqedonisë, që zëri ynë të ngrihet. Nuk duhet që të lejojme me zvarritjen e këtij projekti minimal, krahasuar me ato ç'ka janë bërë në gjithë Shqipërinë. Nuk duhet te lejojmë që të na shfrytëzojnë shpresën e besimin tonë sa herë afrohen zgjedhjet me premtime boshe e afate të gënjeshtërta!

Dibra dhe gjithë shqiptarët që bashkon rruga e Arbërit kanë kontribuar shumë për vendin, kanë bërë histori e kulturë. Njerëzit e famshëm të mendjes e alegorisë, dibranët, kanë paguar taksat si gjithë të tjerët, e kanë përfituar shumë pak nga ky kontribut, duke u shndërruar kështu në rrethin me të varfër të Shqipërisë.

Natyra e kësaj zone, mali më i lartë i Shqipërisë, Korabi, Parku Kombëtar i Lurës, lugina e Drinit të Zi, etj., nuk meritojnë të mbeten të harruar vetëm për 80 km asfalt...

Nuk ka rëndësi kush vjen në pushtet - duam Rrugën e Arbërit prioritet të qeverisë pas 23 Qershorit! Me respekt.. për vendin tim, E. S.

Elton Alku, TIRANA, ALBANIA: Zhvillim për bujqësinë e blegtorinë e zonës e begati për bashkëvendlindjen

Albjonda Dede, DIBER, MACEDONIA: Dibra është një nga zonat më pak të zhvilluara të Shqipërisë. Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të Shqipërisë dhe do t'i japë zonës një hov zhvillimi. Rruga gjithashtu do të bëhet një lidhje e shkelur mes Tiranës dhe Maqedonisë duke sjellë përmirësim të mirë të infrastrukturës së Ballkanit.

Skënder Buçpapaj, BASEL, SWITZERLAND: Është jetike për vendin tim, Shqipërinë.

Përparim Demi, TIRANA, ROMANIA: Kjo rrugë do zhvillojë tërë zonën, që nga Mati e deri në Dibër, plus do jetë aksi i lidhjes me Shkupin.

Raimonda Nelku, TIRANA, ALBANIA: Rruga është jeta… është përgjegjësia e qeverisë shqiptare që t'ju japë një mundësi atyre njerëzve për të jetuar.

Avni Dervishi, KOSOVA, ALBANIA: Sepse do të sjellë zhvillimin e rajonit që sot është shumë pak i zhvilluar. Ndaj shumë të rinj po largohen. Ky rajon dhe ata njerëz meritojnë kushte më të mira jetese. Kjo është arsyeja pse e mbështes këtë iniciativë.

Majlinda Bregasi, ITALY: Rruga sjell civilizim.

Dhurim Nazifi, TIRANA, ALBANIA: Jam nga Dibra, prandaj…

Manjola Mema, STAMFORD, CT: Sepse Peshkopia është vendlindja ime dhe e vlerësoj mirëqënien e saj.

Peter Kampen, SKOPJE, MACEDONIA: Duke qënë se kam jetuar dhe punuar për shumë kohë në Dibër e kuptoj rëndësinë e kësaj rruge për gjithë rajonin e Dibrës. Rruga e tanishme – sapo kam udhëtuar në të – është shumë poshtë standarteve të kërkuara. Një rrugë normale do të ndryshonte prespektivën e zhvillimit për të gjithë ata që janë të lidhur me të.

Arben Palushi, KUKËS, ALBANIA: Jam shqiptar.

Tritan Kalo, TIRANA, ALBANIA: Për zhvillimin e pjesës veri lindore të Shqipërisë dhe gjithashtu për komunikim më të mirë mes shqiptarëve.

Fabio Corona, TIRANA, ALBANIA: Dibra është një nga zonat e mia të preferuara.

Lulzim Haxhiu, BUFFALO, NY: Patjetër se kjo është një kërkesë e cila çon në afrimin dhe zhvillimin e tërë territoreve shqiptare, konkretisht të Dibrës, e cila me qëllim është lënë nga sllavët në pazhvillueshmëri, kur historikisht dihet se Dibra ka qenë dhe është qendra e qëndresës shqiptare në Maqedoni dhe më gjerë, prandaj ËSHTË MË SE E DOMOSDOSHME NJË ZHVILLIM MË I MADH EKONOMIK i kësaj pjese, kur dihet procesi i shpërnguljes në masë së banorëve shqiptarë të Dibrës, e me këtë edhe do të realizohej edhe qëllimi kryesore i sllavo-maqedonëve për shpërnguljen e popullatës shqiptare nga ky rajon!

VAIT SELA, BROOKLYN, NY: Është e rëndësishme sepse dua ta shikoj vendlindjen time më mirë se tani (Fat të mbarë, Dibër!) Faleminderit!

Luljeta Lamce, TIRANA, ALBANIA: Sepse Peshkopia është vendlindja ime. E dua.

Alfons Bara, TIRANA, ALBANIA: Sepse Dibra ka nevojë për të.

Alfons Bara, VÄSTERVIK, SWEDEN: E dua vendlindjen time.

Florent Cice, SKOPJE, MACEDONIA: Rritje ekonomike dhe zhvillim.

Denisa Shefa, TIRANE, ALBANIA: Rritje ekonomike.

Arber Cenga, TIRANA, ALBANIA: Po e them shqip: është rruga ime, është ëndrra ime është ajo që më mban larg shtëpisë sime dhe fëmijërisë sime. Ju lutem bëjeni këtë rrugë!

Besmir Koka, SOHODOLL, ALBANIA: Do sjellë zhvillim për rajonin.

Lulzim Çota, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për pjesën lindore të Shqipërisë dhe do të shkurtojë distancën mes Tiranës dhe Peshkopisë, dhe me qytetet shqiptare në Perëndim të Maqedonisë.

Zana Kamberi ,FORT COLLINS, CO: Dua një Shqipëri të bukur.

Agim Kola, New YORK, NY: Peshkopia është vendlindja ime.

ARTAN MIZA ,ALBANIA, LAC, ALBANIA: Është e rëndësishme për mua, për vete emri dhe funksionin e domosdoshëm që kryen për gjithë zonën veri lindore të vendit.

Fexhri Selami, SKOPJE, MACEDONIA: Zhvillimi i biznesit.

Jorgji Qirjako, TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbrit është arteria kryesore që lidh shqiptarët me atë rajon që ka njerëz shumë punëtorë.

Aspri KAPO, VLORË, ALBANIA: Arsyeja e vetme që nuk e vizitoj Dibrën është për shkak të kushteve të këqija të rrugës.

Kujtime Sinjari, TIRANA, ALBANIA: Sepse kam të afërm në Peshkopi dhe rruga e tanishme na ka ndarë.

Adivije Sina, TIRANA, ALBANIA: Është gjë e rëndësishme për ne se nuk ka më rrugë të lodhshme

Farie Methasani, TIRANA, ALBANIA: Na lidh me të gjithë të afërmit tanë në Diber

Blerta Methasani, TIRANA, ALBANIA: Është një nga ngjarjet më të rëndësishme për të gjithë dibranët edhe gjithë shqiptarët

Vilson Taravari, TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera dhe do e bëjë më të lehtë dhe më të shpejtë udhëtimin

Lulzim Shini, DIBER, ALBANIA: Kjo rrugë është e rëndësishme për mua sepse unë kam llojin e punës që kërkon udhëtimin e shpeshtë nga Dibra në Tiranë dhe anasjelltas.

Keni Kamberi, PESHKOPI, ALBANIA: Se shkurtohet, rruga më e mirë

Musa Caushi, PESHKOPI, ALBANIA: Ka shumë rëndësi për qytetarët e qytetit të Peshkopisë, për disa arsye të rëndësishme si: lidhja me kryeqytetin Tiranën i cili është metropol, për çështje tregtie, çështej pune, biznesesh, vizitash, gjëra që janë shumë të rëndësishme për çdo individ në jetën e përditshme, e shumë e shumë arsye të tjera. Faleminderit.

Iva Kuka, TIRANA, ALBANIA: Eshtë i domosdoshëm përmirësimi i infrastrukturës në zonën e Dibrës

Qazim Manuka, PESHKOPI, ALBANIA: E duam rrugën e Arbërit të gjithë ne dibranet

Liljana Meda, PESHKOPI, ALBANIA: Urime rrugës së Arbrit!

Arta Sina, PESHKOPI, ALBANIA: Është shumë e rëndësishme për ne Dibranët

Edmond Palucaj, LEZHË DISTRICT, ALBANIA: Sepse rruga ekzistuese për në Peshkopi është e shkatërruar dhe shume e lodhshme.

Aldo Xhemali, TIRANA, ALBANIA: Eshtë Rrugë Me Standarte Europiane

Faik Mera, TIRANA, ALBANIA: Për të shkuar sa më shpesh tek vendlindja ime. Atje ku mësova fjalët e para, atje ku hodha hapin e parë, atje ku kam të parët e mi, etj.

Bujar Tabaku, ITALY: Shqipëria të ketë komunikim me sa më shumë vende me standarte europiane.

Ali Kalia, PASKUQAN, ALBANIA: Sepse, unë jam nga Dibra!

Kolec Traboini, BOSTON, MA: Kjo rrugë - është jetike për Kombin.

Anisa Buci TIRANA, ALBANIA: Sepse mendoj se do te ishte gjeja me e mire per kete zone

Pirro Dollani, LAS VEGAS, NV: Amerika është një nga superfuqitë ekonomike të botës pikërisht nga sistemi i autostradave që ideatoi President Eisenhowr, babai i Sistemit të Autostradave. Çdo koment i mëtejshëm është i panevojshëm.

Fasli Tola: Kjo rrugë është shumë e rëndësishme për mua pasi unë e vizitoj shumë shpesh vendlindjen time Dibrën, fshatin ÇIDHEN. Gjithashtu, duhet investuar edhe në rrugën Peshkopi-Lurë pasi në 22 vjet demokraci janë investuar 0 qindarka për këtë rrugë.

Përgatiti për botim dhe përktheu nga anglishtja: **AFRIM KAROSHI**

opinion

Duke qënë se kam jetuar dhe punuar për shumë kohë në Dibër e kuptoj rëndësinë e kësaj rruge për gjithë rajonin e Dibrës. Rruga e tanishme – sapo kam udhëtuar në të – është shumë poshtë standarteve të kërkuara. Një rrugë normale do të ndryshonte prespektivën e zhvillimit për të gjithë ata që janë të lidhur me të.

PETER KAMPEN,
SKOPJE, MACEDONIA

Është shumë me rëndësi që kjo pjesë e Shqipërisë të mos mbetet në humnerën e shekullit të kaluar. Shpresoj se zona e Dibrës të mund të inkuadrohet në sistemin infrastrukturës në Shqipëri sa më shpejt.

NAIM MUCAJ
MELBOURNE, AUSTRALIA

zgjedhje



PROFILI I MR. RUZHDI LATA

Është lindur në vitin 1953 në Dibër ku ka kryer edhe shkollën fillore, të mesmen ne Medresenë Alaudin në Prishtinë, ndërsa Degën e gjuhëve orientale ne Fakultetin Filologjik në Prishtinë, ku edhe është magjistruar në shkencat e filologjisë. Që nga viti 1980 ka punuar në Bashkësinë Islame dhe ka qenë edhe ligjërues në Katedrën e Orientalistikës në Prishtinë gjer në vitin 1991 kur regjimi serb e largo me dhunë nga fakulteti, por ai edhe dy vite tjera punoi si ligjërues nëpër shtëpitë private. Pas vitit 1993 punoi në BIM dhe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup gjer në vitin 1995. Pas vitit 2009 e gjer më sot punon në BIM dhe si ligjërues në Katedrën e Orientalistikës në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Është marrë edhe me përkthime nga arabishtja dhe turqishtja. Është pjesëmarrës në disa simpoziume dhe konferenca shkencore ndërkombëtare. Përkrahës I lëvizjeve demokratike në Dibër e më gjerë. Ka dhënë kontribut të veçantë në themelimin e partive politike shqiptare në Dibër. Pas vitit 1990. Nismëtar dhe aktivist në pajtimin e individëve e familjeve në 180 raste konfliktesh të të gjitha niveleve e natyrave. Organizator për të ndihmuar materialisht dhe për të strehuar vëllezërit kosovarë. Organizator për Lëvzjen kombëtare shqiptare në Maqedoni dhe për nevojat e qytetarëve të Peshkopisë në krizën e vitit 1997 etj.
Për punën e bërë me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë dekorohet me Urdhrin "Qytetar Nderi" nga Këshilli Bashkiak i Peshkopisë. Ka bërë një punë të madhe në mbledhjen dhe ekspozimin e më shumë se 300 fotografive të personaliteteve dhe ngjarjeve të historisë së Dibrës së Madhe.

PËRFUNDUAN ZGJEDHJET LOKALE NË DIBËR TË MADHE

Mr.Ruzhdi Lata zgjidhet kryetar komune

Nga **REXHEP TORTE**

Më 24 mars 2013 si në tërë Maqedoninë edhe në Dibër të Madhe u mbajtën zgjedhjet për kryetar komune dhe për Këshillin Bashkiak. Në këto zgjedhje garuan Mr. Ruzhdi Lata, kandidat I BDI-ë, Mexhit Dika, kandidat i PDSH-së dhe Ibrahim Kolari, kandidat pavarur. Zgjedhjet kaluan në një atmosferë të qetë e dinjitoze. Në këto zgjedhje fitoi bindshëm Mr. Ruzhdi Lata me 6056, ndërsa Mexhit Dika fitoi 1144 vota dhe Ibrahim Kolari 1230 vota.

ÇFARË U THA NË MITINGUN ZGJEDHOR TË BDI-SË NË DIBËR TË MADHE

Në Sheshin "Skënderbe" të mbushur përplot me anëtarë dhe simpatizantë BDI mbajti mitingun zgjedhor në Dibër .

Ruzhdi Lata, kandidat për kryetar i Komunës së Dibrës, duke përshëndetur të pranishmit, tha, " Sot gjendemi në Sheshin "Skënderbe" që për mua është një shesh i shenjtë i të gjithë trojeve shqiptare, nga se në vitin 1463 për herë të parë Skënderbeu Kuvendin e parë shqiptar e ka mbajtë në Dibër, në këtë shesh. Dibranët me çiltërsinë e tyre i kanë shërbyer popullit shqiptar por edhe tërë Europës. Nga ky shesh u nisën për në luftën e Spanjës, Urfi Agoli dhe Ramiz Varvarica që t'i sjellin të mirë tërë Europës edhe të gjithë neve. Nga ky shesh në vitin 1878 u nis Iljaz Pashë Dibra që të kryesojë dhe investojë Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Nga ky shesh u nisën Haxhi Vehbi Dibra dhe Sherif Langu për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë në vitin 1912, nga ky shesh fatkeqësisht u nis në burgosjen në burgjet slave Dr. Kastriot Haxhirexha, bastioni i rezistencës shqiptare për kauzën shqiptare në përgjithësi. Po nga ky shesh u nis për në UÇK- në e të Kosovës. e pastaj të Maqedonisë gjenerali Gëzim Ostreni. Në këtë shesh qëndron pllaka përkujtimore që dibranët pritën dhe përcollën 5 mijë e 500 kosovarë. Kështu që e gjithë kjo për mua është një sfidë që të dal me një vizion për një Dibër më të madhe, më të mirë , më të pastër e të rregulluar ,për një Dibër e cila duhet të zen vendin e vet në trojet shqiptare, ashtu si thoshte Josif Bageri "Dibra është kërthinza e Shqipërisë".

"Unë dua që të jepni shanse të punoj e të angazhohem që Dibrës t'i rikthehet ky bagazh i madh historik, një dinjitet me vlera të jashtëzakonshme...."

"Ne kemi liqenin, një begati natyrore të jashtëzakonshme që do të merr pamje moderne me hotele, vila, rrugë, me infrastrukturë, sepse e kërkon koha. E dij se dëgjojnë bijtë dhe bijat tona në SHBA. Prej këtu i porosis "dyert do t'i keni të hapura, Komuna e Dibrës do të jetë e juaja dhe unë dua të shndërrohem ashtu siç jam shndërruar 35 vjet shërbëtori i juaj, bashkëpunëtori i juaj, pjesë përbërëse e familjes suaj, pjesë e Dibrës së Madhe."

"Infrastrukturës komunale i ka kaluar koha, ajo përfundimisht do të jetë e rregulluar, ne do ta rregullojmë Dibrën, ta ndalim mërgimin duke hapur vende të reja pune".

Unë dua që të jepni shanse të punoj e të angazhohem që Dibrës t'i rikthehet ky bagazh i madh historik, një dinjitet me vlera të jashtëzakonshme. Dibra e meriton një qendër më të rregulluar, nga se në Dibër ka pirë kafenë e konsultimit Abdyl Frashëri, andaj patjetër duhet që kjo qendër të merr tjetër pamje, duke gërshetuar klasiken me modernen, duke gërshetuar dinjitetet e dibranëve me ecurinë Eropiane. Pas vitit 1968 gjimnazi i Dibrës funksionon në një barakë e tani do të ndërtohet një gjimnaz i ri, që më jep guxim edhe më shumë , nga që një hoxhë para 120 vitesh Said Najdeni themeloi shkollën e parë në Dibër, e tani një hoxhë të nderojë gjimnazin e Dibrës. Ne kemi liqenin, një begati natyrore të jashtëzakonshme që do të merr pamje moderne me hotele, vila, rrugë, me infrastrukturë, sepse e kërkon koha.E dij se dëgjojnë bijtë dhe bijat tona në SHBA. Prej këtu i porosis "dyert do t'i keni të hapura, Komuna e Dibrës do të jetë e juaja dhe unë dua të shndërrohem ashtu siç jam shndërruar 35 vjet shërbëtori i juaj, bashkëpunëtori i juaj, pjesë përbërëse e familjes suaj, pjesë e Dibrës së Madhe.

Infrastrukturës komunale i ka kaluar koha, ajo përfundimisht do të jetë e rregulluar , ne do ta rregullojmë Dibrën, ta ndalim mërgimin duke hapur vende të reja pune. Deklaroj se çdo investues nga jashtë që do të dëshirojë të investojë, ai në komunë ka nevojë të vijë vetëm një herë. Dokumentacioni tjetër do të dërgohet atje ku ai jeton e punon. Dibra ka potencial mendor, arsimor dhe shkencor ndër më të mirët në trojet tona. Por ai duhet thithur e sjellë në Dibër. Dibra do t'i shërbejë Tiranës , Shkupit, Prishtinës,nga që ky qytet e meriton më shumë. Duhet të ecë me hapat më të sigurta të dinjitetit kombëtar dhe avancimit Europian.

Do të jem stimuluesi më i madh që në Dibër në dy sallat sportive që ne i kemi ndërtuar të kalitet dhe zhvillohet i riu dibran.

Dibra ke nevojë për bukën e gojës, por ajo bukë që të prodhohet këtu, me kthimin e sistemit të vaditjes. Dua të bëjmë disa punë me këshillin bashkiak por edhe me liderin Ali Ahmeti dhe Abdylaqim Ademin, Ministrin e ekologjisë një punë të madhe. Dibranët kërkojnë që të kenë një rrugë më të mirë që nga Sheshi Skënderbe të shkojmë në Uskanë, të shkojmë në Sheshin Nënë Terezë në Strugë. Ky është një obligim që kërkojnë dibranët, nga se atë s'mund ta bën komuna, por bashkarisht mund ta bëjmë, me përkrahjen e BDI dhe zotit Ali Ahmeti .Zoti na bekoftë, Zoti na bëftë zot në trojet tona", tha në fund Mr. Ruzhdi Lata.

Kastriot Haxhirexha, kryetar i DR, që është në koalicion zgjedhor me BDI, shtoi se, "Shpresoj se kryetari I gjysmës tjetër të Dibrës Ilir Krosi së bashku me kryetarin e ardhëshëm të Dibrës Ruzhdi Lata të punojmë bashkarisht fuqishëm për një kauzë të madhe . Në mjekësi dihet një sindrom për binjakët siamezë, kur dy fëmijë lindin të njëri me tjetrin dhe mjekësia moderne bën të pamundurën për t'i ndarë. Ju mbetet që këta dy binjakë siamezë, këta dy qytete të një trungu t'i bashkoni, dhe unë shpresoj se keni kapacitet që ta bëni këtë.

Në këto zgjedhje Ruzhdi Lata dhe bartësi I listës Bashkim Mashkulli janë janë të nderuar dhe të aftë me vision, por edhe njerëz të fjalës, të cilët synim kryesor në jetën e tyre kanë avancimin dhe prosperimin të Dibrës. Në këto zgjedhje kemi fatin falë insistimit dhe vendimit të z. Ahmeti që të dy këta kandidatë persona që nuk i takonin asnjë partie politike, Këto kandidatë u zgjodhën nga radhët e qytetarëve dibranë. Këta kandidatë të devotshëm edhe më tutje do ta kenë parti vetëm Dibrën, ndërsa anëtarë të partisë të tyre do të jenë të gjithë qytetarët dibran pa marrë parasysh përcaktimet partiake. Arsye e fortë që të përkrahim këta kandidatë është fakti që në programet dhe aktivitete e tyre do të kenë zhvillimin ekonomik, forcimin e sektorit privat, investimet e huaja , dhe të bashkëqytetarëve tanë nga SHBA për hapjen e vendeve të reja të punës dhe ndalimin e mërgimit të të rinjve. Këta dy persona janë të dëshmuar për përpjekjet e pareshtura për realizimin e shumë projekteve të rëndësishme kombëtare ose humanitare . Këta kandidatë kanë lidhje të ngushta shoqërore me shumë personalitete në Maqedoni, Shqipëri , dhe Kosovë", tha në fund Kastrot Haxhirexha.

Ali Ahmeti, lider BDI-së, , veç tjerash theksoi se, " Dibra si edhe gjer më tani do ta ketë përkrahjen tonë me projekte të kapshme dhe të rëndësishme zhvillimi. Nga ky tubim madhështor përshëndet motrat dhe vëllezërit nga diaspora që ta ndihmojnë vendlindjen nëpërmjet investimeve, si Dibrën, Tetovën, Gostivarin, Kërçovën, Shkupin e Kumanovën, sepse nuk ka vende më të bukura se këto për të jetuar . Apeloj te mërgata jonë që t'i kthejë sytë nga vendlindja,për ta ndalur mërgimin.

Bashkim Mashkulli, bartësi i listës së kandidatëve për këshilltarë foli për profesionalizmin, vetitë pozitive dhe gatishmërinë e këshilltarëve për prosperitetin e Dibrës së Madhe.

Kjo garniturë e zgjedhur e BDI-së me kryetar komune Mr. Ruzhdi Lata dhe me kryesuesin e Këshllit Komunal është shumë shpresëdhënëse për prosperitetin e Dibrës se Madhe.

Rruga e Arbërit nr. 83

Bashkim Lami, Qytetar Nderi i Bulqizës



"Për kontribut të veçantë si mësues në qytetin e Bulqizës, plot pasion e përkushtim, në mësimin dhe edukimin e brezave të rinj, si dhe kontribut të vlerësuar në zhvillimin e proceseve demokratike në vitet 1990 në trevën e Bulqizës".

Në një ceremoni vërtet mbresëlënëse për anëtarët e këshillit bashkiak, bashkëpunëtorët e bashkëqytetarët e shumtë, z. Bashkim Lami, iu dha titulli Qytetar Nderi i qytetit të Bulqizës, me motivacionin: "Për kontribut të veçantë si mësues në qytetin e Bulqizës, plot pasion e përkushtim, në mësimin dhe edukimin e brezave të rinj, si dhe kontribut të vlerësuar në zhvillimin e proceseve demokratike në vitet 1990 në trevën e Bulqizës".

Ish-themeluesi i Degës së Partisë Demokratike, Bulqizë, Bashkim Lami (njëherësh dhe kryetari i parë i kësaj dege) është nderuar nga këshilli bashkiak i qytetit verilindor me titullin "Qytetar Nderi i qytetit të Bulqizës".

Një ceremoni vërtetë mbresëlënëse për anëtarët e këshillit bashkiak, bashkëpunëtorët e bashkëqytetarët e shumtë të Z. Lami, të cilit iu dha titulli "Qytetar Nderi i qytetit të Bulqizës" me motivacionin: "Për kontribut të veçantë si mësues në qytetin e Bulqizës, plot pasion e përkushtim, në mësimin dhe edukimin e brezave të rinj, si dhe kontribut të vlerësuar në zhvillimin e proceseve demokratike në vitet 1990 në trevën e Bulqizës". Mësuesi shembullor i disa dekadave, në fundin e vitit 1990 me iniciativën e tij ka përkrahur lëvizjen studentore për vendosjen e pluralizmit politik e të demokracisë në Shqipëri. Në Bulqizë bashkë me demokratë të tjerë themeluan degën e PD-së dhe është zgjedhur kryetari i parë i kësaj degë të PD-së.

Në tetor të vitit 1991 me konsensus politik ju besua detyra e Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të qytetit Bulqizë, kur gjendja social-ekonomike ishte shumë kritike, pasi populli i qytetit dhe i fshatrave furnizohej me tollona. Ai me një komunikim të ngrohtë e njerëzor arriti të kapërcej vështirësitë dhe të normalizoj gjendjen. Realizoi pasaportizimin në qytetin e Bulqizës, për të gjithë punëtorët që e donin këtë, duke thyer këtë tabu të pushtetit komunist.

Në maj 1992, Bashkim Lamit i besohet detyra e Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Rajonit Bulqizë. Arriti të marrë pjesë me përfaqësuesit demokratë në strukturat e administratës që u krijua dhe punoi me përkushtim, për të ngritur imazhin e PD-së në popull. Kuadrot e ri demokratë ishin çdo ditë përballë veprimtarisë shpifëse të sigurimit të shtetit, që punonin për t'i mbajtur shpirtin pushtetit të kalbur komunist dhe për të maskuar bëmat e tyre çnjerëzore të 50 viteve në diktaturë. Në këtë kohë, kanë arritur të organizojmë forcat intelektuale të Bulqizës në të gjitha strukturat dhe i propozuan qeverisë së re, për krijimin e "Rrethit të Bulqizës". Në muajin maj 1992, qeveria e re demokratike miratoi krijimin e rrethit të ri të Bulqizës, duke u veçuar nga rrethi i Dibrës. Qyteti i Bulqizës në zgjedhjet e reja lokale të korrikut u organizua të funksionojë administrativisht si bashki.

Në gusht 1993, Bashkim Lami, u rizgjodh Kryetar i Këshillit të Rrethit Bulqizë, me një mbështetje të gjerë të këshilltarëve të të gjitha partive politike. Arriti të formojë një administratë aktive në kryerjen e detyrave të kohës, ku punohej ndershmërisht e me vendosmëri në zbatimin e ligjeve të reja të Parlamentit e të qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Në nëntor 1993, u caktua të marrë pjesë si delegat në kongresin e autoriteteve lokale të organizuar nga KE në qytetin e Selanikut në Greqi, me pjesëmarrës nga të gjitha shtetet e Ballkanit. Detyrën e Kryetarit të Këshillit të Rrethit Bulqizë e vazhdoi deri në fund të vitit 1996. Më pas, deri sa doli në pension dha kontribut të vyer në dhjetëra detyra të tjera, në institucionet e rrethit të Bulqizës, por dhe në Tiranë. Si i tillë, më 1993 është dekoruar nga Presidenti Sali Berisha me urdhrin "Naim Frashëri", "Për punë të pa lodhur në edukimin shkencor e atdhetar të brezit të ri".

Me rastin e 7 marsit 2013, "Ditës së mësuesit", Drejtoria e Shkollës Mesme të Bashkuar "M. K. Ataturk" ka nderuar me Certifikatë Nderi, z. Bashkim Lami, me motivacionin: "Për kontributin e madh në mësimdhënie të standardeve bashkëkohore dhe në edukimin e nxënësve, për punën e palodhur e plot pasion në formimin e gjithanshëm të brezit të ri, në përmbushjen me nder të misionit fisnik të mësuesit, gjithnjë pranë nxënësit e prindit, i komunikueshëm me komunitetin dhe aktivist i dalluar në veprimtaritë shkollore".

Pasionin për librin e mban në intensitet si gjithmonë. Ai gjen mundësi të lexoj, të sistemoj e të shkruaj diçka për vendlindjen, për jetën dhe për punën. Ka botuar vazhdimisht artikuj në gazetat "Bulqiza", "Rruga e Arbrit", "Dibra", "Rilindja Demokratike", "Mësuesi", "Koha Jonë", etj. Ai ka mbajtur referate në sesione shkencore për pasqyrimin e historisë së Bulqizës. Në kuadrin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, ka përfunduar shkrimin e librit "Qëndresa e bulqizakëve në luftërat e viteve 1912-1921" që do ta botojë së shpejti. Mjaftë mbresëlënëse qe përshëndetja e Arjolës, në emër të nipërve e mbesave e cila ndër të tjera u shpreh: "Kemi nderin të jemi nipërit dhe mbesat e Bashkim Lamit. Për gjyshin tim, do të shkruaja një roman të tërë, por sot do mundohem t'jua përshkruaj me pak fjalë. Përveç kontributit që ka dhënë në arsim dhe politikë për zonën, gjyshi ynë është shembullor edhe në familje. Për ne është mësues, është gjysh, është prind dhe shok i mirë. Ai është gjithmonë i pranishëm për të na ndihmuar në çdo aspekt duke transmetuar tek ne inteligjencë, mirësi, urtësi, drejtësi, ndershmëri dhe, mbi të gjitha, krenari. Çdo ditë marrim drejtim dhe forcë prej gjyshit tonë për të qenë sa më të denjë në shoqëri. Shpresoj që një ditë ai të jetë krenar për ne siç jemi dhe ne për të". Këto cilësi të mrekullueshme të Bashkim Lamit u transmetuan, më së miri, nëpërmjet dokumentarit kushtuar atij që u shfaq dhe u ndoq me interes të jashtëzakonshëm nga pjesëmarrësit e shumtë në këtë ceremoni festive.

H.Rama

Petrit Bara, "Qytetar Nderi" i Peshkopisë



"Vlerat njerëzore çmohen nga njerëzit e mençur". Kjo sentencë, bashkudhëtare e historisë së njerëzimit, gjen mishërim të plotë në propozimin e kryebashkiakut Ilir Krosi dhe në vendimin e këshillit bashkiak të Peshkopisë për t'i dhënë prof. dr. Petrit Barës titullin "Qytetar Nderi i Peshkopisë". Kurorëzimi i këtij titulli sinjifikativ, ndodhi gjatë një ceremonie mbresëlënëse që Bashkia e Peshkopisë organizoi më 13 mars 2013 në pallatin e kulturës. Deputeti Sherefedin Shehu, kryebashkiakët e Peshkopisë, Bulqizës e Dibrës së Madhe, anëtarët e Këshillit Bashkiak, intelektualë dibranë të të gjitha trevave, mes të cilëve edhe mjeshtri i madh Bujar Kapexhiu, nderuan dekanin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Petrit Bara, i cili demonstron një model të ri sjelljeje dhe përkushtimi ndaj bashkëqytetarëve të vet.

Petrit Bara lindi më 11.1.1952 në Peshkopi. Përveç diplomimit si mjek në Universitetin e Tiranës më 1977, me rezultate të shkëlqyera, kreu specializimet jashtë shtetit për terapi intensive koronare dhe ekokardiografi në Turqi (Ankara), Trafik Hastanesi, 6 muaj (korrik – dhjetor 1992); emergjenca kardiovaskulare, terapi intensive, ekzaminime joinvazive (Holter, Ekokardiografi, Prove ushtrimore) në – Itali (Bari), Policlinico di Bari (Pergjegjes – Prof. Ritzon) 3 muaj (korrik – tetor 2001) dhe sërish – Itali (Rome), Ospedale Sandro Pertini, shtator 2004.

Si njohës në mënyrë perfekte i tri gjuhëve të huaja (anglisht, gjermanisht dhe rusisht), prof. dr. Petrit Bara, do të udhëheqë ndër vite titujt e projekteve: Hipertensioni arterial dhe komplikacionet e tij – më 1998, si dhe Infarkti akut i miokardit dhe rehabilitimi i tij më 2001. Po ashtu ai njihet në rrethet akademike e shkencore si botues i disa teksteve me vlera të pallogaritshme shkencore, si:Trajtimi farmakologjik i urgjencave kardiovaskulare, Sëmundjet e brendshme, Trajtimi i urgjencave hipertensive (monografi),Statistika – Tekst për shkollat e larta te infermierisë, Shëndeti Publik – Manual për shkollat e larta te Infermierisë, Sëmundjet e brendshme, Fakulteti i Infermierisë dhe Fiziologjia patologjike. Po ashtu prof. dr. Petrit Bara, si një nga personalitetet më në zë të kardiologjisë njihet si kryeredaktor i revistës "Infermieria dhe mjekësia bashkëkohore" (prej 3 vitesh në vazhdim) dhe si pedagog pranë Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, që nga viti 2003 për lëndën e fizio-patologjisë.

Në këtë profil punoi me devotshmëri e përkushtim si mjek kardiolog, shef i pavijonit të kardiologjisë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" të Tiranës, si pedagog dhe dekan i Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Personaliteti dhe karakteri i tij në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos dinjitoz për më shumë se dy dekada në funksion ët zhvillimit dhe modernizimit të shkencave mjekësore.

Prof. dr. Petrit Bara ndihet tejet i nderuar si "Qytetar Nderi" i tri qyteteve të njohura në hapësirën mbarëshqiptare: Peshkopisë që është dhe vendlindja e tij, Tetovës dhe Dibrës së Madhe. Nderimin që i kanë bërë këshillat bashkiakë e komunalë të këtyre tri qyteteve e quan të pakrahasueshëm me çfarëdo nderimi tjetër. "Fjalët më mungojnë për të shprehur gjithë mirënjohjen time për këtë. Prej më shumë se një dekade jeta ime u lidh fort me këto qytete, me Universitetin e Tiranës e Tetovës, me formimin e edukimin, me spitalet e klinikat, me jetën e qytetarëve", – tha Bara. Sipas tij, të jesh "Qytetar Nderi" i Peshkopisë, Bulqizës, Tetovës e Dibrës së Madhe do të thotë të dish të nderosh vlerat më të rëndësishme të këtyre qyteteve të bukur, të mbushur me shqiptari dhe me arsimdashje, të orientuar saktë drejt së resë dhe progresit.

H.RAMA

Peshkopi, Bajram Alush Stojku i jepet titulli "Qytetar Nderi"

Me datën 15 mars 2013, në Pallatin e Kulturës "Haki Stërmilli" Peshkopi u zhvillua ceremonia për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" të qytetit të Peshkopisë Bajram Alush Stojkut. Ishin të pranishëm familjarë, shokë e miq si dhe qytetarë të ardhur posaçërisht për këtë evinement të bukur. Mbresa dhe kujtime të bukura nga jeta dhe veprimtaria e Bajramit sollën Rahman Çenga,Isak Plaku e Sabri Uta. Kryetari i bashkisë zoti Ilir Krosi në emër të Këshillit bashkiak lexoi vendimin e këtij këshilli mbi dhënien e titullit "Qyetar Nderi" Bajram Stojku me motivacion:"Për kontributin, përkushtimin dhe pasionin pozitiv në vite për ndërtimin, përparimin dhe zhvillimin e gjithanshëm të qytetit të Peshkopisë dhe rrethit të Dibrës".Në fund zoti Bajram Stojku falenderoi Këshillin bashkiak për këtë vlerësim të madh që i bëjnë.

Bajram Stojklu lindi në qytetin e Peshkopisë me 10 Tetor 1934 në një familje me tradita patriotike, atdhetare dhe pjesëmarrëse në të gjitha luftrat kundër turqve, serbëve, italianëve dhe gjermanëve.

Përveçse një punonjës e drejtues i palodhur, këmbëngulës dhe i paepur, Bajrami ka qënë dhe është një prind i devotshëm. Ai ka rritur dhe edukuar pesë fëmijë, të cilët janë të nderuar e respektuar në qytetin e tyre, pavarësisht se nuk jetojnë këtu. Ata sot janë pesë familje me nipër, mbesa e stërmbesa që janë krenaria e gjyshit dhe e stërgjyshit të tyre.

Nderimi që i bëhet sot nga qyteti i tij, është pika kulminante e vlerësimit të punës së Bajram Stojkut. Ky nderim vjen në prag të 80 vjetorit të tij, dhe pikërisht nga ky qytet, ku lindi, u rrit, u burrërua, punoi dhe iu përkushtua me gjithçka dhe në gjithçka.

Shënim i redaksisë:

Një biografi më të hollësishme të Bajram Alush Stojkut do ta pasqyrojmë në numrin e ardhshëm të gazetës.

vështrime

- Meditime duke parë fotografi me shkrepje... '91 e kujtimesh... '60.

Pamje që më ngjethin mishtë…dhe më mbysin në kujtime

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Një pamje që dua ta heq nga kujtesa por nuk mund ta bëj. Sido që mundohem ajo më del përpara, më del e më shfaqet nga truri elektronik i kompjuterit.


Dua të çlirohem prej saj ndaj po shkruaj, po meditoj, po fluturoj më se pesë dekada më parë.

Fotografia e parë, që të jem i sinqertë me lexuesin, është e vitit 1991 apo 1992. Është fiksuar nga kthesa e rrugës që nga njëra anë të çon në Muhurr e nga ana tjetër të çon në Peshkopi.

Për sqarim të atyre që se njohin vendin po përsëris se poshtë xhadesë, në të majtë, është fshati Rreth-Kale, një fshat i vogël me shtëpi mbi rrjedha burimesh diku-diku me bërraka, midis dy kodrave, Gjaricës dhe Pasmarit që në lartësi maten me njëra tjetrën e në pikëmbështetje duken sikur janë ulur këmbëkryq e sodisin nga njëra anë vargmalet në lindje me Korabin në krye e nga ana tjetër me Runjën e Gjagjishtin në perëndim. Nën këmbët e kryqëzuara, gati në gjysmën e harkut, edhe Gjarica edhe Pasmari kanë Drinin e Zi.



Ura e Muhurrit-Gjarica 1991



Gjarica-Rreth Kale 1991

Më tutje, përsëri majtas, duken disa shtëpi të fshatit Vakuf, kodra e fusha-Livadhet e Frangut (që kur ishim në shkollë fillore aty e bënim piknikun pranveror) që së bashku me Gjaricën e Pasmarin i kishin mbledhur dy katundet siç mblidhen thekët dhe pistili i mollëve në kupë lulesh maji, pemësh ku mbretëresha e mollëve të tavolinës, "Renet Canada" dhe mbreti i mollëve me emrin kuptimplotë që e zbërthen vetëm anglishtja "Star-king", "Ylli - Mbretëror", ishin në sofrën e shtëpisë së tyre, ashtu siç ishin në tavolinat e Evropës tej e tej. Nami i sektorit të Zdojanit dhe i Kastriotit në tregjet e vendit dhe ndërkombëtare buronte pikërisht nga rrënjët që ushqenin mollët, nga duart punëtore të fshatarëve të Rreth Kales, Muhurrit, Zdojanit, Vakufit...



Cen Mikli



Blloku frutor i Zdojanit

Më tutje, mbi të tjera kodra duket Zdojani dhe Brezhdani-djathtas e tej një copë nga një kodër e famshme për kumbullat tropojane, të ëmbla mjaltë, të shkëlqyeshme për konservim e për tharje, Kubeni...

Tutje-tutje, në prehër të vargmaleve të Deshatit, Skërtecit e Valivarit - Peshkopia me kurorën e bardhë - dimrit e të blertë - verës bjeshkësh, njëra më e bukur se tjetra e burimesh akull të ftohta uji bore...

Fotografia e dytë, e fiksuar në të njëjtën ditë diku nga një rrugicë që zbret nga Kodra e Rame të Muhurrit, në të majtë ka një fragment rruge që ka marrë emër të përveçëm nga puna vullnetare e rinisë gjatë pranverës, verës dhe vjeshtës së parë e të dytë të vitit 1946: "Rruga e Rinisë Kukës-Peshkopi". Ura, me këmbë të ngulura që në kohën e Italisë e plotësoi trupin e hekurt më vonë, pas lufte. Kodra në të djathtë është pjesë e Gjaricës, kurse pemishtja në të majtë me kullën e moçme të dinastisë me emrin Dine Hoxha flet me gjelbërimin përballë lakuriqësie brezaresh që më dhembin. Ura, po të vësh në punë pak me kujdes syrin, përshkohet nga një tub metalik, tub çeliku me një diametër diku tek 500 milimetër që në fundvitet '60-të mori ujin e Murrës dhe me vetërrjedhje e ngjiti në majë të Gjaricës për ta shpërndarë mbi shtatin e saj dhe të fushës nën këmbë, Livadheve të Frangut e Çapit të Brezhdanit.

Në tërë këto pamje nxjerrë nga kujtesa e gjallë e jetës sime më vjen një pamje "natyrë mort". Brezare të zhveshura nga bimësia, dele që kullotin atë pak barë që u jep natyre, një grua me barrë mbi shpinë, barrë e mbledhur nga një masakër bimore, mbeturina të atyre që la sëpata, shkallë të thata që i ngjiten kodrës me mundim...

Këtyre shkallëve, tabanit të brezareve, në vitet '60-të u ngjitën arrat, të parat arra në blloqe frutorë kultivuar nga njeriu shqiptar, më i madhi (thuhej) në Ballkan...

Jam dëshmitar jo vetëm me sy por edhe me krah i kësaj nisjeje. Isha agronom i mesëm dhe isha ftuar që të piketoja vendet ku do të hapeshin gropat e mbilleshin arrat. Xhavit Hysa ishte arkitekti i krijesës së re. Unë me të, e përballë tij, isha një djalë i ri, një djalë që ai do të më mbillte në zemër dashurinë për pemëtarinë, dashuri që do ta përjetoja më fort e më thellë pesë vjet më vonë kur përsëri bashkë do të piketonim bllokun frutor me pesëdhjetë mijë rrënjë kumbulla, arra dhe gështenja të Qenokut. Nuk ishte i vetmi, ishin edhe të tjerë...Idriz Lala, Mehmet Hajrullai, Xhetan Xhika...

Xhaviti ishte shumë racional dhe largpamës. Arrat i piketuam dhe i mbollëm në distanca 8 me 8 metra, ngushtë për biologjinë e arrës por me mendimin që kur bimët të takonin degët e tyre, një rresht të pritej për të kaluar në 16 me 16 metra dhe drurët e prerë të kalonin në përpunim industrial për prodhimin e rimesos së arrës, aq e çmuar dhe e kërkuar në prodhimin e mobilieve të kohës.

Në Qenok, Xhaviti, tash pas shumë vite përvoje mes rreshtave të arrave do të fuste kumbullat, jetëgjatësia e të cilave e shumta shkonte në 30-40 vjet e pasi të priteshin arra do të ishte në gjallërinë e saj biologjike. Kush donë ta shohë këtë, kur arrin të përpjetën e Qenokut, aty ku është një karburant, le të hedhë vështrimin poshtë. Arrat e mbetura nga kujdesi i pronarëve të ish zabelit të dushkut i kanë "mundur" plotësisht kumbullat që tash vetëm tek tuk mund ti shohësh...

Fotografia e tretë dhe e katërt më vijnë nga rreshtat e pemëve, njëra tek krasiten pemët e bllokut të Zdojanit e tjetra nga mjeshtri i pemëtarisë, brigadieri i njohur i Zdojanit Hysen Mikli...

... Kisha muaj që këto rreshta i kisha hedhë në zarfin"Për botim", zarf në të cilin fus shënime të prera në mes. Do ti kisha lënë atje mes shënimeve të tjera jetime sikur Mond Hasani mos ishte ngjitur një ditë për të përshkuar tërë kurrizin e Gjarajcës e për të më mbledhë një nyje në shpirt, nyje kujtimesh që lidhen me tërë zonën që në një rreth treqind e gjashtëdhjetë gradësh kishte fotografuar e përcjellë në facebook. Dua ta falënderoj Mondin për fotografitë, të gjitha fotografitë që përcjell në internet nga Katër Grykët e Murrës në Kalanë e Zagradit e gjerë e gjerë sa të kap syri.

E pashë me zemër në dorë Gjarajcën, luginën e Drinit, Brezhadanin, Çapin pjellor si asnjë fushë tjetër, fiksova në horizont Katundin e Ri e Lusninë, pashë ujëmbledhësin artificial të Zdojanit ngritur mbi tokat e fisit të Zhuzheve me banim në Rreth-Kale e Brezhdan, Pullazhinat dhe Livadhet e Frangut...

Midis pamjeve poshtë të cilave një piktor do të shkruante "Natyrë mort", pashë edhe një ngastër të vogël, pak poshtë grumbullit të shtëpive të Mane, ngastër të mbjellë me mollë në distanca të afërta...

Më ngrohu pamja. Shpresoj që të zgjerohet e zgjerohet, të pushtojë Livadhet e Frangur dhe Pullazhinat, pse jo edhe kodrën e Gjarajcës dhe Pasmarit.

Shpresoj...


Athinë, 23 mars 2013



Ujëmbledhësi në tokat e fisit Zhuzhe



Lagja e fundit e Zdojanit, Manet



Fshati 'Gropa' ka qenë në Grykën e Madhe në rrethinat e Zerqanit

Nga **Destan RAMA**

Ne librin e tij monumental 'Historia e Dibres' Profesor Kristo Frasheri shkruan:

Si deshmi per strukturen shoqerore ne Dibren e Eperme ne kemi nje akt te kancelarise anzhuine- nje diplome te Karlit te i Anzhuin, mbretit te "Mbreterise se Arberise" , leshuar me 18 maj 1273,ne favor te sevastit Pal Gropa.

Mbiemrin e tik ky sevast duket se e kishte marre nga emri i fshatit 'Gropa', nje vendbanim me kohe i zhdukur, i cili ka ekzistuar ne rrethinat e Zerqanit. *(Kristo Frasheri 2012 fq.78.)*

Po. Ky fshat ketu ka ekzistuar. Kete na e deshmojne dokumentet dhe faktet ne vijim . Dokumenti i pare dhe me kryesori eshte libri 'Historia e Dibres', ne te cilin autori thekson: Viset e dhuruara duket se pajtohen me faktin se Gropajt sikurse u tha ishin me origjine nga fshati sot i zhdukur 'Gropa', qe dikur ndodhej ne Gryken e Madhe te Dibres se Eperme. (Kristo Frasheri 2012, fq. 83)

Mendoj se autori Prof. Kristo Frasheri me kete thenje nuk na le me shteg per diskutim, per vendodhjen e fshatit Gropa.

Fakti se familja Gropaj, banonte ne nje fshat te Grykes se Madhe ne rrethinat e Zerqanit, nuk do te thote se kjo familje kishte ne zoterimin e saj gjithe Gryken e Madhe (Zerqanin), perpara se te merrte diplomen e cituar me lart.

Dy tregimtaret popullore, Isa Kola nga fshati Sopot (rreth te 90-tave) dhe Naxhi Hasa nga fshati Strikcan, nisur nga thenjiet e brezave te meparshem pohojne : Fshati ' Gropa' ka qene i vendosur midis Fushes se Sopotit dhe kroit te Sadikut, ne jug te fshatit Sopot. Me kalimin e viteve banoret e tij u bene zoter te malit. Fshati dallohej per klimen e bukur, me dimer pak a shume te ashper dhe me vere te fresket. Banoret merreshin me blegtori dhe me bujqesi. Relievi i vendit ku ishte i vendosur fshati vinte ne formen e nje kupe. Banoret i takonin besimit katolik. Ne krye te fshatit kishn kishen ne te cilen kryenin ritet fetare. Rrenojat e saj jane edhe sot. Po keshtu duken edhe muranat e shtepive te fshatareve, si edhe varrezat e fshatit qe sot njihen nga banoret me emrin Varrezat e Kaurreve.

Familja me e mekembur e fshatit kishte qene ajo e Gropajve. Kjo familje u largua nga ky fshat, pasi kishte pasur shume pretendime per te ardhmen, per nje jete me te mire. Ndaj ne fillim u vendos ne Dibren e Madhe. Me vone, pas nje viti, siç deshmon historia e saj, familja e Gropajve u kthye ne nje familje dinastike teper e fuqishme, e cila seline e vet e shperngguli nga qyteti i Dibres ne qytetin e Ohrit. (Kristo Frasheri 2012, fq. 83 – 84).

Me pas ne kete fshat u shqua familja Doshlli (Doçi). I pari i tyre ishte nje katolik i ashper. Shpejt futi nen zoterimin e tij tere malin. Ndertoi disa objekte ne sherbim te fshatareve, si: Çezmen e ujit qe sot nihet me emrin 'Kroi i Kalorses'. Me kryesore ishte ndertimi i mullirit, ku fshataret bluanin dritherat e tyre per buke. Mullirin e ndertoi ne perruan e Strikçanit ne lindje te fshatit 'Gropa' , pasi aty kishte uje te bollshem per nje objekt te tille. Me mullirin ka lidhje toponimi' Mulliri I Doçit' qe perdoret edhe sot ne te foluren e banoreve te zones.

Ne veri te fshatit 'Gropa' ndodhej fshati Sopot. Shpesh here banoret e ketyre dy fshatrave konfliktoheshin, per arsye se ata te fshatit 'Gropa', si zoter te malit qe ishin, pengonin kullotjen e bagetive te sopotareve. Per kete kreret e dy fshatrave duhet te negocionin per te zgjidhur, (normalizuar) problemin e malit. Mbledhjet (kuvendimin) e benin ne nje vend qe ishte ne rrethine te fshatit, qe njihej me emrin 'Kuvenes'. Ky ishte nje vend i sheshte i rrethuar me shkallare guri. Edhe sot ekziston toponimi 'Kuvenes'

Nisur edhe nga presioni i madh qe ushtronin sopotaret ndaj banoreve te fshatit 'Gropa' si zoter te malit, po edhe faktoreve te tjere, familjet e fshatit filluan te largoheshin ne vende te tjera. E fundit u largua per ne Lure familja Doçi. Qe nga kjo kohe fshati u braktis dhe u zhduk edhe si emer. Tanime ketu filluan te banonin pak familje nga fshatra te tjere te Zerqanit qe merreshin me blegtori, sidomos gjate stines se veres. Fshati u njoh me emrin 'Katunes' . Me kete emer lidhet toponimi 'Fshati Katunes'.

Fshati Gropa ka qene edhe vendpushimi per kaloresit qe udhetonin ne rrugen e vjeter, gjurmet e seciles jane edhe sot, ne drejtimin lindje perendim: Ura Spile - Qafa e Çerenecit -Shkembi i Ures (ure mbi lumin Okshtun) - Strikçan, - fshati 'Gropa' ,Varret e Vrame e me tej. Ne hyrje te fshatit' Gropa ' ishte kroi i Kalorses . Ketu kaloresit benin pushim, pinin uje, rifreskonin forcat , zgjidhnin ndonje hall qe u kishte dale gjate rruges me ndihmen e fshatareve dhe niseshin per rruge. Me kete krua, ku pushonin kaloresit, lidhet toponimi ' Kroi I Kalorses'.

Ju faleminderit Prof. Kristo Frasheri per sihariqin e madh qe na dhate. Ne Zerqanasit njohem nje fshat tonin qe shekujt na e kishin fshehur ne gjirin e tyre per te mos e njohur kurre. Na bëte te jemi krenare me kete fakt . U njohem me prejardhjen e familjes 'Gropa', me pinjollet e saj, te njohur ne histori, Andrea Gropa , Pal Gropa , zakaria Gropa, qe paskan pasur gjak nga i yni. Ne u gezuam pa mase, ashtu siç gezohet prindi, kur gjen femijen e humbur pas shume vitesh.





Mësuesi i mijëra mësuesve

Lidhja e Intelektualëve Dibranë organizoi me rastin e 7 Marsit, një pasdite festive kushtuar Mësuesit të Popullit, Prof.dr. Nuri Abdiu

PËRSHËNDETJA NË EMËR TË KRYESISË SË LID, NGA PROF.DR.EDLIRA HAXHIYMERI



Profesor Nuri Abdiu bën pjesë në atë plejadë intelektualësh që vunë gurë themeli në arsimin kombëtar dhe luftuan pa ndërprerë për ta përsosur atë - mbi 50 vjet pedagog janë një jetë e tërë në shërbim të çështjes së madhe, arsimit kombëtar.

Shkodra dhe Instituti i Shkodrës janë vatra të arsimit kombëtar që mbushën Shqipërinë me mësues e mësuese dhe ku, pa dyshim, shquhet, qysh në krye të herës, si smerald, kontributi i padiskutueshëm dhe shumëdimensional i profesor Nuri Abdiut.

I nderuar profesor Nuriu!

Të nderuar familjarë, miq, bashkëpunëtorë, studentë dhe bashkëkohës të profesor Nuriut!

Eshtë një kënaqësi e veçantë për ne, veçanërisht për mua, që të kemi sot midis nesh "Mësuesin e Popullit", profesorin dhe doktorin e shkencave psikologjike, nënkryetarin e shoqatës mbarëkombëtare të psikologëve, konsulentin e revistës shkencore "European Psychologist", njeriun e dekoruar me urdhërin 'Naim Frashëri' të Klasit të Parë, Kryetarin e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, njeriun që flet bukur, që shkruan bukur, që paraqitet kudo me fisnikëri, Prof. Nuri Abdiun. Eshtë një rast i lumtur për të gjithë ne që të kremtojmë e festojmë së bashku 7 Marsin, ditën e mësuesit dhe 83 vjetorin e lindjes së profesorit të nderuar.

Ne, i nderuar profesor Nuriu, vendosëm të gëzojmë sëbashku në ditën tuaj të lindjes. Ju, profesor i nderuar, dukeni sot shumë më i ri, më energjik, më sfidant se kurrë i viteve që rregjistrohen formalisht në pasthëniet e librave tuaj, libra të cilat koha nuk do të mund t'i zverdhë kurrë.

Të nderuar pjesëmarrës! Më duhet të nënvizoj që në fillim se nuk e kisha aspak të lehtë të qëmtoja e të radhisja këto fjalë zemre që, edhe kështu, mund të jenë të varfëra përpara jetës dhe kontributit të prof Nuriut. Jeta e tij tepër aktive, kontributet e vyera, personaliteti i tij shumëdimensional, rrethi i gjërë i bashkëpunëtorëve, numri i madh i studentëve, fisi i madh dhe lidhjet e shumëfishta për arësye njerëzore, e bëjnë figurën e profesor Nuriut intriguese dhe të dëshirueshme për ta hulumtuar, por edhe të vështirë për ta prezantuar në një mbrëmje si kjo.

Megjithatë, e kemi marrë rrezikun në sy dhe shpresojmë që t'ja dalim....

Ç'do njëri prej nesh do të ishte fatlum që të përjetonte një ditë të tillë të shënuar mes një auditori të tillë të nderuar e të respektuar. Kam nderin dhe emocionin e vecantë të përcjell disa nga vlerësimet që të gjithë: bashkëpunëtorët, profesorët, shkencëtarët, studentët, të afërmit dhe familjarët kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë për profesor Nuriun!

Edhe pse kontributi shkencor, profesional, por edhe shoqëror i Prof. Nuriut është i pasur dhe i gjërë, më lejoni, të nderuar pjesëmarrës, të ndalem në disa momente të rëndësishme:

Profesor Nuri Abdiu bën pjesë në atë plejadë intelektualësh që vunë gurë themeli në arsimin kombëtar dhe luftuan pa ndërprerë për ta përsosur atë - mbi 50 vjet pedagog janë një jetë e tërë në shërbim të çështjes së madhe, arsimit kombëtar.

Shkodra dhe Instituti i Shkodrës (sot Universiteti Luigj Gurakuqi) janë vatra të arsimit kombëtar që mbushën Shqipërinë me mësues e mësuese dhe ku, pa dyshim, shquhet, qysh në krye të herës, si smerald, kontributi i padiskutueshëm dhe shumëdimensional i profesor Nuri Abdiut.

(Vijon në faqen 12)

KRONIKA

(Vijon nga faqja 1)

Zonja Tefta Cami, ish ministre e arsimit, në fjalën e saj e quajti Prof. Nuri Abdiun si një misionar i ngritjes së katedrës së psikologjisë në Shkodër ku çdo gjë e nisi nga e para."Sot e them me bindje se Prof. Nuriu e ka sfiduar moshën". Në emër të Universitetit jo publik Albanian University përshëndeti rektori i këtij universitetit zoti Pavli Kondo, i cili foli gjatë mbi periudhën kur Prof. Nuri Abdiu drejtonte departamentin e psikologjisë në këtë universitet. "Prof.Dr. Nuri Abdiu është themelues i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme dhe drejtues shkencor i Fakultetit të Shkencave Sociale të Albanian University, është dhe do të mbetet një figurë e nderuar në fushën akademike ashtu dhe në atë shkencore si dhe një emër i nderuar në arsimin jo publik në vendin tonë", tha në fjalën e tij rektori.

Zoti Shemsi Manjani, ish drejtues i arsimit të rrethit Dibër, bashkënxënës me i Prof. Nuriun, ngriti lart figurën e profesorit dhe të familjes së tij si një element që e lartëson akoma më shumë këtë emër të nderuar, jo vetëm të Dibrës por edhe të gjithë Shqipërisë .

Një ndjesi të veçantë këtij aktiviteti i dha muzika e bukur e interpretuar me violinë dhe organo nga muzikantet e famshëm të familjes Qerimi.

Mes cicërimave të zogjve të dala nga violina dhe tufave me lule e mori fjalën Prof. Nuriu, i cili përshëndeti dhe falenderoi të gjithë të pranishmit, Kryesinë e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, ish kolegët e tij të Universitetit të Shkodrës, të Albanian University , miqtë, shokët , familjen, dhe sponsorin e këtij aktiviteti.

Në fund, moderatori i këtij aktiviteti, zoti Shpëtim Cami, i ftoi të pranishmit për të vazhduar urimet dhe përshëndetjet në koktejin e organizuar për këtë rast, ku të gjithë sëbashku tokën gotat për festën e 7 Marsit dhe përvjetorin e lindjes së Prof. Nuri Abdiut.

Kjo veprimtari, ashtu si edhe shumë të tjera të shoqatës së Lidhjes Intelektuale Dibrane, u sponsorizua nga zv/kryetari i shoqatës së LID, biznesmeni Musa Rriçku. / ***Korresp. Rr.A.***



Në foto (Lart): Anëtarët e Kryesisë së Lidhjes së Intelektualëve Dibranë (nga e majta në të djathtë: Shpëtim Cami - Sekretar i përgjithshëm, Bashkim Lleshi, Demir Osmani, Nuri Abdiu - Kryetar, Edlira Haxhiymeri- Zv/kryetare, Shaban Bitri, Musa Rriçku- Zv/kryetar, dhe Hasan Çipuri.
Foto poshtë: Pamje nga salla. Fotot: ©

Mësuesi i mijëra mësuesve

"Prof. dr. Nuri Abdiu është një nga studiuesit më të shquar shqiptar në fushën e psikologjisë.... "
Akademik Bedri Dedja

Gjithashtu, akademiku Bedri Dedja, në librin e tij "Nëpër ravat e jetës", që i ka dhuruar Prof. Nuriut, ka shënuar: "Nuri Abdiut, kalorësit të psikologjisë... Me respekt autori, 29.5.2001"

"Ndiej krenari që në gjirin e popullit shqiptar lindi dhe arriti të afirmohet një studiues i zhvillimit të mendimit psikologjik shqiptar dhe të bukurisë zhvillimore të botës shqiptare. Duke përkujtuar dhe nderuar tetëdhjetë vjetorin e jetës dhe të aktivitetit tuaj, ne nderojmë atë personalitet që bëri shumë për mendimin psikologjik dhe zhvillimin e tij por edhe si pedagog universitar i psikologjisë që keni vënë bazat e këtij mendimi në mësimet e larta të universiteteve shqipfolëse të viteve të gjysmës së dytë të shekullit njëzet duke u bërë nismëtar i studimit të historisë së mendimit psikologjik shqiptar".

Prof. PAJAZIT NUSHI, zv. Kryetari i Akademisë së Shkencave të Kosovës

(Vijon nga faqja 11)

Prof. dr. Vehbi Hoti, në fund të parathënies "Psikologjia e Hasan Tahsinit", përgatitur nga Prof. Nuri Abdiu, nënvizon se Prof. Nuriu është nismëtari i studimit të historisë së mendimit psikologjik shqiptar, më i angazhuari dhe më i përkushtuari.

Akademiku Bedri Dedja,në "Dy fjalë si parathënie për librin e Nuri Abdiut "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar" (deri më 1939) (Tiranë, 2001) shprehet se: "Prof. dr. Nuri Abdiu është një nga studiuesit më të shquar shqiptar në fushën e psikologjisë.... Nuri Abdiu është hartuesi i parë i bibliografisë së punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë. Për veprën e prof. Nuri Abdiut "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939) akademik Dedja nënvizon se ky libër voluminoz është përfundim logjik i pasionit shkencor të autorit, si hulumtues këmbëngulës, i përqëndruar seriozisht në një temë me rëndësi historike kombëtare. Ajo është ... një vepër që pasuron literaturën tonë historike dhe shoqërore; vlerat e saj nuk kanë të bëjnë vetëm me zhvillimet arsimore të vendit tonë, me njohjen e tyre, me hapat që ka bërë shkolla shqipe, nga një etapë në një tjetër, por edhe me evolucionin e përgjithshëm të mendimit shkencor shqiptar, në përgjithësi dhe të mendimit politik, social e filozofik, në veçanti. Ky libër ka krijuar të gjitha premisat që në universitetet shqiptare të trevave të Ballkanit, qëhistoria e psikologjisë kombëtare të futet tanimë si një disiplinë e veçantë në degët e fakulteteve përkatëse.

Prof. Pajazit Nushi, zv. Kryetari i Akademisë së Shkencave të Kosovës, në një letër drejtuar prof. Nuri Abdiut me rastin e 80 vjetorit të lindjes së tij do t'i drejtohej me shumë ngrohtësi dhe intimitet : "Me një dëshirë të përzemërt unë, Esmaja, Leonora, djemtë dhe familjet e tyre, sot nderojmë jo vetëm vitin e tetëdhjetë të lindjes së njeriut të ndershëm, të mençur, dhe punëtor të palodhur, por duam të nderojmë edhe rëndësinë e veprave që mbushën këto vite dhe përbëjnë hallkën më të re të zhvillimit të mendimit psikologjik ndër shqiptarët. Me jetën dhe me veprat tuaja u bëre protagonist më i dalluar i të përpjetës së mendimit psikologjik në Shqipëri dhe ndër të gjithë shqiptarët.Ndiej krenari që në gjirin e popullit shqiptar lindi dhe arriti të afirmohet një studiues i zhvillimit të mendimit psikologjik shqiptar dhe të bukurisë zhvillimore të botës shqiptare. Duke përkujtuar dhe nderuar tetëdhjetë vjetorin e jetës dhe të aktivitetit tuaj, ne nderojmë atë personalitet që bëri shumë për mendimin psikologjik dhe zhvillimin e tij, por edhe si pedagog universitar i psikologjisë që keni vënë bazat e këtij mendimi në mësimet e larta të universiteteve shqipfolëse të viteve të gjysmës së dytë të shekullit njëzet duke u bërë nismëtar i studimit të historisë së mendimit psikologjik shqiptar".Më tej, Prof. Pajaziti nënvizonte "Jeta juaj e njerëzishme tetëdhejtë vjeçare dhe puna e palodhshme, e ndershme dhe frytëdhënëse u bë jetë e historisë së mendimit psikologjik ndër ne. Me angazhimet dhe kontributet tuaja, Ju, njëkohësisht, i dhatë kuptim zhvillimit tonë të gjithëmbarshëm. ....." Pajazit Nushi, (22/12/2010)

Alma Zenellari, poete, një ish studente e profesor Nuriut, do ta uronte nëpërmjet një poezie të ndjerë. Edhe emocionet e ndjesitë e saj po i ndajmë sonte me ju:

DIPTIK

Ma merr k'te breng, merrma me vete,
Ne mundesh, merrma ankthin tim..
Ti thinjëpërndritur e gojëembël,
I urt' (si) ati im...

Në mundesh brengën time merrma,
Dhe lotin kthema, valë...
Ti thinjëpërndritur e fisnik,
Të bardhë e ke çdo fjalë...

Një fjalë magjike, të ngrohtë e pres,
E pres të rrjedh' si uj' në krua,
E di tek zemra jote e fshehur,
Një fjalë e bardhë do jetë për mua...

Sa herë që ikën të ndjek nga pas,
Një krah pëllumbi mendimi im,
Të ndjek nga pas edhe kur vjen,
Një krah i brishtë pafluturim...

Je bregliqen ku shlodhen zogjtë,
Përplasin krahët, mërgon trishtimi,
Je det i ter' mistere plot,
Je oqean i thellë mendimi...

Të uroj me gjithë zemër jetë të gjatë...

Të nderuar pjesëmarrës!

Më lejoni që pas këtyre vlerësimeve të ngarkuara me emocione të shumta, të bëj një vështrim të shkurtër të rrugës që ka përshkuar Prof. Dr. Nuri Abdiun në këto 80 vite.

FAMILJA

Kur udhëton nga qyteti i vogël i Peshkopisë drejt Veriut, atje ku sapo kalon përroin e rrëmbyeshëm të Gjelagjoshtit, që zbret thikë nga mali i Korabit, shtrihet Sohodolli, njëri nga fshatrat më të mëdhenj të rrethit të Dibrës. Kushdo qëkalon asaj ane kujton se pikërisht, në këtë fshat, u lind profesor Nuri Abdiu.

Profesor Nuriu lindi në 1 shkurt të vitit 1930 në një familje që jetën e përballonte vetëm me të ardhurat që siguronte nga bujqësia e blegtoria, si të gjithë banorët e fshatit të madh të Sohodollit.

Sohodolli thirrej fshat i madh jo për shtëpitë, tokat e banorët që kishte, por figurativisht, sepse ishte një nga fshatrat më me tradita në Dibër.

Këtu jetonte edhe fisi i Abdieve. Asokohe, në fshat jetonte një burrë i zgjuar, punëtor, bujar, sedërli tejmase por edhe përkrahës i të resë e përparimit, Haziz Abdia, babai i profesor Nuriut.

Gjulja, nëna e profesorit, ishte nga Vlesha, ose Teqja e Vleshës, siç përmendet nga anët tona. Ajo ishte rritur e edukuar në një familje patriotike, nga më të mëdhatë e zonës, në familjen e Sheh Halilit, i cili kujtohet e nderohet për kontributin e dhënë në fushën e arsimit e kulturës në Dibër.

Nga martesa e Hazizit me Gjulen, erdhi në jetë i pari djalë, Nuriu, një shpresë për të ardhmen e familjes, i cili, me shpirtin e tij të madh dhe vizionin e qartë për të ardhmen, do të ndihmonte pa kursim vëllezërit Ismetin, Fehmiun, Sabriun dhe motrat Shahen, Kujtimen e Mejtapen.

ARSIMI

Profesor Nuriu ka mbaruar studimet e larta në Institutin Pedagogjik Shtetëror të

Moskës, në specialitetin PEDAGOGJI-PSIKOLOGJI në vitin 1958, dhe ka marrë diplomën SHKËLQYESHËM duke iu dhënë kualifikimi "Pedagog i

Pedagogjisë dhe i Psikologjisë për shkollat pedagogjike, inspektor-metodist për shkollat fillore";

Në vitin 1973, Komisioni i Lartë i Atestimit Shkencor pranë K.M. i ka dhënë titullin shkencor "DOCENT";

Në vitin 1991 fiton gradën shkencore "DOKTOR I SHKENCAVE" me disertacionin: "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939)".

Në vitin 1999 Komisioni i Kualifikimit Shkencor pranë KM, i ka dhënë titullin shkencor "PROFESOR".

AKTIVITETI

Profesor Nuriu mbart mbi shpatulla një aktivitet intensiv në fushën profesionale, pa hequr dorë asnjëherë nga mësimdhënia. Madje, e ka filluar mësimdhënien shumë herët në jetën e tij.Tek studionte në ish Bashkimin Sovjetik, bënte edhe punën e pedagogut të gjuhës shqipe në kurset e gjuhëve të huaja të Ministrisë së Punëve të Jashtme të ish Bashkimit Sovjetik. Sapo u kthye në atdhe, ai u emërua Pedagog i Psikologjisë dhe i Pedagogjisë në Institutin Pedagogjik Shkodër - Shtator 1958- dhjetor 1962, Zv.Drejtor për anën mësimore dhe shkencore dhe përgjegjës i komisionit Psikologji - Pedagogji në Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër (1962-1974); Zv.Drejtor i shkollës së mesme



cyan magenta yellow black

veprimtari



Në foto (Lart): Ethem Qerimi gjatë një interpretimi me violinë. Posht: Pamje nga salla.

pedagogjike "Shejnaze Juka" Shkodër (1974-1977); Pedagog i Psikologjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik, Shkodër (1977-1980); Shef i Katedrës së Psikologji - Pedagogjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër dhe i degës së Mësuesisë për Ciklin e Ulët (1981-1990); Gjatë kësaj periudhe, Prof. Nuriu zhvilloi edhe një cikël leksionesh mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar në kursin njëvjeçar pasuniversitar për psikologji-pedagogji në Universitetin e Tiranës (1982-1988). Në periudhën 1990-1993 ka punuar si Pedagog i Psikologjisë në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër; dhe në Shkurt 1993 e nxjerrin në pension.

Por Profesor Nuriu nuk e pushon aktivitetin e tij mësimdhënës dhe kontributin në fushën e kërkimit.

Ai zhvillon leksionet e psikologjisë së përgjithshme në Fakultetin Pedagogjik dhe Filologjik të Universitetit të Tetovës (Tetor 1996- tetor 2005); dhe vazhdon të mbajë leksione të psikologjisë së përgjithshme në Universitetin e Tiranës.

Profesor Nuriu angazhohet si Drejtues i Departamentit të Psikologjisë në Universitetin jo publik Albanian University në periudhën Gusht 2006–shkurt 2012.

Në Shkurt 2012 deri në fund të vitit akademik 2011-2012 punon si Zv. Dekan për anën shkencore i Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Albanain University.

BOTIMET

Ashtu sikurse në mësimdhënie, profesor Nuriu ka një kontribut të shquar në fushën e botimeve psikologjike e pedagogjike. Në mënyrë të përmbledhur do të përmendnim disa prej tyre si:

Vepra e tij kryesore është, pa dyshim, studimi "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar" (gjer më 1939), botuar më 2002 dhe ribotuar më 2010, i cili përbën një kontribut të veçantë në përgjithësimin e përvojës sonë kombëtare në fushën e mendimit psikologjik shqiptar. Më 2007 botoi monografinë "Psikologjia" e Hasan Tahsinit; "Bibliografia e punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë", është botuar më 1986 dhe ribotuar më 2011;

Është autor edhe i disa monografive me përmasa më të vogla, të botuara në revista e përmbledhje shkencore.

Lista e punimeve shkencore, studimeve, kumtimeve shkencore dhe artikujve arrin në mbi 170 zëra.Shumë prej tyre janë botuar në organe shkencore dhe mbajtur në sesione të ndryshme shkencore, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si në Kongresin VI Europian të Psikologjisë (Romë 1999), në Prishtinë, Gjakovë, etj.

Është bashkautor në 7 tekste të psikologjisë, 4 për shkollat e larta, 1 për kursin pasuniversitar dhe 2 për shkollat e mesme pedagogjike;

Profesor Nuriu ka qënë dhe është anëtar i një numri të konsiderueshëm shoqatash profesionale, këshillash dhe bordesh, me të drejta vendimmarrjeje, që nga vitet e para të aktivitetit të tij.

Për gjithë kontributine tij të vyer në fushën e arsimit shqiptar emri i Prof. Nuriut është një zë i veçantë në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë - 2008). Përvec kontributeve që përmenden edhe më lart, në Enciklopedi theksohet se profesor Nuriu ka statusin e këshilltarit botues në revistën shkencore "European Psychologist" (psikologu europian).

TITUJ NDERI

Profesor Nuriu mbart edhe disa tituj nderi të akorduara nga Kuvendi Popullor si Medaljen e "Punës" , të akorduar më 1968; Urdhërin "Naim Frashëri" të KLASIT TË PARË, të akorduar më 1980; titullin "MËSUES I MERITUAR", të akorduar më1987; dhe titullin "MËSUES I POPULLIT", akorduar më 1989.

Për të qënë sa më objektiv në vlerësimin e figurës shumëdimensionale të profesor Nuri Abdiut, e gjykuam të arësyeshme t'ju referohemi vlerësimeve të disa specialistëve të fushës.

KOLEGËT

Ju lutëm prof. **Hamit Boriçi** të na thoshte diçka për figurën e profesor Nuriut. Mes emocionesh, sigurisht të kuptueshme,nuk ngurroi të shprehte kënaqësinë për organizimin e këtij aktiviteti në respekt të veprës, kontributit dhe vlerave të profesor Nuriut. Ndër të tjera, profesor Hamit Boriçi na tha: "Prof. Nuri Abdiu ka qënë dhe mbetet një nga personalitetet e fushës së psikologjisë dhe pedagogjisë, bashkëkohës dhe bashkëpunëtor i akademikëve e profesorëve të shquar Hamit Beqja e Bedri Dedja.

Me profesorët Hamit Beqja dhe Bedri Dedja, Prof. Nuriu ka konsultuar dhe vlerësuar kontributet dhe trashëgiminë e pandërprerë në fushën e psikologjisë e të pedagogjisë shqiptare. Të tre këta dijetarë kanë dalë nga e njëjta shkollë dhe kanë reflektuar idetë më përparimtare të kohës në fushën e mendimit pedagogjik dhe psikologjik, duke lënë gjurmë të thella në zhvillimin e këtyre degëve; në të njëjtën kohë si mësues, edukator, si veprimtar në fushën e kërkimit shkencor, Prof. Nuriu mbart mbi supe kontribute të vyera e të pashlyeshme. Emri i profesor Nuriut, si edhe ai i dy profesoreve të tjerë të nderuar, janë në piadestalin e mendimit pedagogjik e psikologjik shqiptar"- do ta mbyllte vlerësimin e tij profesor Hamit Boriçi.

BASHKËPUNËTORËT

Duke kërkuar mes vlerësimeve të bashkëpunëtorëve të fushës, na ra në dorë libri i **Musa Krajës** "Mësuesi, pedagogu, personaliteti, etika e tyre". Faqet 3-4 i janë kushtuar profesor Nuriut. Po shkëpus pak rradhë nga ky liber, ku autori e vlerëson profesor Nuriun si: "Mësues i mijëra mësuesve dhe pse jo edhe i disa dhjetra profesorëve" (f.. 698), "Aftësitë organizative, të hershme dhe të reja, janë një provë se këto kanë qenë e janë në natyrën e profesor Nuriut, i cili aq mjeshtërisht ka tërhequr dhe tërheq opinionet, idetë dhe pikëpamjet e kolegëve në fushën shoqërore dhe profesionale. Serioziteti në punën hulumtuese, kërkimore e shkencore, as i nxituar, as i vonuar, duke zbatuar një metodologji shkencore në hulumtimet e traditës dhe të problemeve psikologjike aktuale, e ka bërë që produktet shkencore të përfunduara t'i pasqyrojë në brendinë e leksioneve dhe seminareve që drejton, me theks bashkëkohor krijues, të cilat vërehen edhe në veprat që ka publikuar vitet e fundit. ...Këto, vazhdon më tej Prof. Musa Kraja janë disa aspekte të personalitetit dhe të etikës profesionale të Profesorit Nuri Abdiut, i cili në vepren e tij aplikative mbetet një shembull ku janë ndërthurur natyrshëm tiparet themelore të etikës profesionale të një pedagogu bashkëkohor-modern, me gjithë vitet e gjata në sherbim, të cilat nuk e kanë zbehur vitalitetin e tij intelektual dhe profesional...". (f.699-700)

"Prof. Nuri Abdiu ka qënë dhe mbetet një nga personalitetet e fushës së psikologjisë dhe pedagogjisë, bashkëkohës dhe bashkëpunëtor i akademikëve e profesorëve të shquar Hamit Beqja e Bedri Dedja."

Prof. HAMIT BORIÇI

"Mësues i mijëra mësuesve dhe pse jo edhe i disa dhjetra profesorëve. Serioziteti në punën hulumtuese, kërkimore e shkencore, as i nxituar, as i vonuar, duke zbatuar një metodologji shkencore në hulumtimet e traditës dhe të problemeve psikologjike aktuale, e ka bërë që produktet shkencore të përfunduara t'i pasqyrojë në brendinë e leksioneve dhe seminareve që drejton, me theks bashkëkohor krijues, të cilat vërehen edhe në veprat që ka publikuar vitet e fundit..."

Prof. MUSA KRAJA

"Personalisht pedagogu, personaliteti i të cilit ka ndikuar tek unë dhe është kthyer në modelin që dua të ndjek është ai i Prof. dr. Nuri Abdiut, pasi mbart vlera profesionale, por mbi të gjitha vlera humane, të brendësuara brënda atyre akademike, të cilat më kanë tërhequr më tepër ndaj tij. Profesor Nuriu është pedagogu që jep e kërkon, duke të respektuar njëkohësisht".

ARDIT XHAFKOLLARI, Student

STUDENTËT

Studenti **Ardit Xhafkollari**, në një detyrë kursi, titulluar "Ndikimi i personalitetit të mësuesit dhe pedagogut tek nxënësit e studentët", në f. 7, do të shkruante: "Personalisht pedagogu, personaliteti i të cilit ka ndikuar tek unë dhe është kthyer në modelin që dua të ndjek është ai i Prof. dr. Nuri Abdiu, pasi mbart vlera profesionale, por mbi të gjitha vlera humane, të brendësuara brënda atyre akademike, të cilat më kanë tërhequr më tepër ndaj tij. Profesor Nuriu është pedagogu që jep e kërkon, duke të respektuar njëkohësisht". Më tej ai shton: "Kujtoj vitin e pare, kur fillova mësimin në universitet. Isha i topitur dhe disi i mpakur në mendimet e mia dhe gati t'i dorëzohesha fatit të keq, por personaliteti i profesor Nuriu Abdiut m'u bë mbështetje. Ndonjëherë ai i ngjan atij të mbinjeriut që nuk plaket asnjëherë.Forca dhe vitaliteti i tij më kanë dhënë kurajon që vështirësitë e jetës t'i shoh me syrin e luftëtarit. Jam krenar që e kam njohur dhe pavarësisht nëse arrij diçka në studimet e mia për psikologji, kam fituar shumë, dashurinë për jetën dhe kjo falë personalitetit të profesor dr. Nuri Abdiut".

TË AFËRMIT

Në angazhimin për të gjetur një vlerësim nga njerëz të afërt të profesorit, ju drejtuam çiftit Sami dhe Kumrie Shehu. Kumria, "Mësuese e merituar" do të nënvizonte se:"Kur bisedon me profesor Nuriun në telefon dëgjon një zë të ëmbël, të qeshur, të dashur e përkëdhelës. Nuk t'i kursen as komplimentat, të cilat i kanë aq hije. Kur është nevoja, të jep kurajë e merr prej tij një këshillë me vlerë të sinqertë.Mund të them me bindje se në rrethin tonë të gjërë familjar, Nuriu është më i vlerësuari.Ai e meriton plotësisht thënien e të madhit Tolstoi se "dashuria për të afërmit është zbukurimi më i madh i njeriut".

Në respekt të këtyre vlerave të rralla njerëzore të profesor Nuriut, do ta mbyllja këtë fjalë duke ju cituar disa vargje të jorgo Bllacit (i njohur si Esenini shqiptar):

Askërkënd se kujtoj për keq në botë,
Në zemrën time shteg të mbyllur s'ka,
Mjafton një fjalë e urtë, fjalë e ngrohtë,
Të më bësh prap mik e prap vëlla.

Ky është profesor Nuri Abdiu!

I nderuar profesor,

Më lejo që në emër të gjithë pjesëmarrësve, kontribuesve të këtij takimi, të gjithë atyre që me shumë dashuri e respekt për Ju, ndanë kujtimet e tyre me mua, të të uroj jetë të gjatë, shëndet, lumturi në gjirin e familjes suaj të mrekullueshme!

E.Haxhiymeri



Rruga e Arbërit nr. 83



Prof. dr. Nuri Abdiu vlerësohet si hartuesi i parë i Bibliografisë së punimeve shqiptare në fushat e psikologjisë dhe si hartuesi i historikut të mendimit psikologjik shqiptar që nga vitin '39.

Nuri Abdiu ka dhënë një kontribut të papërsëritshëm në fushën e psikologjisë



Nga **TEFTA CAMI***

I nderuar profesor Nuri Abdiu!

Të nderuar të pranishëm, familjarë, kolegë, miq e bashkëpunëtorë të profesor Nuriut!

Ndjehem e nderuar që më jepet fjala, por jam edhe e ndrojtur nëse do të mund të flas ashtu siç e meriton me të vërtetë për kontributin e shquar që ka dhënë profesori i papërsëritshëm i psikologjisë Nuri Abdiu. Me punën e kontributin e tij ai është e do të jetë një institucion shkencor e pikë reference për të gjithë studiuesit në fushën e psikologjisë brenda e jashtë vendit.

Profesori i papërsëritshëm i psikologjisë Nuri Abdiu, me punën e kontributin e tij është e do të jetë një institucion shkencor e pikë reference për të gjithë studiuesit në fushën e psikologjisë brenda e jashtë vendit.

Plejada e profesor Nuri Abdiut qe me fat. U arsimuan dhe u përgatitën nga ana shkencore jashtë shtetit, siç qe edhe vet prof. Abdiu në BS dhe kryen me dashuri e profesionalizëm misionin e madh e të vështirë të ngritjes nga e para të institucioneve të larta arsimore e shkencore, siç qenë edhe katedrat e pedagogjisë e të psikologjisë dhe institutet e larta pedagogjike e deri tek Universiteti Shtetëror i Tiranës. Prandaj do ta vlerësoj Prof. Abdiun në radhët e misionarëve të parë të ngritjes nga e parë të katedrës së pedagogji-psikologjisë dhe të Institutit të Lartë Pedagogjik katër vjeçare " Luigj Gurakuqi " të Shkodrës si dhe të zhvillimit të procesit të arsimimit, të specializimit e kualifikimit pasuniversitarë të qindra e qindra specialistëve në fushat e psikologjisë.

Si ndër misionarët e parë në fushat përkatëse Prof. Nuriut i takoi detyra që ta fillonin çdo gjë nga e para, siç qenë hartimi i programeve e leksioneve, i teksteve të psikologjisë e pedagogjisë për shkollat e mesme e të larta, si dhe për kualifikimin e mësuesve dhe specializimet pasuniversitare në Universitetin e Shkodrës dhe në Universitetin e Tiranës.

Vlerësohet si hartuesi i parë i Bibliografisë së punimeve shqiptare në fushat e psikologjisë dhe si hartuesi i historikut të mendimit psikologjik shqiptar deri në vitin '39, duke studiuar grumbulluar mendimin shkencor psikologjik më të përparuar shqiptar me metoda shkencore bashkohore, duke shtruar një trase të gjerë e të pasur të mendimit psikologjik shqiptar.


Mendimi e kontributi në fushat e psikologjisë i përfshirë në shumë botime u ka shërbyer e u shërben studentëve e specializantëve shqiptarë të të gjitha Universiteteve shqiptare brenda e jashtë kufijve të RSH, të RK dhe të viseve të tjera shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi dhe të Preshevës e Bujanovcit dhe të Medvegjës, duke u udhëhequr nga motoja se jemi një komb dhe kemi një psikologji kombëtare dhe duhet te kemi një formim e edukim psikologjik kombëtar e bashkëkohor europian të brezave të rinj, duke ecur në rrugën e gjithëpërfshirjes të mendimit bashkëkohor psikologjik shqiptar e europian dhe duke ruajtur karakterin e individualitetin tonë kombëtar edhe në kuadrin e integrimeve rajonale e europiane, si dhe të zhvillimeve globale e nomandizimit të shoqërisë njerëzore.

Profesor Nuriu është vlerësuar me shumë tituj e medalje si dhe me titullin më të lartë në fushën e arsimit shqiptarë " Mësues i Popullit ". Ligjësitë e metodologjinë shkencore në fushat e psikologjisë e të pedagogjisë i ka aplikuar në praktikë gjatë veprimtarisë mësimore e shkencore, duke eksperimentuar e pasuruar në praktikë me vlerat më të shquara të kombit shqiptarë. Të gjitha studimet e prurjet shkencore pasqyrojnë ecurinë e botës psikologjike të kombit tonë në ato nivele intelektuale, saqë mund të pohojmë,se ka ardhur koha që nuk mund të përdoret më kombi shqiptar si mish për top, për t'u ngjallur frikën fqinjëve, sepse kemi qenë dhe jemi një nga popujt që kemi aspiruar e aspirojmë paqe e stabilitet. Prandaj prioritet, si gjithmonë, kanë synimet e studimet që të vlerësohen e afirmohen vlerat më të shquara intelektuale të të gjitha fushave të kulturës e të shkencave, sepse njihemi si kombi më i lashtë në gadishullin Ilirik dhe në Europë.

Profesor Nuriun e çmojmë dhe e vlerësojmë së bashku me familjen e tij. Familja e Prof. Nuriut është e njohur si një familje fisnike dhe e shquar në krahinën e Dibrës. Prof.Nuriu është i lindur e i rritur nga prindër të fjalës e të besës, me vëllezër e motra të arsimuar e të ngritur nga ana kulturore e shkencore, me znj. Fitnet, një bashkëshorte të përzgjedhur ideale e të kujdesshme, e cila pa mëdyshje është bashkëpunëtorja e natyrshme dhe efektive në të gjithë veprimtarinë Tuaj mësimore e shkencore profesor Nuriu. Është meritë e trashëgimisë familjare dhe e përkujdesit familjarë si të bashkëshortes e të fëmijëve tuaj të mrekullueshëm, si dhe e pasionit e vullnetit tuaj, që vazhdoni të jeni aq vital e krijues në veprimtaritë mësimore e shkencore si dhe në aktivitetet shoqërore. Ju e keni sfiduar moshën dhe, me siguri, do të vazhdoni ta sfidoni e të punoni edhe në të ardhmen. Prandaj dëshiroj t'ju uroj jetë të gjatë dhe veprimtari sa më aktive në shërbim të familjes dhe të shkencës së psikologjisë e të shkencave të tjera sociale! Ju uroj të gjithëve 7 marsin, ditën simbolike të mësuesit e të arsimit tonë kombëtarë!

* Ish ministre e Arsimit dhe e Kulturës së Shqipërisë. Përshëndetje e mbajtur në takimin e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, në Hotel International Tiranë, më 7 mars 2013.

Studentët tuaj dhe Dibra të kanë vendosur në krye të vendit



Nga **SHEMSI MANJANI ***

Të nderuar pjesëmarrës

Kam kënaqësi të veçantë që në këtë 7 mars mua, mësuesit veteran të Dibrës, më jepet rasti të uroj për ditëlindje shokun tim të fëmijërisë dhe të gjithë jetës, të mirënjohurin, Nuri Abdiu.

Është urim për 80-vjetorin, urim I veçantë për çdo njeri me jetëgjatësi për t'u admiruar, me balance të shumta, për rastin konkret, me bilance e kontribute të pasura e të njohura nga unë, nga opinioni i shëndoshë shoqëror, të cilin pretendoj se e njoh, siç e njihni gjithashtu dhe ju, të nderuar pjesëmarrës.

Është urim për shokun e mikun tonë Nuri Abdiu, i cili, të gjitha moshat, fazat e momentet e jetës i kaloi me një shkëlqim të veçantë.

Është urim për shokun e mikun tonë Nuri Abdiu, i cili, të gjitha moshat, fazat e momentet e jetës i kaloi me një shkëlqim të veçantë. Me shkëlqim si fëmijë, nxënës e student në shkollë, pedagog e drejtues në universitet. I veçantë e i rrallë është rasti, kur dhe 80-vjetori i lindjes, mosha e katërt, e gjen Nuriun tonë pedagog e drejtues në një nga universitetet më me emër në vendin tonë. Me shkëlqim si prind e familjar, si bashkëshort e vjehërr, si shok e mik me të gjithë ata që pati rastin të njihet.

E kam njohur Nuriun e dashur që kur ishim në të njëjtën klasë, klasën e parë unike, konviktorë në Peshkopi, në vitin 1946. Njohur e lidhur ngushtë si fëmijë. Që kur u krijua organizata e pionierit, e ne të dy anëtarë të shtabit, Nuriu udhëheqës me mendje, zemër e sjellje të dallueshme, të harmonizuara këto dhe me pamjen tërheqëse, harmonizim që e vërejmë dhe sot që e kemi përpara në moshë 80-vjeçare.

Vit pas viti u përballuam me konsideratat e opinionin e mirë për të në Dibër, Shkodër, më shumë në Tiranë, ku jemi më pranë, në disa raste dhe në disa vende fqinjë. Konsideratë do ta quaja unë rastin që kur planifikonim e dilnim për shëtitje, dështonim në biseda nga ndërprerjet që na bënin hap pas hapi kalimtarët, ish studentë të tij, për të takuar e përqafuar gjithë dashuri, pasion e përzemërsi Nuriun, përzemërsi e vërejtur dhe ndaj meje, sapo mësonin në prezantim nga Nuriu se isha dibran, shoku i tij i ngushtë i fëmijërisë. U kënaqem duke biseduar e duke kujtuar me Nuriun ngjarje nga e kaluara, shokët e shoqet, një pjesë e mirë e tyre të ndarë nga jeta prej vitesh. Shkurt, të mbetur në këtë moshë si lisa të gjatë, të rralluar, shumë të përmalluar, pa shokët e larguar. Nuriu – iniciator për të kujtuar e takuar ato që janë gjallë.

Nuk mund të mbyllet urimi pa uruar në këtë përvjetor të veçantë si festë familjare pjesëtarët e familjes, bashkëshorten shumë të nderuar, me të cilën kaluan e kalojnë jetën në harmoni të plotë, që lindën, rritën e edukuan fëmijë, bashkëshorten që me siguri ka ndikuar më shumë se kushdo te Nuriu, për të qenë ai që është sot. Uroj vajzat shumë të dashura e të kujdesshme ndaj prindërve deri në fund, dhe me më shumë dashuri në pleqëri, siç kemi provuar dhe ne të tjerët këtë dashuri e përkujdesje të veçantë. Nga kjo veçanti e vajzave, mençuria popullore është shprehur me fjalët: "Kush nuk ka vajzë, zëre se nuk ka fëmijë". Urime djalit të Nuriut! Për djalin dhëndër. Gjithashtu, siç e kemi provuar e mësuar nga mençuria e njerëzve të urtë: "Kush ka dhëndër të mirë, ka fituar një djalë, kush e ka të keq, ka humbur dhe vajzën!".

Uroj vëllezërit, motrat e Nuriut me fëmijët e tyre. Vëllezërit shumë të njohur prej meje, së afërmi. Të kujton ky fakt thënien e shkrimtarit me famë botërore, Gëte, në një nga veprat e tij: "Njerëzit formohen vetëm nga njerëzit, të mirët nga të mirët".

Urime të veçanta për të gjithë ju, shokët e miqtë e Nuriut që ndodheni këtu, jo vetëm si shokë e miq të tij, por dhe si të njohur e si njerëz me kontribute e virtyte.

Përfundoi duke iu drejtuar shumë shkurt drejtpërdrejt personit që na nderoi duke na ftuar e duke na bashkuar në këtë ceremoni të gëzueshme:

Nuri i dashur,

Urime të përzemërta, shumë të përzemërta, të përqendruara e të drejtuara tek shëndeti yt! Të tjerat i ke të sigurta e të siguruara vetë! Të jesh shumë krenar për jetën që ke bërë e po bën. Jetë që kaloi përmes virtytit, jetë që nuk i bëri keq askujt. Synime këto e të tjera të rëndësishme të jetës si te rrallëkush. Po ta theksoj me bindje të plotë se Dibra të ka vendosur në krye të vendit. Dhe jo vetëm Dibra, por dhe shumë ish-studentët tuaj, mësues apo në punë të tjera, të shpërndarë brenda apo jashtë vendit, të tjerë shokë e shoqe. Në krye të vendit ty të parafytyron dhe të kujton gjithkush. Madhështia jote ka për të spikatur gjithmonë në jetë të jetëve, sepse madhështia jote është madhështi larg alibive politike, larg vlerave false, që shkatërrojnë çdo komb, vlera false që nuk i pamë tek ti asnjëherë. Të lumtë!

Urime! Edhe 100 vite të tjera plot shëndet e mbarësi!

** Ish drejtor i arsimit në Dibër*

kulturë



U HAP EKSPOZITA E PARE E PIKTORES SANKA BAUSHI

Shpëtim Kurti poet: Kisha rastin e fatin e mirë të isha i ftuar për të parë ekspozitën vetjake të piktores SANKA BAUSHI! E përmbledhur në pak fjalë ishte: Përkushtim, Seriozitet, Pasion, Talent e Impresione të drejtpërdrejta e të fuqishme! Përgëzimet e urimet më të mira! Edhe në ekspozita të tjera, pa fund!

Xhelal Luca, poet:Një shpirt që flet me muzikën e Vivaldit, një valle e Çajkovksit që merr flladin e lëndinave Dibrane dhe lulon brigjet Veneciane . Një dorë e praruar që krenon çdo Dibran e çdo Shqiptar. E urova me gjithë forcën e shpirtit këtë piktore që penelaton shpirtin.

Flutura Maçi, piktore dhe poete:Urime Sanka, ishte një ekspozite me dashuri për artin e pikturës, relaks shpirtëror në këto kohëra...

Lulëzim Kita, SHBA:Urime Sankës, ato që e kanë vizituar ekspozitën japin vlerësime maksimale, edhe unë i uroj asaj gjithë të mirat dhe suksese të mëtejshme në krijimtarinë e saj. Gjej rastin të përshëndes të gjithë pjesëmarrësit në ekspozitë, përshëndes të gjithë motrat e saj.

Eduard Abazi, biznesmen: Jam i nderuar që mora pjesë në këtë ekspozitë ku njoha dhe pjesë të jetës dhe fisin tim. Vërtetë rastësia të jep një mundësi, por vlera që merr prej saj nuk shlyhet.

Ermir Q. Grezda, Skulptor: Qëndrimi i sinqertë artistik është në sinkron me autoren, e shprehur në vizatimet si dhe finesa piktorike në Venecian romantike, plot transparencë e diell, duke ju dëshiruar ta vazhdoni pasionin me dashuri deri në fund të udhëtimit të jetës.

Një ekspozitë me dashuri për artin e pikturës

Si lindi dëshira për pikturën?

Dëshira dhe pasioni për këtë arte kaq të bukur siç është piktura, ka qenë dhe është brenda qenies time. Konkretisht filloi të dukej, fillimisht në vizatimet e thjeshta e naive të një fëmije 12 vjeçe duke bërë portret e shokëve të klasës e të bankës, të motrave dhe nipave të mijë moshatarë. Në atë periudhe vizatimet ishin spontane, të çiltra, të thjeshta dhe shpesh herë ndjej nostalgji për ato vite, një sensacion të ngrohtë, një mallëngjim, që më shton dashurinë për këtë art magjik, plot ngjyra, e jetë, më jep kurajo për të vazhduar, për të respektuar ndjenjën e asaj vajze të vogël për këtë arte të cilën nuk e njihte, por e kuptonte në brendësi të shpirtit të saj.

Si u zhvillua e kultivua ajo në të ardhmen?

Vitet pasuan njëra tjetrën, dhe kjo vajze e vogël u rrit. Jeta mori një tjetër drejtim, nga ajo që kish ëndërruar. Dëshira ime e madhe ishte për të vazhduar studimet në Akademinë e Arteve të Bukura e për këtë arsye konkurrova në degën e pikturës, pjesëmarrja ishte nga talente të ndryshme të ardhur nga e gjithë Shqipëria, kryesisht liceistë, por kishte edhe gjimnazistë si puna ime. Në ato vite numri i studentëve që do të ndiqnin degën e pikturës ishte i kufizuar dhe precedence kishin liceistët që vinin të përgatitur nga liceu. Shpresat ishin shumë të vakta dhe me të vërtetë nuk mu dha mundësia për të vazhduar. Megjithatë kjo nuk më pengojë të ëndërrojë për pikturë. Vazhdova Fakultetin ekonomik dhe me mbarimin e saj fillova punë në institucione të ndryshme shtetërore. Këto vite kanë qenë mjafte të vështira, ku punohej e mendohej vetëm për të mbijetuar. Dhe ato pak punime që bëra, mbeten si një kujtim si një relike e një ëndërr e pa realizuar.

Dhe diçka për jetën tënde, lindja, shkolla, puna, përshtypje nga vendlindja, takime me piktor të njohur e tjerë

Në vitin 1993 u largova nga Shqipëria, dhe që prej 20 vjetësh jetoj në Itali. Mbas këtij viti e deri më sot jetoj e banoj në Itali, në qytetin e bukur turistik bregdetar Manfredonia. Në Itali mu dhanë të gjitha mundësitë që të punoj e të zhvilloj më tej punën time në pikturë. Jeta në këtë vend të bukur, më dha mundësi që të njohë nga afër jetën, traditën e kulturën e këtij populli artist. Aty, gjeta frymëmarrjen e vërtetë, ku arti ndihet në çdo hap, kudo, në çdo cep të vendit dhe është pjesë e jetës. Kjo gjë të bën të mendohesh e të përqafosh atë që është e bukur. Vendqëndrimi i gjatë në këtë vend më mësojë shumë, në të gjithë aspektet e jetës, mu dha mundësia, për të realizuar dëshirat dhe ëndrrat e mija. Kjo më bëri që të mendojë seriozisht e t'i hyje me pasion punës në artin e bukur, siç është ajo e pikturës. Mendimi ishte mjafte i guximshëm dhe shumë i vështirë, por këtë mundësi duhet ta përqafoja pa vonese duke mos marrë parasysh as moshën, as vështirësitë që mund të ndeshja gjatë rrugës time drejt artit. Kështu fillova të punojë duke mësuar gradualisht dhe me shumë kujdes teknikën, si në peizazhe, portrete e në punime të tjera, vaj, pastel. Kjo dha rezultatet e para, që për mua ishin të kënaqshme dhe që u pritën me shumë entuziazëm nga kritikët e artit në vendin ku unë jetojë.

Mund të them se punimet janë bërë me shumë dashuri, pastërti, kujdes dhe jam munduar të transmetojë diçka nga vetja ime, mund të them se e gjithë jeta, është përkushtim, vëmendje, pasion, ëndërr, dashuri e lumturi. Me kalimin e viteve, të gjitha krijimet e mija të deritanishme dëshiroja t'i ndaj me miq e dashamirës të artit me familjarët e mi me qytetarët e vendit ku unë kam lindur dhe kam kaluar pjesën më të bukur të jetës sime fëmijërinë dhe rininë, me Tiranën dhe Dibrën time.

Keni provuar të hapni ekspozitë pikture në Itali?

Në Prill 2003 në qytetin ku unë jetoj u hap konkursi i parë "SIPONTINO" i Pikturës Bashkëkohore "Atmosfere festive a Manfredonia". Unë konkurrova me punimin tim vetjak "Shikim nga deti" FARI (LA LANTERINA), e organizuar nga Qendra Sociale Komunale Artistike "DIOMEDES". Manfredonia. Nga 27 pjesëmarrës në konkurs, piktura ime zuri vendin e shtatë.

Ndonjë moment kur hape ekspozitën e pare?

Në vendlindje, Tiranë unë vij çdo vit, por këtë vit ndryshe nga vitet e tjera erdha me mendimin që të çelë për herë te parë një ekspozitë vetjake të cilën e titullova "MOMENTE" Kjo ekspozitë u hap në Muzeun Kombëtar Tiranë nga data 10 -15 Mars, dhe u përcoll nga dy kanale televizive UTV dhe ABC NEËS, si dhe nga një Gazetë Lokale. Gjithashtu ekspozita u vizitua nga mjaftë artdashës të kryeqytetit, miq e dashamirës, piktorë skulptorë dhe poet. Reagimet e para ishin impresionuese dhe mjaft të mira që më dhanë kurajo te eci edhe më tej, megjithatë pati edhe kritika dashamirëse të cilat unë i pranova pa hezitim, sepse rruga e pikturës është e gjatë është e vështirë, por mjaft e bukur . Unë punoj me entuziazëm me shpirt dhe mundohem të jap më të mirën e vetes sime. Pata takime edhe me piktorë e skulptorë të dëgjuar të vendit, si Muntaz Dhrami, Suzana Varvarica, Ermir Grezda, Fatmir Boshnjaku etj, me te cilët shkëmbyem mendime të ndryshme. Ekspozita ime e parë vetjake ishte një event i rëndësishëm për mua, sepse ballafaqova veten time me publikun, dhe ekspertë te fushës, kjo ekspozite me angazhon, të shumëfishoj të gjitha forcat e mija intelektive dhe artistike, më dha kurajo të eci më tej me bindje se mund të bej diçka edhe më të mirë. Në këtë ekspozitë u ndesha me personat e thjeshtë, qytetarë, nxënës e student, artdashës, intelektual të fushave të ndryshëm të artit e kulturës. Me shumë emocion dëgjoja përshtypjet e tyre, shumica ishin entuziastë për thjeshtësinë dhe dashurinë që kam pasqyruar në punimet e mia dhe për këtë i falënderoj të gjithë përjashtim.

Piktori që ke për zemër shqiptar e të huaj.

Piktori shqiptar që më ka frymëzuar që në fëmijërinë time ka qenë dhe është i madhi Sali Shijaku, ndërsa ndër piktorët e huaj do të veçoja Van Gog, Mone, Karvaxho.

Ju faleminderit dhe suksese

Ju falënderoj ju dhe gazetën "Rruga e Arbërit", zërin e fuqishëm të Dibrës që motra ime Nexhi më dërgon çdo numër të gazetës.

Bisedoi: **ILMI DERVISHI**



Rruga e Arbërit nr. 83

Shënime për monografinë
"Gjenerali me shajak" të Xhafer Martinit

studim

Mënyra e ndërtimit të një monografie

Nga **Dr.FEJZULLA GJABRI**

Kur shkruan një libër historik për një ose disa ngjarje të caktuara, ose për një figurë historike, e cila ka lidhje me shumë ngjarje, pa dyshim, që duhet të kesh dokumente të shumta se, siç thotë populli, bukë pa miell nuk bëhet. Kjo për vetë faktin se historia operon me dokumente, me fakte, me të vërteta historike, që ndriçojnë jo vetëm kohën për të cilën shkruan, por edhe protagonistin historik, i cili, me ndryshimin nga personazhi që krijohet nga autori, që është frut i fantazisë së tij, ka jetuar dhe ende mund të ketë njerëz që e kanë njohur.

Por, nga ana tjetër, është po kaq e vërtetë se edhe një mal me dokumente të kesh, prapë ato nuk mund t\i quajsh libër, monografi, sepse ato duhen vënë në vendin e duhur, duhet t\i shërbejnë qëllimit të duhur, duhen interpretuar në mënyrën e duhur, shkurt duhen lidhur dhe organizuar, duhen shkrirë në atë mënyrë që të mos jenë jashtë librit, si apendiks, por pjesë organike e tij, si indet, gjaku dhe rrahjet e zemrës e frymëmarrja për njeriun. Ashtu si një grumbull gurësh, nuk bëjn dot një ndërtesë, ashtu edhe dokumentet historike nuk bëjnë dot një monografi, nëse ajo nuk ka një strukturë, një mënyrë ndërtimi të përshtashme.

Një monografi që i plotëson këto që thamë, është ajo me titull "Gjenerali me shajak", kushtuar figurës së Elez Isufit, shkruar nga shkrimtari dhe studiuesi Xhafer Martini. Kjo monografi ka një mori ngjarjesh dhe problemesh që duhen vënë në dukje, për të mund të shkruhen shumë artikuj dhe shkrime, duke kapur anë të ndryshme të saj. Unë do të vë në dukje vetëm faktin se si është ndërtuar vepra, si ndikon kompozicioni i saj në funksion të vlerës artistike.

Një mendimtar thotë se njeriu është fëmijëria e tij, në kuptimin se ajo pjesë e jetës së njeriut ka një rëndësi shumë të madhe për gjithë të ardhmen e tij. Mbresat dhe kujtimet e fëmijërisë janë të pashlyeshme. Njeriu në fëmijëri formohet, edukohet, merr atë formë shpirtërore që nganjëherë mbetet e pandryshuar edhe nga dallgët e tërbuara të jetës. Prandaj një fëmijëri e pasur, jo në kuptimin e salltaneteve jetësorë, por të përvojave të saj, të vështirësive dhe kapërcimit të tyre, është pasuria më e madhe për shpirtin e njeriut. Jo më kot Xhafer Martini i ka vënë një rëndësi të madhe pasqyrimit të fëmijërisë së Elez Isufit, si çoban, por më shumë si kaçak, si një i ri që iu desh të përballonte shumë vështirësi që ia kalitën shpirtin dhe karakterin. Janë shumë të bukura këto faqe të librit, sepse janë shkruar me dashuri dhe mjeshtëri artistike, në funksion të pyetjes kryesore: kush ishte ky Elez Isufi, si u formua ai, pse u bë ai që e njeh historia? Autori ka ditur të tregojë kushtet e veçanta në të cilat u ndodh Elez Isufi, i cili pati fatin të kalojë nëpër ngjarje dhe peripeci që pak fëmijë i provojnë në jetë. Elez Isufi u rrit si trup e si shpirt, në unitet të plotë, e jo trupin si kallami dhe mendja për tavani, siç thuhet. Atij iu desh të marrë përgjegjësi mbi veten qysh në fëmijërinë e hershme.

Kemi lexuar libra për figura si Elez Isufi, por përgjithësisht ato janë të varfëra dhe pa ide, sepse autorët e tyre nuk ndjekin rrugën e formimit të protagonistit, por e japin atë të formuar, duk e parë vetëm nën prizmin patriotik, pa asnjë imtësi individuale. Këta protagonistë janë të gjithë njëlloj, të gjithë të mërzitshëm meqë vështrohen vetëm nga këndi atdhetar. Por dihet se asnjë prej njerëzve të mëdhenj, nuk ka lindur si i tillë. Ata kanë qenë si të gjithë të tjerët, por premisat, ose kushtet dhe rrethanat në të cilat janë ndodhur, u kanë dhënë drejtim jetës së tyre. Kështu, si shembull, askush nuk lind as atdhetar, as tradhtar, por njerëzit bëhen të tillë dhe jo në një çast të vetëm, jo në një ditë, por për shumë kohë dhe për shumë arsye. Pra, edhe rruga e atdhetarizmit ka rritjen e vet, sepse hero nuk bëhesh në një ditë dhe rastësisht. Askush nuk mund ta mendonte që një çoban dhish si Elez Isufi, një kryeneç dhe harrakat si ai, që nuk i pëlqente asnjë punë, të bëhej i tillë që, me të lëshuar kushtrimin, t\i mblidheshin një mijë burra rrotull. Pra kjo rrugë formimi ka një rëndësi të madhe për çdo hero nëse do ta japësh atë jo vetëm me anën heroike, por edhe me atë njerëzore, me të mirat dhe të metat që ka çdo njeri.

Në monografinë"Gjenerali me shajak", formimi atdhetar i Elez Isufit bëhet në mënyrë graduale, nga pavetëdija në vetëdije, nga anarshizmi e rrebelizmi, në veprime të menduara dhe kordinuara, nga jeta e vetmuar prej Robinsoni, në një jetë plot veprimtari, në lidhje të ngushtë me njerëz të thjeshtë dhe atdhetarë të nderuar, nga ngjarje sporadike, me vlerë vetëm individuale e me rrezatim të vogël, në ngjarje me rrezatim kombëtar dhe me vlerë kombëtare. Kjo nuk arrihet me një punë shkelë e shko si të të vijë, por me një procedim të kujdesshëm artistik, me një strukturë solide të veprës, duke mos u ngatërruar në ngjarje në vetvete, por duke i vështruar ato me një dritë filozofike.Autori është një krijues jo vetëm i talentuar dhe me përvojë të gjatë krijuese, por edhe me një përvojë për lloje të ndryshme të letërsisë, mbasi i ka lëvruar me sukses poezinë, poemën, tregimin, novelën, romanin, dramën, kritikën letare, esenë filozofike, esenë historike, publicistikën etj. etj. Përvoja e tij si prozator i mirë e ka ndihmuar shumë në mënyrën e konceptimit të heroit kryesor dhe me krijimin e një kompozicioni solid nëpërmjet të cilit jepet personaliteti i Elez Isufit. Ndërtimi i veprës, i çfarëdo vepre, është pak a shumë si ndërtimi i një shtëpie, vile apo pallati. Një shtëpi e mirë do projekt të mirë, që ajo të dalë jo vetëm e përshtatshme për banim, por edhe e bukur, që të rrijë mirë me vendin dhe mjedisin ku është ndërtuar. Një shtëpi e mirë do edhe zbatimin e projektit në mënyrë të përkryer. Po kështu është edhe çdo vepër qoftë kjo letrare, historike apo e ndonjë lloji tjetër. Çdo vepër ka ndërtimin e vet, arkitekturën e vet, por ka edhe materialin e ndërtimit, ka pra, si të thuash, edhe anën e zbatimit, me çka në këtë fushë duhen kuptuar mjetet shprehse, stili, fjalori, mënyra e të shkruarit. Pra, një vepër, pavarësisht nga natyra e saj, është tepër komplekse, aspak diçka që improvizohet shpejt pa respektuar ligjësitë e krijimit, sipas fushës përkatëse. Xhafer Martini është nga ata krijues që i njeh mirë të gjitha këto ligjësi dhe punon me përkushtim dhe ndërgjegje krijuese për të bërë më të mirën e mundshme. Për të krijimtaria është pasion e talent, por jo kollajllëk.

Monografia "Gjenerali me shajak", për nga ndërtimi ngjan me një dramë, sepse vetëm në dramë ka ngjeshje, intensitet mendimi e veprimi, përqëndrim, kohezion, dinamizëm dhe gjallëri. Kjo duket në çdo kapitull të monografisë për Elez Isufin. Le të marrim vetëm kapitullin DASHURIA, që meriton të shkruhet me germa të mëdha.

Ndonjë mediokër, dritëshkurtër mund të mendojë : dashuria për EleZ Isufin? Po a shkon kjo? Por Xhafer Martini ka treguar se jo vetëm shkon, por shkon shumë bukur. Nuk ka në jetë vetëm tym baruti dhe pluhur të betejave, nuk ka vetëm gjak dhe lot, nuk ka vetëm përleshje dhe varre. Jeta është e gjerë dhe e larmishme. Ai me të drejtë fut edhe një kapitull si DASHURIA, ka lirizëm, dritë, ngrohtësi që rrezaton edhe në luftërat e betejat legjendare. Udhëtari, pas një rruge të gjatë, ka nevojë të ulet për pak kohë në një lëndinë të gjelbëruar dhe të hijezuar që të çlodhet. Monografi "Gjenerali me shajak" është një reliev, është vetë natyra, me male, shkëmbenj, gryka e gremina, pyje, por edhe me fusha, me liqene dhe vende të bukura për të cilat e vlen të jetosh, por edhe të vdesësh. Që autori është mjeshtër, duket edhe në mënyrën dhe formën se si i ka ndërtuar episodet dhe ngjarjet e dashurisë, që në fakt përmblidhen në tri martesa që natyrisht nuk janë bërë në një ditë dhe ka të ngjarë që dasma e parë të jetë bërë më e madhe, më e bujshme, më e hareshme etj. Kështu mund të ketë ndodhur në jetë, por për autorin, përveç së vërtetës jetësore, ka edhe një të vërtetë tjetër që është ajo shpirtërore, ajo artistike, e cila, ngaqë është ndriçuar nga një dritë hyjnore, bëhet më e vërtetë se të gjitha të tjerat. Herën e tretë Elez Isufi martohet me atë që ka dashuruar me të vërtetë. Por për ne si lexues ka rëndësi tjetër gjë: tërheq vemendjen mënyra se si episodet e dashurisë shkrimtari i grumbullon, i përbashkon, i lidh, i unifikon , i gërsheton, i krahason dhe i individualizon nën titullin DASHURIA. Vini re se si janë dhënë portretet e grave të Elez Isufit me pak fjalë, por me domethënie të madhe, vini re marrëdhëniet e tyre me njera-tjetrën, por edhe me Elez Isufin. A ka dramë më të fuqishme sesa vdekja e Bjeshkës, vrasja e saj, a ka mënyrë më të fuqishme dhe prekëse se ajo që përdor autori për ta dhënë këtë vrasje? Por, mbi të gjitha, fatkeqësinë që ka ndodhur shkrimtari nuk e jep në kohën kur ka ndodhur. Ai, me anë të një plani retrospektiv, e vë atë në mes të një dasme, dasmës së Mersinit që si kohë ndodh shumë vite më vonë. Por për një gjë të tillë shkrimtari ka shfrytëzuar në mënyrë shumë efikase, artistike e estetike, një nga dukuritë më të fuqishme letrare siç është shoqërimi i ideve, kur një gjë të kujton një tjetër. Tragjedia e Bjeshkës dhe e bijës së saj, Mines, që mbeti jetime, përjetohet më thellë dhe bën përshtypje më të madhe në mes të dasmës së Mersinit. Autori din t\i pranëvejë ngjyrat, dritat dhe hijet, dhe kjo ka një rëndësi të veçantë për ta bërë një vepër inetresante. Edhe pasqyrimi i dasmës së Mersnit është një akt dramatik. Xhafer Martini nuk e ka hallin tek dasma. Ai niset nga një gjë për të treguar një tjetër. Dyzimi kthehet në një figurë për ta metaforizuar jetën, për ta parë atë nga ai kënd ku ndriçimi është më i përshtatshëm. Po të shprehemi me figurë, do të thoshim se monografia është si një katedrale gjigande, e cila, të duket që dritën nuk e merr nga dritaret, por lart, nga kubeja. Në dasmën e Mersinit kanë ardhur dhjetra vajza e nuse që hedhin valle dhe këndojnë. Ku ja, fare papritur, si diell, shfaqet Elez Isufi, hijerëndë dhe madhështor, por edhe me shpirt delikat, që do ta shijojë elegancën e valleve të vajzave pa rënë në sy, por ato e shikojnë. Një autor pa përvjë do ta kishte dhënë skenën ndryshe, në mënyrë shabllone e shkollareske, pa dramacitet. Por autori gjithçka e ngrin, ka ndodhur eklipsi sikur dielli papritur zihet nga re të zeza.

"Vallja mbeti pezull, duart të lidhura, por këmbët nuk lëviznin sa thoshe se të gjitha ato valltare, që një çast më parë ishin gjithë joshje e lëvizje, u shndërruan në statuja të gjalla. Ahengxhinjve, që u binin veglave, u ngrinë topuzat në ajer, kurse karthitë u dridheshin në dorën e majtë, culat u mbetën në buzë dhe gishtërinjtë i kapi ngërçi në vrimat e kavallave. Ishte një mpirje e përgjithshme, një ndalje e qarkullimit të gjakut, një pushim njësekondësh i zemrës, një ndalim i jetës... Të gjitha shikonin Elez Isufin."(f.111)

Pas këtij pasazhi vibrant autori kalon tek ajo që don të tregojë:

"Nusja e re po afrohej me hap të matur dhe elegant. Po, ai e kishte parë këtë lloj të ecuri, këtë lloj të tundjes së lehtë të kokës dhe të supeve, po se tek kush, nuk i kujtohej. Me njeriun që po shikonte, ose me njeriun që i ngjante atij që kujtonte, kishte shumë vite që nuk ishte takuar. Nusja e re u ndal pesë hapa para tij dhe buzëqeshi, duke zbuluar dhëmbët e bardhë që i kishte të rregullt sikur t\i kishte prerë dikush me sharrë, iu afrua edhe dy hapa. Po, tani nga buzëqeshja e njohu.

Po na vjen bija anës me nazet e nënës, - thotë një këngë popullore. Por ajo nuk vinte vetëm me nazet, por edhe me pamjen, ishte kopja e saj.

- Or La Lez, a nuk më njeh?- e pyeti buzëgaz ajo.

- Po, të njoh, por ta kam harrue emnin...Nga ruda të njoha...

- Jam Minja, vajza jote, La Lez...

Asaj i shpërthyen lotët dhe ashtu, duke qarë, iu hodh tet në gjoks. Ai e mbajti një sekondë të shtrënguar, pastaj e largoi nga vetja dhe e pa mirë. Pastaj tha:


- Ai ti Mine je?

- Unë jam, La Lez, unë, - foli ajo përmes lotëve. – Sa më ka marrë malli, La Lez. Të kam parë nga larg, por kështu afër, si tashti, të kam parë vetëm kur isha e vogël...

- Ah, Mine, Mine, - tha Elezi Isufi pa ditur ç'të thoshte tjetër. (f.113)

Ja,kështu episodesh ka shumë në monografi. Ato janë imtësi por që japin shumë dritë dhe e bëjnë një vepër njerëzore. Elez Isufi nuk ishte preh hekuri, edhe ai kishte ndjenja, bile shumë të fuqishme, por jeta që bënte, përkushtimi ndaj atdheut, e bënë që të mos njihte as fëmijët e vet.

Shkrimtari Xhafer Martini ka dhënë gjithçka që ka ditur për Elez Isufi, edhe ato që disa autorë pa përvojë dhe pa talent i fshehin se mos njollosin protagonistin. Në popull është thënë se Elez Isufi është bërë i pasur me florinjtë që ka gjetur në një guvë mali. Këtij episodi autori i ka kushtuar disa faqe, por të përshkruara shumë bukur. Elez Isufin e kishin pushtuar ethet e arit. Ai në atë periudhë kishte një temperaturë shpirtërore dhe një padurim si të gjithë ata që kërkojnë ar. Autori e ka dhënë sikur ai e gjen arin, por, mënyra si është dhënë, diçka midis legjendës dhe realitetit, të bën



të mendosh se edhe nuk e ka gjetur, dhe se kjo është vetëm një lojë e autorit. Por këtu ka qenë qëllimi i tij që ngjarjen ta japë të dyzuar, diçka midis ëndërrës dhe realitetit.

Një tjetër episiod i kësaj natyre është kur Elez Isufi, në rininë e tij të hershme, është në kampin turk, i rreshtuar në kahje të kundërt me Lëvizjen tonë Kombëtare. Edhe këtë autori e jep si nëpër mjegull, sikur është dhe sikur nuk është e vërtetë. Lexuesi nuk imponohet, lihet të mendojë dhe të gjykojë vetë. Shkrimtari shkruan edhe mes radhëve, me nënkutime, prandaj kjo vepër është disashtresore dhe jo e drejtëpërdrejtë. Ai thotë se edhe dielli ka njollate veta, kurse për njeriun nuk e vë në dyshim që ka. Pse mos të ketë Elez Isufi?

Midis halucinacioneve, midis së mundurës dhe të së pamundurës, jepet edhe episodi kur Elez Isufi var vajzën e vet që kishte mbetur shtatzënë me një shërbëtor të shtëpisë. Sa tragjik është ky episod! Por edhe ky, ashtu si është dhënë, herë të duket sikur ka ngjarë, herë sikur është thjesht një trillim i autorit. Edhe këtu autori luan me imazhin, me ngjyrat, me të vërtetën dhe fantazinë. Ai shikon të gjithë spektrin e ngjyrave. Autori për një çast beson sikur Elez Isufi e ka kryer atë veprim. Shpjegon arsyen pse veproi ashtu. Është një arsyetim vërtet filozofik dhe pa qenë mendimtar, filozof, ky libër, i përceptuar në këtë mënyrë, nuk mund të shkruhet. Elez Isufi e thirri shërbëtorin dhe e pyeti për marrëdhëniet e tij me vashën e Ndreve. Atij sa nuk i ra të fikët nga frika. Elezi urdhëroi t\i jepeshin paret që i takonin dhe ta përzenin në çast, duke e nxjerrë nga dera e kabxhikut. Ai sa nuk qau nga gëzmi që shpëtoi, pa menduar për të dashurën e tij që pat sakrifikuar shumë për dashurinë e tij. Sikur të ishte treguar burrë, të kishte mbrojtur dinjitetin e vet dhe të asaj që e kishte bërë grua, Elez Isufi do të sillej ndryshe. Ai e dënoi vajzën jo për gjestin, por për njeriun me të cilin ishte lidhur...Ai ishte shërbëtor jo vetëm nga puna që bënte, por edhe nga shpirti...Këtë dënoi Elez Isufi!

Shkrimtari nuk i fal asgjë Elez Isufit, sepse, siç thotë në një vend, për njerëzit e mëdhenj duhet të thuhen të gjitha. Zoti nuk ka nevojë t\i dalësh zot dhe ta mbrosh ti që je njeri, thotë një filozof. Autori e ngre gati në një lartësi hyjnore Elez Isufin, e quan gjeni dhe dihet se gjenitë e kanë një dimension të tillë tek shpirti i vet. Edhe kjo nuk është gënjeshtër dhe nuk tingllon si gënjeshtër. Elez Isufi nuk ka nevojë ta mbrojë autori. Autori ka detyrë të tregojë. Mbrojtja e tij është që ai të tregojë bukur, me art, me bukuri dhe elegancë stili. Nuk ka nevojë Elez Isufi t\i mbash anën. Dhe autori këtë nuk e bën kurrë. Prandaj figura e Elez Isufit ka dalë e plotë, e pacunguar, prandaj leximi i monografisë të shkakton kënaqësi, të jep dritë dhe hare, të bën të ndihesh komod në ndjenjën tënde artistike, ia pazhgënjyer, i bindur se nuk kanë dashur të luajnë me ty, të ta hedhin, por se kanë dashur të të njohin me një burrë të madh të kombit.

portret

Xhafer Selman Kaloshi

I mbuluar padrejtësisht me mjegullën e harresës është Xhafer Selman Kaloshi, që besën bujarinë, trimërinë i kishte në një shkallë të lartë si Kaloshët e tjerë, por, përveç tyre, ai kishte edhe veti e cilësi të tjera, si: inteligjenca e jashtëzakonshme, aftësia për të mësuar shpejt dhe në mënyrë autodidakte, prirja për gjuhë të huaja, pasioni i madh për të lexuar dhe për të grumbulluar libra etj.

Nga **XHAFER MARTINI**

Në kuadrin e përpjekjeve për të sjellë për lexuesin patriotë të panjohur të së kaluarës, po jap jetëshkrimin e shkurtër të njërit prej figurave më interesante të historisë dhe të kulturës sonë: Xhafer Selman Kaloshin e Kandrrit në Dibrën e Poshtme. Kaloshët janë dalluar për trimëri, besë dhe bujari. Në këto tri drejtime ata e kanë pasur shkëlqimin më të madh. Dhe, pa dashur t'i numëroj të gjithë, figurat më të spikatura për cilësitë që përmendëm më lart, janë Ibrahim Kaloshi, Llan Kaloshi, (Haxhi Llani), Hasan Kaloshi, Murat Kaloshi, Selim Sulë Kaloshi etj.

I mbuluar padrejtësisht me mjegullën e harresës është Xhafer Selman Kaloshi, që besën bujarinë, trimërinë i kishte në një shkallë të lartë si Kaloshët e tjerë, por, përveç tyre, ai kishte edhe veti e cilësi të tjera, si: inteligjenca e jashtëzakonshme, aftësia për të mësuar shpejt dhe në mënyrë autodidakte, prirja për gjuhë të huaja, pasioni i madh për të lexuar dhe për të grumbulluar libra etj.

Xhafer Kaloshi ka lindur në Kandërr aty rreth vitit 1890. Në vitin 1912, kur Shkodra, në zbatim të vendimeve të Kongresit të Berlinit, u rrethua për t'iu dorëzuar malazezëve, shqiptarët hodhën kushtrimin për ta mbrojtur qytetin historik me çdo kusht. Midis shumë shqiptarëve në udhëheqje të çidhnakëve ishte edhe legjendari njëqind e dy vjeçar Llan Kaloshi. Në përbërjen e vullnetarëve që komandonte Llan Kaloshi bënte pjesë edhe i riu 22 vjeçar Xhafer Kaloshi. Shkodra në atë kohë mbrohej nga gjeneral Esad Pashë Toptani që ishte komandant i trupave rezerviste shqiptare dhe nga gjeneral Hasan Riza Pasha, komandant i trupave turke.

Dibranët luftonin në frontin e Bërdicës, luftonin me heroizma dhe sakrifica jashtënjerëzore. Hanin nga një copë peksimet me krimba dhe jetonin në lloç deri në brez, natë ditë në llogore, që nuk i lëshuan për gjashtë muaj asnjë sekondë. Llan Kaloshi u vizitua në vijën e frontin nga gjeneral Toptani, i cili piu një kafe nga uji klladë dhe nga filxhani që kishte disa muaj që nuk ishte larë. E piu se ashtu e pinte kafen për ditë Llan Kaloshi. Aty gjenerali u njoh dhe , për çudi, bisedoi në disa gjuhë të huaja me vullnetarin e ri, 22 vjeçar Xhafer Kaloshin, që, siç mësoi nga goja e trimave të tjerë, ishte i papërmbajtur në luftime. Dy javë pas asaj vizite, nga predhat e armikut që binin pa pushim, Xhafer Kaloshi humbi njërin sy. Më vonë, mbas mbarimit të luftës, Esad Pashë Toptani, do ta dërgonte në Francë për syrin e lënduar, por qe e pamundur të shpëtohej. Xhafer Kaloshi e pranoi shërbimin që po i bënte gjeneral Esad Pashë Toptani se e dinte që mbi të nuk rëndonte as vrasja e Hasan Riza Pashës,1) as dorëzimi i Shkodrës,2) siç thuhej atëherë dhe siç trumbetohej me të madhe nga historiografia e diktaturës komuniste. Në atë kohë luftohej edhe në vise të tjera shqiptare, si në Janinë, për ta mbrojtur atë nga ushtritë greke, por qëndresa e shqiptarëve atje nuk qe si e Esad Toptanit në Shkodër. 3)

Xhafer Kaloshin me Esad Pashë Toptanin e lidhte, në radhë të parë, miqësia e një ushtari trim për gjeneralin e tij trim dhe të sakrificës.

Por edhe pse me një sy, ai nuk e humbi dashurinë për librat dhe për kulturën.

Thellohej vazhdimisht në gjuhët e huaja që dinte, si : turqishten, serbokroatishten dhe italishten, dhe lexonte vazhdimisht libra gjithëfarësoj nga biblioteka e tij që kapte mijëra vëllime.

Koha kërkonte sakrifica të reja. Atdheu nuk ishte çliruar plotësisht edhe pse Shqipëria ishte shpallur shtet i pavarur. Dibra mbahej e pushtuar nga forcat serbo-jugosllave deri në anën e djathtë të rrjedhës së Drinit të Zi. Jemi në vitin 1920, kur populli i Vlorës, me ndihmën e rrethinave, por edhe të një pjese të krahinave të tjera, e hodhi Italinë në det dhe ajo u detyrua ta pranonte humbjen dhe ta njihte Shqipërinë e vitit 1913. "Më në fund, me 2 gusht 1920 Roma kërkoi me ngutësi të ndërpritej kryengritja shqiptare mbasi kishte vendosur të nënshkruante marrëveshjen për tërheqjen e ushtrive të saj nga Vlora." 4) Kur këtë gjë e deklaronte Italia që ishte shtet i madh dhe i fuqishëm, të njëjtën gjë duhej të bënte edhe Jugosllavia dhe ta tërhiqte ushtrinë nga territori shqiptar dhe të njihte kufijtë e vitit 1913, që ishin caktuar nga Fuqitë e Mëdha. Por Jugosllavia rezistonte me kokëfortësi, me shpresë se mund ta mbante pjesën e pushtuar të Dibrës. U krijua në atë kohë e ashtuquajtura "Qeveria e Arrasit", që nuk ishte gjë tjetër veçse administrata shqiptare me prefekt Ramiz bej Dibrën, me seli në Arras. Administrata e prefekturës, porosiste qeveria e Tiranës, duhej ta kishte vendqëndrimin në Katër Grykë, larg vijës së pushtimit, që të mos i jepte mundësi Jugosllavisë për luftime dhe beteja të reja, mbasi ishin krijuar kushtet për ta detyruar atë të tërhiqej nga Dibra e pushtuar me mjete diplomatike. Të njëjtën gjë porosiste edhe Elez Isufi. Por Ramiz bej Dibra, i nxitur nga Ramiz Daci, nuk iu përmbajt këshillave dhe udhëzimeve të qeverisë së Tiranës dhe e ngriti administratën në Arras, mu në vijën e pushtimit, çka u mor si provokacion i rëndë nga ana e jugosllavëve. Populli shprehu entuziazmin, dhe i ndezur nga "qeveria " e tij u hodh në kryengritjen e 1920-s, nën udhëheqjen e Elez Isufit dhe të komandantëve të tjerë vullnetarë. Kryengritja nisi me 16 gusht 1920 në Shumbat dhe u përhap me shpejtësi në gjithë Dibrën e Poshtme. Trupat jugosllave u shpartalluan keq dhe lanë në duart e shqiptarëve rreth 100 të vrarë dhe 600 robër si dhe shumë armë dhe municion. Si çliruan Peshkopinë, vullnetarët shqiptarë, të ndezur nga padrejtësitë historike, nuk iu përmbajtën as këshillave të qeverisë së Tiranës as të"qeverisë" së Arrasit, por mësynë edhe Dibrën e Madhe dhe e çliruan atë nga trupat jugosllave.

Xhafer Kaloshi mund t'i shmangej me nder kësaj kryengritjeje se ishte invalid lufte, por ai jo vetëm mori pjesë, por luftoi në ballë të saj, në frontin më të vështirë dhe u plagos sërish, kësaj here në këmbë. Në atë kohë në Shqipëri nuk kishte spitale dhe doktorë që të merrnin sadopak përgjegjësi për plagë të rënda, prandaj shkoi në Itali për t'u mjekuar me shpresë për ta shpëtuar këmbën. Por mjekimi edhe atje nuk pati sukses dhe ai e humbi këmbën përgjithmonë. Kështu si invalid i dyfishtë ai jetoi disa vjet në Itali me ndihmat një organizate humane që vepronte në këtë vend.

Në Itali ai ra në kontakt me ide të ndryshme që lidheshin jo vetëm me të ardhmen e Italisë, por edhe të njerëzimit. Fashistët po përgatiteshin për marrjen e pushtetit dhe ishte e natyrshme që idetë e tyre kishin pushtuar më shumë zemrat dhe mendjet e njerëzve. Por Xhafer Kaloshi nuk u bë fashist. Erdhi në Shqipëri dhe qëndroi i mënjanuar dhe i harruar, pa pension dhe pa asnjë përkrahje, në odën e tij bibliotekë duke lexuar dhe filozofuar për të ardhmen e njerëzimit.

Kur Italia fashiste pushtoi Shqipërinë më 7 prill 1939, Xhafer Kaloshi, duke mos pasur mundësi tjetër për të siguruar bukën e gojës, u shërbeu atyre si përkthyes. Komunistët shqiptarë e akuzonin si fashist, por ndonjë akuzë konkrete nuk ishte ngritur për të, aq më tepër që ajo t'i bëhej ballë për ballë. Po ja që një ditë, kur hyri në klubin e Peshkopisë, i vetmi klub, aty ku sot është postëtelegrafa, Xhafer Kaloshi, i mbështetur në paterica, pa në një tryezë, një komandant të lartë partizan, rrethuar nga disa ushtarakë të tjerë. Ky, megjithëse nuk pajtohej për asnjë çast dhe në asgjë me regjimin komunist, si njeri i kulturuar që ishte, u dha një përshëndetje të lehtë me kokë dhe u ul në një tryezë të lirë larg tyre.

- Po ta pranoj këtë përshëndetje, megjithëse ti Xhafer Kaloshi je italofil, - i tha komandanti ushtarak patriotit pa një këmbë dhe pa një sy, që, ashtu i drobitur dhe i plakur, dukej sikur nuk kishte qenë ai që kishte përpirë malet dhe luftonte kundër armikut në këmbë. Po nëse nuk i punonin këmbët, zemra kishte mbetur e fortë si gjithnjë, dhe ai, duke ngritur kokën me krenari, pa i bërë tërr syri i vetëm, i tha komandantit partizan:

- Ju po më quani italofil, por kjo nuk është e vërtetë. Ju komunistët jeni sllavofilë, dhe kjo është shumë e vërtetë. Unë kam lënë këmbën dhe syrin duke luftuar me ata me të cilët ju jeni bashkuar dhe vëllazëruar, - tha Xhafer Kaloshi dhe u ngrit e doli nga klubi.

Por pa bërë as dhjetë hapa iu vërsulën dy – tre partizanë dhe e arrestuan.

Me hekura në duar, shoqëruar nga një togë e armatosur, sikur të ishte bandit me famë, e dërguan në Sllatinë, tek brigada partizane që ta pushkatonin. Do ta kishin pushkatuar me siguri sikur mos ta kishte marrë vesh Dali Ndreu, i cili tha se ishte turp të bëhej një gjë e tillë ndaj një patrioti si Xhafer Kaloshi. Prej ndërhyrjes së Dali Ndreut, Xhaferi shpëton nga ekzekutimi. Që midis Xhafer Kaloshit dhe italianëve nuk kishte asnjë gjë konfidenciale, e dëshmon edhe një dokument që lëshon kuestura fashiste. 5) Por Xhafer Kaloshi shpëtoi përkohësisht nga vdekja. Mendja e tij e ndritur dhe fjala e hidhur, por që në atë kohë nuk ishte e lirë, sidomos për Xhaferin, do ta çonte prapë para togës së pushkatimit.

Në një valle burrash ra fjala për një konferencë të "tre të mëdhenjve" të kohës për të vendosur disa piketa për të ardhmen e pasluftës, siç ishte: krijimi i një këshilli administrativ të pesë fuqive të mëdha, ku, përveç Anglisë, Bashkimit Sovjetik dhe SHBA, do të përfshihej edhe Franca me Kinën, me detyrë të paraqiste traktatet e paqes me vendet e mundura; çarmatimin, çmilitarizimin e "denazifikimin" e Gjermanisë; dhënja e kufijve perëndimorë (Oder –Najse) Polonisë; pranimi i vendeve të mundura në OKB etj. Është fjala për Konferencën e Potsdamit, ku u fol edhe për përdorimin e bombës atomike. Në atë valle burrash pikërisht rreth kësaj ngjarjeje po diskutohej. Ishte i pranishëm edhe Xhafer Kaloshi dhe prisnin mendimin e tij. Disa që e dinin se kishte shpëtuar një herë nga litari, i thanë mos të fliste, pr kishte edhe prej atyre që e nxitën.

Xhafer Kaloshi ishte intelektual. Misioni i intelektualit është të përhapë dritë kudo që të jetojë pavarësisht nga pasojat. Ai iu drejtua burrave të pranishëm dhe u tha:

- Ky Traktat ka rëndësinë e vet për një periudhë të shkurtër pas luftës, por duhet të dimë se Fuqitë e Mëdha i mban të bashkuara Gjermania: Sa të bjerë Gjermania, do të fillojnë mosmarrëveshjet midis tyre. Pas lufte do të grinden dhe do të konfrontohen me njëra-tjetrën sa do të fillojë një luftë e re më e egër se e para, sepse midis tyre do të hyjë mosbesimi. Janë shtete me sisteme të ndryshme politike dhe ekonomike. Bashkimi Sovjetik ka komunizmin dhe kolektivizimin që nuk i duron as Amerika, as Evropa. Do të luftojnë për vdekje dy sistemet, kush të fitojë. Do të rrëzohet sistemi i Stalinit se mbështet në egërsinë dhe në kolektivizimin.

Për herë të dytë Xhafer Kaloshi u shau sllavin komunistëve, kësaj herë "Baba Stalinin". Gjer këtu ka ecur kungulli në ujë, i thanë dhe arrestuan përsëri. Tani më askush nuk mund ta mbronte dhe e vunë para togës së pushkatimit dhe e ekzekutuan pa gjyq dhe menjëherë. Ishte pragu i vitit 1945, kur komunistët e kishin fituar Shqipërinë. Njerëz si Xhafer Kaloshi do të pushkatoheshin edhe pa thënë ato fjalë, por të gjithë ruajnë në kujtesë jo thjesht fjalët e tij, por parashikimin gjenial për luftën e ftohtë, për ndarjen e botës në dy kampe, në dy sisteme, kapitalizëm dhe socializëm, që do të luftonin, për gjysmë shekulli, deri në vdekjen e këtij të fundit.

Madje shkencëtarë të ndryshëm edhe hedhjen e bombës atomike në Hiroshima dhe Nagasaki e kanë konsideruar si mjet presioni ndaj Bashkimit Sovjetik. Bleket ka thënë: " Duhet të arrijmë në përfundimin se hedhja e bombës atomike, më shumë se veprimi i fundit ushtarak i Luftës së Dytë Botërore, përfaqëson në realitet operacionin e parë të madh të luftës së ftohtë kundër Bashkimit Sovjetik" 6)

Kjo luftë e ftohtë , më e egër se kudo qe në Shqipëri, në formën e saj më gjithëpërfshirëse, në formën e luftës së klasave.

Referenca:

1) Hasan Riza Pashën "... e vrau ajo politikë që filloi t'i shiste si të kota sakrificat, që nuk ishte për rezistencë deri në fund dhe me çdo çmim..." (Në librin e Novruz Zejnatit: "Esad Toptani, t'i japim gjeneralit atë që i takon", f. 21)

2) Në librin "Ishkodra Mudafaasi" (Mbrojtja e Shkodrës) , të shkruar nga bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë disa kohë mbas vrasjes së Hasan Riza Pashës, thuhet: "Dhjetë ditë para se të mbaronte ushqimi për ushtrinë, për tri ditë me radhë do t'u jepej ushtarëve racioni i plotë e do t'u ngopej barku, të katërtën ditë do të niseshin rrugës në mes të Taraboshit dhe të Bunës në drejtim të Tivarit, drejt limanit të Splitit, territor i Austrisë, 60 kilometra nga Shkodra" " Sado që këto përgatitje ishin mbajtur sekret, në dijeni të tyre ishin edhe të tjerë...Me datë 30 janar në mbrëmje do të shkonte të takonte të dërguarin e arqipeshkvit në shtëpinë e Esad Toptanit, por kjo do të ishte nata e fundit e tij. Kur po kthehej nga shtëpia e Esad Pashës, nga ora 22.00, pak para se të arrinte tek vendkomanda, tre vetë dalin nga errësira dhe e qëllojnë..."(Nga libri i Novruz Zejnatit: "Esad Toptani, t'i japim gjeneralit atë që i përket", f. 17, 19))

3) Janina ra në duart e grekëve me 6 mars 1913, për arsye se shqiptarët ikën nga fronti i luftës, thotë Eqrem bej Vlora. Esad Toptani nuk e braktisi frontin (Nga libri i Novruz Zejnatit: "Esad Toptani, t'i japim gjeneralit atë që i përket", f. 29)

4) Kristo Frashëri: "Lufta e Dibrës", botim M&B, Tiranë 2012, f. 355)

5) "Xhafer Kaloshi ishte gjithashtu një element i dyshimtë politikisht për të cilin duhen marrë masa nga policia"(AQSH, f. 253, viti 1940, dosja 33, fl. 163)

6) Roberto Batalia: "Lufta e Dytë Botërore", Tiranë 1991, f. 417

Rruga e Arbërit nr. 83

portret

Një përshkrim i thjeshtë lidhur me krahinën ku u zhvillua masakra nga osmanllinjtë dhe për komandantin legjendar në krye të trimave, ku luftoi dhe më në fund ra edhe vet heroikisht.

JOVAN NOK TËRSHALLA

Komandanti legjendar që ra heroikisht në masakrën e Çidhnës

Nga **RAMADAN NDREKA**

Çidhna e Epërme dhe Çidhna e Poshtme shtrihen në luginën që formon në perëndim Faqesa dhe Guri i Kuq. Në lindje mali i Tërthores, në jug dy Sinjat, e Epërmja dhe e Poshtmja. Përballë saj, në juglindje, është Gryka e qytetit, në hyrje të saj kur del nga Çidhna është Varri i Jovan Nok Tëshallës, 500 m më poshtë ndodhet Kepi i Skënderbeut. Në veri Çidhna e Epërme kufizohet me Pratin, që e ndan përgjysmë me Dardhën. Që në kohërat më të vjetra se dinastia e Kastriotëve, këto fshatra kanë mbajtur emrin e krahinës Çidhën. Në këto troje ka ekzistuar, deri në vitin 1850, edhe fisi Çidhna, të cilin turqit e detyruan të ndërrojë mbiemrin, duke marrë si mbiemër, emrin e një pinjolli të këtij fisi, për të cilin do të flasim më vonë. Krahina e Çidhnës në Dibër përbëhet prej 10 fshatrash, që janë të shtrira në të dy anët e Drinit të Zi. Çidhna e Epërme dhe Çidhna e Poshtme janë vazhdimi nga ku ka lindur e famshmja Sinjë, e cila njihet sot, si trojet rrënjë të Kastriotëve, dhe kufizohet me Muhurrin dhe Runjën e Selishtës. Edhe Sinja, më vonë, u nda në dy fshatra, Sinja e Epërme dhe Sinja e Poshtme. Kështu, në këtë anë të Drinit Zi u nda në 4 katunde. Sinjë e Epërme, Sinjë e Poshtme, Çidhën e Poshtme dhe Çidhën e Epërme. Më vonë u krijuan edhe fshatra të tjera si rezultat i rritjes popullatës dhe ndarjeve të familjeve të mëdha. Çidhna e Poshtme nuk përmendet fare në materialet që shkruajnë historianët shqiptarë e, megjithatë, ajo qëndron krenare midis atyre dy maleve me emrin e saj të pandryshuar që në kohën e ilirëve, ndërsa Çidhna e Epërme ka ndryshuar emrin dy herë, një herë në kujtim dhe përjetësim të masakrës së Çidhnës që bëri sulltani kundër shqiptarëve, pas vdekjes së Skënderbeut, ku u vranë mijëra luftëtarë, ndër to edhe kryekomandanti që komandoi rezistencën antiosmane, Jovan Nok Tërshalla nga Çidhna e Epërme.

Kur malet e Dibrës u ndeshën me Hajredin Pashën dhe dolën fitimtarë, vendosën që emrin e Çidhnës së Epërme ta ndryshojnë për të përjetësuar heroin e krahinës Jovan Nok Tërshalla, prandaj dhanë emrin, "Gryka Jovan Nok Tërshalla". Me këtë emër Çidhna e Epërme vazhdoi të quhej deri në vitin 1946 e, më vonë, megjithëse Nokajt që në vitet 1930 filluan ta quajnë Gryka e Major Haxhi Nokës, i cili ishte aga dhe mbreti Zog i kishte dhënë gradën major në rezervë, duke i dhënë të drejtë të gjykonte edhe problemet që dilnin në krahinë, bashkë me krerët e Çidhnës.

Pas Luftës Nacionalçlirimtare u bënë zgjedhjet për pushtetin lokal, të cilat shërbyen, pa dashje për ndryshimin e emrit të katundit, Gryka Jovan Nok Tërshalla, kështu pa asnjë vendim. Ju hoq emërtimi dhe u bë Grykë-Nokë, por kjo përsëri u tha në atë kohë, nuk do të thotë Gryka e Nokajve, por Grykë Nokë, ç'ka Nokë është emër në numrin njëjës i një individi dhe jo emër fisi, dhe ky individ është emri i babës së Jovan Tërshallës. Nokajve ky rast u shërbeu të realizonin dhe të maskonin atë që nuk kishin mundur ta realizonin, sepse populli dhe gjithë Çidhna e thirrnin sipas traditës, Gryka e Jovan Nok Tërshallës. Duke vepruar kështu, Nokajt kujtonin se do të rrisnin prestigjin e tyre si agallarë, pa llogaritur se tanimë, në këtë kohë, u kishte ardhur fundi gjithë bejlerëve dhe agallarëve jo vetëm në Çidhën, por edhe në të gjithë Lindjen Evropiane.

Historikisht, Nokajt e Çidhnës së Epërme nuk kanë asnjë lidhje me emrin e Gryk-Nokës, pasi ata kanë ardhur nga Dom-Gjoni i Mirditës si klerik katolik, mbas dekadës së parë të viteve 1800. Shumë kohë para ardhjes së priftit, pinjoll i fisit të Nokajve të Domgjonit në Fanë, Çidhna e Epërme është quajtur Gryka e Jovan Nok Tërshallës. Ata e gjetën fshatin me këtë emër dhe, për të thënë të drejtën, e kanë ngritur lart emrin e këtij heroi, që ka marrë fshati. Në të gjitha meshat dhe deri vonë edhe në festa islame, emri i Jovan Nok Tërshallës është përmendur në hapësirat popullore, larg veshit të turqve, sepse turqit bënin shumë përpjekje për të kthyer priftin për vete, duke i premtuar koncesione të mëdha dhe, së fundi, ia arritën qëllimit, e kthyen priftin mysliman, pastaj me ndihmën e tij, asnjëherë nuk lejuan të thirret fshati me emrin e vet, Çidhën e Epërme ose Gryka e Jovan Nok Tërshallës, por lejuan të përmenden vetëm emrat e lagjeve si pas fiseve. Në këtë mënyrë, presioni vazhdonte jo vetëm kundër atyre që mbanin mbiemrin Çidhna, kryesisht ndaj stërnipit të Gjon Çidhnës, Ndrekës, për të pranuar të ndryshimin e fesë dhe emrat, ndërsa mbiemrat t'i ruanin në fenë që kishin. Të parin thyen priftin, duke i dhënë siguri, se jo vetëm nuk do të humbiste, por do ta rriste ekonominë dhe epërsinë në fshat. Si garanci i dhanë postin e agait, ndërsa stërnipit të Gjon Çidhnës i garantuan se nuk do të goditej më nga turqit, në qoftë se do të rrinte urtë dhe nuk do të përzihej në punët e (hyqimetit) perandorisë, duke i shtuar edhe kushtin tjetër, se në qoftë se do të hiqte dorë edhe nga mbiemri Çidhna, si mbiemër të shërbente emri i Ndrekës.

Ky qe dhe fundi kur kryepleqësia ndërroi vend nga origjina e saj dhe shkoi tek Nokajt, deri në vitin 1946, kohë kjo kur u bënë zgjedhjet për pushtetin vendor në Republikën e Shqipërisë, pas Luftës së Dytë Botërore, duke zëvendësuar atë të zgjedhurin që gjatë luftës si këshilli antifashist nacionalçlirimtar. Kryetar këshilli në atë kohë ishte Hamit Noka, i cili u rizgjodh përsëri. Në fshatin Arras u krijua lokaliteti me kryetar Selman Rusin dhe Liman Gjonin sekretar. Këta ishin të pashkolluar, por kishin zhdukur analfabetizmin dhe ishin më të shkolluar se të tjerët. Favorizim tjetër qe, se kishin qenë edhe partizan, aq më tepër, Selman Rusin e favorizonte se edhe i ati, Sabri Rusi, i cili kishte qenë partizan dhe ishte dëshmor; kishte rënë në Kosovë, duke luftuar kundër gjermanëve.

Të dy këto pushtetarë lokalë, duke u nisur thjesht nga propaganda e Nokajve se na qenkan një fis me Tërshallën, pa asnjë lloj shqetësimi pranuan kërkesën e kryetarit të këshillit që vula e fshatit të jetë: "Këshilli Popullor i Katundit Gryk-Nokë. Emri i katundit të ndahet në dy fjalë me vijë në mes, (Gryk-Nokë)". Kjo kërkesë ndryshonte plotësisht historikun e emrit të katundit, nga Gryka e Jovan Nok Tërshallës, në Gryk-Nokë, dhe zhduku nga faqja e dheut emrin historik me rëndësi kombëtare, Jovan Nok Tërshalla.

Këtë veprim e bëri kryetari i këshillit të katundit, sepse, sipas tij, nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga Gryka e Jovan Nok Tërshallës me Gryk-Nokë. Burrat më të ditur të Çidhnës, të udhëhequr nga historianët popullorë, që njihnin historinë e transmetuar në breza, që nga koha e rënies së Kastriotëve dhe pushtimi turk, siç ishin Ali Isuf Krashi, Brahim Noka, Rushit Hisa, Sadin Tola, Sali Kariçi si edhe sheh Musa i Teqes së Limjanit, imam i katundit u mblodhën menjëherë dhe kundërshtuan ndryshimin e emrit. Ata argumentuan se Tërshallajt nuk kanë lidhje gjaku me fisin Nokaj. Hamit Noka nuk mundi t'u rezistojë argumenteve të krerëve të fiseve të katundit, sepse me to ishte bashkuar edhe Brahim Noka, që ishte një historian i fortë. I kapur ngushtë, ai e mbylli problemin, duke deklaruar "Kaq dij unë, si i pashkollë që jam". Duke kundërshtuar këtë padrejtësi, u vendos që të rikthehej emri i katundit, që e kishte më përpara. Këtë e pranoi edhe kryetari i lokalitetit, Selman Rusi, i cili ishte po nga ky katund dhe premtoi se këtë do ta bënte shumë shpejt. Kjo që ndodhi, ka qenë një lajthitje. Këtë premtim Selman Rusi nuk mundi ta realizojë për dy arsye: e para, se lokaliteti u shkri dhe shkoi në Zall-Dardhë dhe, së dyti, ai pësoi një goditje fatale nga shteti me ekzekutim, që gjithë fshati thoshin hapur se kjo është një enigmë, sepse eprorët e tij u dënuan me burg, kurse vartësit e tyre u dënuan me pushkatim. Kryetari i lokalitetit, Rexhep Troci, e dërgoi kërkesën më lart, por nuk mori përgjigje nga organet eprore. Tentativa e tretë u bë në vitin 1975, për të rimarrë emrin e humbur. Komiteti i Partisë së Punës të rrethit Dibër orientoi ndryshimin e emrit të katundit Grykë-Nokë, por që nuk kishte parasysh kërkesën e bërë nga populli në vitin 1946 dhe kryesia e lokalitetit të Zall-Dardhës. Shumë nga burrat e moshuar që e mbanin mend ndërrimin e emrit dhe vendimin që mori populli, kujtuan se erdhi koha të rregullohej ai gabim i madh, prandaj e propozuan të rikthehej mbiemri Tërshalla, ose të quhej Çidhna Epërme. Këshilltarët e katundit ishin të rinj në moshë dhe nuk ishin marrë me këtë histori; ata njihnin vetëm atë lloj historie që u ishte bërë në 7 vjeçare. Kishin parasysh fisin e Tërshallajve të kohës së tyre, që nuk kishin ndihmuar dhe aq shumë gjatë Luftës NÇL, prandaj shikoheshin me një sy jo të mirë. Kthimi në emrin e parë u dukej atyre që gjykonin shkurt, sikur po rehabilitonte Tërshallajt, prandaj ndërrimi i emrit mori një drejtim tjetër për ta afruar sa më afër emrit më të hershëm, por me devijim nga Çidhna Epërme, për ta bërë Gryk-Çidhën. Këtë kërkesë e përshëndeti edhe këshilli popullor i rrethit Dibër, sepse edhe në këshillin e rrethit kishte, jo vetëm urrejtje për këtë emër, për arsye se, një pjesë e Nokajve kishin qenë bashkëpunëtor me pushtuesit italian dhe gjerman, por edhe pse herë pas here rikujtohej kërkesa e këshillit të frontit demokratik për rikthimin e emrit të katundit Gryk-Nokë në identitet. Në këtë kohë të drejtën e ndërrimit të emrit e kishte vetëm Presidiumi i Kuvendit popullor, prandaj u dërguan atje për t'i miratuar.

Shqyrtimi i kërkesave në Presidiumin e Kuvendit popullor, më përpara se shtroheshin për diskutim, duhej të njiheshin patjetër nga anëtarët e kryesisë. Anëtar i të cilës ishte edhe sekretari i parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës, Enver Hoxha, prandaj ju dhanë edhe atij këto dokumente të ardhura nga Këshilli popullor i rrethit të Dibrës që t'i lexonte dhe të jepte mendim. Pasi i lexoi Enver Hoxha këto dokumente, në pjesën e poshtme anash u bëri një shënim, tekstualisht kështu: "I mjerë është ai popull që nuk njeh vetveten", duke vijuar më tej: "Në Paris kam mësuar në histori masakrën e Çidhnës, që kryekomandanti i rezistencës kundër osmanllinjve ishte Jovan Nok Tërshalla, i cili ra heroikisht për të mos vdekur kurrë. Kjo është Gryka e Jovan Nok Tërshallës dhe jo Gryka e Nokajve të sotëm, që shumica kanë mbështetur fashizmin. - (Ky shënim gjendet në Arkivin e Shtetit së bashku me dokumentet përkatëse). Me të lexuar këtë shënim, administrata e Kuvendit popullor jo vetëm nuk guxoi ta shtrojë më për gjykim, por e arkivuan dhe shënimin e bërë ia kthyen edhe Këshillit popullor të rrethit në atë kohë, duke u kujtuar se ishin keqkuptuar për ndërrimin e emrit të katundit Gryk-Nokë. Askujt më nuk i shkoi ndër mend ta rregullojë këtë gabim, por mbeti si në vitin 1946, por mori trajtën e pandryshueshmërisë.



Çidhna. Foto: © Hajredin Toca

Kjo metamorfozë historike ka futur në harresë shumë ngjarje të rëndësishme që hulumtuesit i kërkojnë gjithandej dhe nuk i gjejnë. Megjithatë, toponimet janë aty në Çidhën e Epërme dhe në Çidhnën e Poshtme, kokëforta, të heshtura, që mbajnë mbi shpatulla shumë ngjarje të rëndësishme të historisë, gjurmët e të cilave ende nuk janë shkatërruar plotësisht. Ka shumë rrënoja, që mbrojnë historinë tonë. Është edhe varri i Jovan Nok Tërshallës mbi kepin e Skënderbeut, afërsisht 500 m, që rrugës para se të futesh në Çidhnën e Poshtme, përballesh me varrin e tij.

Në Çidhnën e Epërme, Gryk-Noka e sotme, në anë të malit, në krye të fshatit janë varret e arrasve, livadhet e arrasve, gjurra e arrasve, për të cilën është munduar të shkruajë profesor Kristo Frashëri, por theksoj se ai shkrim nuk i përket Arrasit të sotëm, i cili është krijuar nga fshatarë që kanë zbritur nga Arrasi i vjetër pas vitit 1800, që deri atëherë ka qenë pjesë e Çidhnës e Epërme. Këtë e vërteton fakti se shumë toka në Arras janë pronë edhe sot e fisit të Ndrekajve dhe të Laçve, dhe fisi i Krashve nga Çidhna e Poshtme, që pothuaj shumica e tyre zbritën në Arrasin e sotëm. Ky botim në gazetën "Mësuesi" në vitin 1974, sidoqoftë ka shërbyer për të nxitur studiuesit që të kërkojnë për më shumë.

Më poshtë këtyre toponimeve janë varrezat e Shën Gjonit. Varri i Gjon Çidhnës, që sipas historianëve të sipërpërmendur, thuhet se ai e ka lënë me amanet të varroset në pikën dominonte, ku të shikojë varret e Sinjës së Epërme, ku është varrosur Rrapushi dhe varret e Pashnjarve, ku është varrosur Konstadini, dy nga djemtë e Gjon Kastriotit. Varrezat e Pashnjarve janë në Çidhnën e Epërme në lagjen e Pashnjarve, e cila ka një varrezë dhe një kishë shumë të vjetër historikisht. Varrezat ku është varros Gjon Çidhna, nga ai moment e deri në sot quhen varret ku është varros Gjon Çidhna, pastaj këto varre dalëngadalë u shejtëruan dhe vet banorët e gjithë krahinës i thirrën "Varrezat e Shëngjonit".

Kisha e Pashnjarve edhe sot ruan pjesë të mozaikut që flet se është e hershme përpara dinastisë së Kastriotëve dhe, me gjithë kërkesat e vazhdueshme për të ardhur arkeologët ta studiojnë, asnjë përpjekje shtetërore nuk është bërë, me gjithse për Gjergj Kastriotin folet e shkruhet pa pushim. Shkojnë e kërkojnë rrënjët e Kastriotëve gjithandej, duke përfshirë edhe zemrën e Stambollit, por nuk bëjnë kërkime aty ku gjejnë me të vërtet rrënjët e tyre. Të pyesin më së paku veten, pse lagjja Pashnjar është në Çidhnën e Epërme dhe asnjë familje nuk e ka këtë mbiemër? Kjo don të thotë se fisi i Pashnjarëve është persekutuar nga turqit, prandaj ka ndrruar troje dhe sot gjendet në Sinjën e Epërme.

Në rajonin që përfshin Sinjën e Epërme, Sinjën e Poshtme, Çidhnën e Poshtme dhe Çidhën e Epërme, gjenden toponimet e 11 kishave që kanë ekzistuar edhe në kohën e Skënderbeut, të cilat i shkatërruan pas pushtimit turqit. Kisha e Pashnjarëve dhe e Sinjës së Epërme ruajnë pozicione të qarta, për të orientuar kërkimet arkeologjike,

(Vijon në faqe 19)

kulturë

(Vijon nga faqja 18)

të tjerat e kanë humbur orientimin, por dihen pika orientuese. Në të dyja kishat që përmendëm, eksplorohet lehtësisht vendi, megjithëse Turqia ka bërë mjaft ndryshime për të humbur gjurmët. Këto kisha, që sot janë rrënoja, gjeografikisht qëndrojnë përballë njëra-tjetrës me fushë të lirë pamje rreth 10 km. Në këtë luginë ka shumë toponime që sqarojnë momente që lidhen me historinë e kombit shqiptar, të cilat osmanllinjtë janë munduar me shumë zell t'i varrosin, këto dëshmi të gjalla historike, me qëllim që çdo gjë të futet në harresë dhe dalëngadalë të vijë koha që Kastriotët të mos kenë origjinë të saktë, fillimisht të mos jenë nga Çidhna, pastaj të mos jenë nga asnjë vend tjetër i Shqipërisë dhe më në fund le të jenë boshnjakë, apo italianë nuk ka më rëndësi. Të zhduken të gjitha gjurmët. Të zhduket edhe rruga që të çon në Çidhnën e Poshtme dhe të Epërme. Të zhduket edhe varri i Jovan Nok Tërshallës, ai varr që qëndron i heshtur mu në anë të rrugës, si edhe vetë historia e masakrës së Çidhnës, që e bënë osmanllinjtë pas vdekjes së Skënderbeut.

Pikërisht këtu, tek ky varr, shikon rrafshinën e Çidhnës së Poshtme dhe rrugën që të çon më tej, për në Çidhnën e Epërme. Për këtë gjen vetëm pak shkrime nga të huajt, të cilët mundohen të bëjnë lidhjen e fshatit Kastriot edhe me Çidhnën e Poshtme, që sot ia kanë hequr prapashtesën – e Poshtme - dhe e kanë lënë vetëm Çidhën. Kjo ka ardhur natyrshëm, sepse edhe emri i Çidhnës së Epërme është zhdukur nga faqja e dheut, për të vazhduar me kohë që të zhdukin edhe emrin e Çidhnës së Poshtme. Çidhna të ngelet vetëm si nocion krahinor, për të veshur me atributet historike të Çidhnës tokat bujqësore që janë në atë anë të Drinit Zi. Nga masakra e Çidhnës e deri në ditët e sotme, direkt dhe indirekt, është luftuar e punuar nga ish pushtuesi për të zhdukur çdo lloj shenje që ndriçon rrënjët historike të Kastriotëve, duke përfshirë dhe krerët që kanë organizuar dhe kanë mbajtur në këmbë rezistencën antiosmane dhe, veçanërisht të shuhet nga faqja e dheut emri i lavdishëm i Jovan Nok Tërshallës.

Lind pyetja: Po garnizoni i vogël i ushtrisë turke që vepronte në këto anë, drejtpërdrejtë, ç'ka bërë për të mbuluar faktet historike, të cilat një pjesë e tyre kanë ngelur vetëm si relikte në gojën e historianëve popullorë të krahinës, siç ishte Gjon Çidhna nga Çidhna e Epërme, i cili thirrej ndryshe edhe Gjoni i shokëve, pjesëmarrës në disa kuvende shqiptare antiosmane, një nga krerët kryesorë për Çidhnën dhe Dibrën.


Emri i tij është zhdukur gjithandej ku kanë pasur mundësi osmanllinjtë. Ky emër ka ngelur pa u shuar vetëm në Arkivin e Venedikut, si nënshkrues kryesor për Dibrën, në një letër që i çon Kuvendi i Dukagjinit me 15 shkurt 1602, si dëshmi e kohës. Lufta për të zhdukur gjithçka që lidhej me historinë kombëtare shqiptare ka vazhduar dhe vazhdon. Kjo luftë nxjerr krye herë pas here, si edhe nxori krye në vitet 1970, kur spiunazhi jugosllav organizoi zhdukjen e varrit të Jovan Nok Tërshallës bashkë me lisin e madh shekullor, tek koka e varrit të tij, që i bënte hije jo vetëm varrit, por edhe udhëtarëve që pushonin atje, i cili ndodhet në grykën e qytetit mbi Kepin e Skënderbeut, afër Fushbanit, me pretekstin se ky na qenka një varr kauri. Kjo luftë u bë më e egër pas viteve 1990, nga spiunazhi jugosllav, duke hedhur parulla se në varrin e Jovan Nok Tërshallës na paska flori, me qëllim që ta shkatërrojnë kërkuesit injorantë të floririt dhe një gjë e tillë ndodhi. Pastaj, thuhet se dikush nga fiset tjera e ribëri përsëri varrin Jovan Nok Tërshallës.

"Fole e nacionalizmit" i Gafur Zotos, një dritare atdhetarizmi

Nga **MEVLUD BUCI**

Kur përfundova së lexuari librin e tretë monografik "Fole e nacionalizmit" të studiuesit virtuoz Gafur Zoto, sinqerisht më rëndoi fort në shpirt e në mendje pesha e detyrimit përpara figurave të shquara kombëtare, të atyre që me pendë, pushkë e gjak çanë në shtigjet e historisë. Gafur Zoto, ish drejtor shkolle e ish drejtor i muzeut historik të Dibrës, sot banues e studiues në Durrës, i ngjan një inxhinieri gjeolog, i cili gjen veçse minerale të çmuara. Puna hulumtuese, sprovat në veprimtari prej studiuesi e historiani të mirëfilltë e të pa lodhur kanë bërë që të na jap botime me vlera të mëdha. Gafuri ka një përvojë të gjatë e të çmuar si mësimdhënës i lëndës së historisë, si drejtor i palodhur i muzeut historik Dibër, ndaj dhe botimet e tij janë me "bukë" me peshë e të arrira në dobi të pasqyrimit të traditave, njohjeve të figurave dhe të epokave të vështira që ka kaluar populli i Dibrës dhe mbarë kombi ynë. Libri i Gafur Zotos "Fole e nacionalizmit" është një punë e madhe studimore dhe na sjell me vërtetësi e fakte të dhëna të pa njohura ma parë, për rolin sa patriotik e atdhetarë të klerikëve të teqes së Zerqanit se siç thotë dhe vetë autori "është një përpjekje modeste për të ndriçuar sado pak figurat atdhetare e klerikale të teqes së Zerqanit. Mustafa Sheh Zerqani me të birin Sulejmanin, dhe nipin Hajredinin përbëjnë një trini burrash elitarë". Ndihmesa e çmuar e klerikëve patriot të teqes së Zerqanit, në harmoni të plotë me ata të Bulqizës, përbëjnë masivin e qëndresës për fatet e atdheut, për flamur e pavarsi. Autori është vërtet kërkues brilant, vëzhgues i hollë , mjeshtër e argumentues i fakteve. Ndonëse flitet për breza atdhetarë klerikë të teqes së Zerqanit, autori në unitet e harmoni me lëvizjet atdhetare të Dibrës e të kombit, pra nëpërmjet librit "Fole e nacionalizmit", plotësohet dhe hapet një dritare e re e atdhetarizmit kombëtarë. Pasqyrim i saktë e argumentues i figurave të teqes së Zerqanit është sinonim i qëndresës kombëtare. "Bëmat atdhetare të klerikëve të teqes së Zerqanit, shkruan autori- i kaluan kufijtë lokalë. Që me filimet e lëvizjes nacionale dha jetën Mustafai me vëllanë Jusufin. Më pas Sulejmani. Sheh Zerqani provoi dy herë internimin në Turqi. Për ta realizimi i idealit kombëtar gjendet në lartësimin e edukimit. Kjo i lidhte ata pazgjidhshmërisht me shtresat e gjëra të popullsisë, por edhe me krerë e prijësa të tjerë të Grykës së Madhe, Bulqizës e gjetkë. Mes tyre një vend të veçantë kishin Fejzë Bulqiza,Dalip Karaj, deri tek më të rinjtë; Sheh Rrahmani, Ymer Pervizi, Destan Puca, Mehmet Duriçi etj". Studiuesi Gafur Zoto na pasqyron figura atdhetarësh të lidhur me diturinë, me jetën, me luftën, me fenë. Klerikët e teqes së Zerqanit qysh nga Sheh Mustafa, Sulejmani e Hajredini na shfaqen edhe si njerëz të dijeve, të lidhur me kohën, me çështjen e zgjimit kombëtarë. Nacionalizmi shqiptar ka dhënë prova nëpër kohëra, nëpër ngjarje ku janë dëshmuar qëndresa për pavarsi e për çështjen e mbrojtjes tërësore të kufijve të atdheut tonë të shtrenjtë.

Libri "Fole e nacionalizmit" na pasqyron atdhetarinë e brezave të klerikëve të teqesë së Zerqanit, por është edhe pasqyrë e vërtetë e nacionalizmit kombëtar, sinonim i vlerave të patriotëve, të cilët kishin si moto parësore: "për atdhe e për fe". Autori i librit ka saktësuar me korrektësi ngjarje, fakte të qëndresës, dokumenta arkivore e mbi të gjitha ka realizuar me qartësi argumenta e analiza ku pasqyrohet shembulli, përvoja dhe rrezatimi i nacionalizmit.Të shkruash për nacionalizmin sot nuk është e lehtë, sepse konceptet bajraktare, dëshmitë e faktet nëpër kohëra dëshmojnë se si ndonëse në pak raste koncepti "nacionalizëm" apo "nacionalist" është keqpërdorur dhe keqpërdoret. Nacionalizmin nuk e çmojnë si rrymë e humanizmit atdhetarë, si front i qëndresës, si lidhje shpirtërore për çështjen mbarë kombëtare. Ajo që gdhend studiuesi e historiani vyrtuoz Gafur Zoto dëshmon se si drita e klerikëve atdhetarë-nacionalistë është drita për çështjen kombëtare. Njerëz të urtisë, të qëndresës, të besimit e të diturisë të tillë ishin dhe mbetën nacionalistët shqiptarë."Klerikët e teqesë së Zerqanit së paku që nga Sheh Mustafa, Sulejmani dhe Hajredini na shfaqen edhe si njerëz të letrave. Korespondenca e tyre është për problemet e kohës dhe si e tillë edhe burimore"- thekson autori. Në libër gjejmë plot fakte, ngjarje, argument, analiza citime të saktësuara e mbi të gjitha një trini trimërore e atdhetare, një trini që u flet brezave të kombit tonë. Autori krahas thellimit mbi studimet e bëra nga Moisi Murra,Bajram Xhafa, Munir Shehu, Adem Bunguri, Destan Rama, Ymer Keta etj, ka ditur të gjurmojë, analizojë dhe saktësojë veprimtarinë atdhetare të klerikëve të teqesë së Zerqanit. Qysh në kreun e parë argumenton gjurmët e familjes Zhalla(Shehu) të Zerqanit, pasqyron mjaft mirë edhe historinë e trevës së Grykës Madhe. "Krahina e Zerqanit,-shkruan autori-ka luajtur një rol të rëndësishëm në periudhat historike. Nga të dhënat burimore dëshmohet se në krahinën e Grykës së Madhe dhe Bulqizës, posaçërisht në Vajkal, Skënderbeu u ndesh me hordhitë osmane" . Studimi i Gafur Zotos sjell të dhëna e argumenta, gjurmime e analiza, referenca të sakta e të shumta.Teqja e Zerqanit, e Dullenjës në Vajkal, me në krye klerikun e mençur, luftëtarin e dëshmorin Baba Fejzë Bulqiza e sheh Zyberin, sheh Rrahmanin dhe teqet e tjera të Bulqizës. Në librin "Fole e nacionalizmit" pasqyrohet në plotësi origjina e familjes Zhalla(Shehu). "Pas largimit nga Valikardha Zhallet u vendosën në të dalë të përroit të Botave, afër fshatit të Zerqanit. Ende sot e kësaj dite aty gjenden rrënoja të vendbanimeve të tyre të hershme....".Në këtë libër del në pah vlera dhe kontributi atdhetar i Mustafa Shehut si frymëzues dhe organizator i luftës së Drinit(1844) kundër ushtrisë së Hajredin Pashës. Në libër pasqyrohet dhe sheh Sula gjatë lëvizjes autonomiste dhe për pavarsi në dhe të huaj. Ky libër është një relike e çmuar për brezat, për studiuesit dhe për lexuesit e çdo lloj moshe. Libri "Fole e nacionalizmit" një dritare e atdhetarizmit kombëtar.



Libri i Gafur Zotos "Fole e nacionalizmit" është një punë e madhe studimore dhe na sjell me vërtetësi e fakte të dhëna të pa njohura ma parë, për rolin sa patriotik e atdhetarë të klerikëve të teqes së Zerqanit se siç thotë dhe vetë autori "është një përpjekje modeste për të ndriçuar sado pak figurat atdhetare e klerikale të teqes së Zerqanit.

Në libër gjejmë plot fakte, ngjarje, argument, analiza citime të saktësuara e mbi të gjitha një trini trimërore e atdhetare, një trini që u flet brezave të kombit tonë.

lerikët e teqes së Zerqanit qysh nga Sheh Mustafa, Sulejmani e Hajredini na shfaqen edhe si njerëz të dijeve, të lidhur me kohën, me çështjen e zgjimit kombëtarë. Nacionalizmi shqiptar ka dhënë prova nëpër kohëra, nëpër ngjarje ku janë dëshmuar qëndresa për pavarsi e për çështjen e mbrojtjes tërësore të kufijve të atdheut tonë të shtrenjtë.

Cikël poetik nga Sakip Cami

PASAPORTA IME

Në duart e mia, gjaku i babait të plagosur
Gjaku i gjyshit të vrarë buzë Drinit,
Në duart e mia, mijëra yje të gjakosur,
Në duart e mia, kënga e tim biri.

Në fletët e saj pranvera,
Në vijat e saj hullitë e tokës
Në kapak si në krye të oxhakut
Shqipëria ime , më e mira e botës.

LINDJA E FOSHNJËS

Dhe tha një shkrep :
Këtu lindi Skënderbeu

Dhe tha një curle :
Këtu mori frymëzim Naimi

Dhe tha një pishë :
Me degëzën time flamurin tundi Ismaili

Dhe djepi tha :
Nga shekulli në shekull do të tund fëmijën

Nga shekulli në shekull
Shqiptarët i lind nga rrënja e vet, liria.

U UL SHQIPJA MBI NJË GUR

U ul shqipja mbi një gur,
Guri ishte larë me gjak.
Pranë tij ishte një trim,
Balli i tij digjte flakë.

U ul shqipja mbi një ballë,
Balli ishte prush i nxehtë.
Dhe e puthi atë me mall,
Siç puth motra vëllanë e vet.

ELEZ ISUFI

Dikush tha për të: gjenerali me shajak
Dikush e quajti harushë mali
Piskama e tij zemrat i ndezi flakë
Ngriti nga varri edhe plakun edhe djalin !

GJYSHJA PEMË

Si përbindësh ra mes halleve tona
Fruthi, tifo dhe murtaja.
Nga frëngjitë e kullave u përhap jehona:
“E hej murtaja !”

Jehona njerëzve u mbeti në buzë
Nuk ishte këngë majekrahu.
Jeta u nguros për një çast
Si shkëmbinjtë e ftohtë ndër mjaja !

Gjyshja ime me emrin Pemë
Ndonëse shtatë fëmijë ia mori murtaja
Qëndroi e patundur si bohemë
Rriti edhe katër të tjerë, male e maja.

DIBRA

Dritare diturie , sofër bujarie
Idhull shqiptarie, shembull urtësie
Bashkë me Kosovën dhe Çamërinë
Rendite hallet për të qarë
Arriti kohë e Arbërisë, gëzohuni !



BALADË PËR HAJRULLA TOLLEN

(Majorit që ra në krye të detyrës,
përballë shovinistëve sllavo-maqedonas)

Ç’është ai në majë të malit ?
Kush e vrau e kush e ndali ?

Askurkush atë s’e ndal
S’ndalet shqipja lart në mal

Syri i tij rreze drite
Pushka e tij gjëmim prite.

Dorë e hasmit, moj e mallkuar
Ti u shofsh siç je shuar

Kali i tij hingëllin
Ulërin e qan si fëmijë.

Shqiponjë e malit seç loton
Mbi pushkën e tij vigjëlon.

EPIKË PËR NËNAT

Nga rrebeshi i kohërave
Kurrë s’e ulët kokën
Nga stuhitë e kohërave
Më fort e deshët tokën

Për ju ishte jeta
Ajo foshnjë në bark
Kur s’patët qumësht
E rritët me gjak.

HOXHË MOGLICA, LUFTËTARI

Moglicë e vogël të dha emrin e saj
Të dha shpirtin dhe emrin e madh
Gollobordë e Dibrës të mëkoi me lirinë
Përëndia të mësoi të duash Shqipërinë.
Profeti Muhamed me fjalët epope:
O njerëz mbi tokë, s’ka fe pa atdhe
Ndaj hoxha predikonte tek njerëzit:
 gërmat e alfabetit janë bekim i Muhametit
Mësoni gjuhën shqipe, mësoni në Shqipëri
Se gjuha është pararendëse e lirisë
Se gjuha është dhuratë e përëndisë
Se gjuha jonë shqipe, e para ndër gjuhët e tjera
Tashmë ka nevojë të shkruhet,
të këndohet si ngahera
Ndaj 500 abetare shqipe i solli
Nga Turqi e largët, nga Stambolli
Në arkat e drurit prej dushku
I transportoi dhe i shpërndau Vasil Pleushku
Dhe në Elbasan dërgoi jo pak, por tetë
Tetë djem të rinj me syrin tek retë
Tetë njerëz të etur për dije
Ata që do të bëheshin arsimtarët e ardhshëm
Ata që do të rrezatonin rreze diturie.
I dashur Luigj*, po të dërgoj tetë
Janë sypetritë, janë atdheu vetë.
I shkruan Gurakuqit, drejtorit të parë
Për dije e shqiptarizëm janë luftëtarë.
Shtëpinë e tij, kullën në Moglicë
E ktheu në fortifikatë-shkollë
Edhe luftohej, edhe mësohej.
Ashtu ish koha, dhe kohës i shkoi pas
Ai që me Abdyl Beun dhe Pashanë Iljas
Ngritën edhe Lidhjen, ngritën dhe kalanë
Ngritën dhe vetëdijën, gatuan lirinë
Thirrën nga Stambolli edhe Ismailë
Ngrije Ismail Bej se jemi me Ty
Jemi me Isanë, jemi me Shqipninë.
Hej Hoxhë Moglica, o dibrani i shekullit
I shekullit të njëzetë, por dhe të 21-të
Burra si ti, zor se nëna lind
Burra si ti, sa shumë i duhen kombit
Burra si ti nuk dalin prej nji shekulli.

KORABI

Kryekështjellë e Shqipërisë
Oxhak trimërie , log burrërie
Rrëzë teje Drini shushurit
A thua janë vëllezër binjakë
Betejë pas beteje fitoret rendit
I qofshim falë, strehës së Përëndisë

DRINI

Desha ta imitoja vrullin e tij
Rrebeshe kaloi e rrebeshe përballon
I ashpër , i bukur , i kristaltë
Nga Driloni në Rozafë
I shtrin krahët dhe dritë lëshon.

SHQIPËRIA

Shqiponja nga flamuri
Hap krahët , fluturon
Qielli e prêt si bijën e tij
I lëshon za bijëve të saj.
Prej fjalës së lirë
Ëngjëjt flenë gjokszbuluar
Rrituni ju, o ëngjëj
I kam falur siguri e ardhmëri
Arbërisë tej e mbanë.

FLAMURI

Fluturo mbi male, shqiponjë e lirë
Liria për ty, ajri që thith
Atdheu yt, Shqipëria e shqiponjave
Mu në mes të saj . krahët i ka shtrirë
Ulur mbi gjak, gjaku të rinon
Rritur mbi plagë, plagët të lartojnë
I thuaj botës mbarë: “Jam Shqipëria”.

histori njerëzore

Besë në ditë të vështira

Nga **SHAQIR SKARRA**

Mëngjesi zbardhi e rrezet e diellit përflakën majë malet. Në fshatin Obok rrallë portë kishte mbetur pa hapur këtë mëngjes korriku të vitit 1950. Abaz Tonuzi, bëri të ngrihej në këmbë por nuk mundi. Plaga e marrë një natë më parë në shpatullën e djathtë i theri deri në kockë. Kufiri nuk ishte shumë larg por e kishte të pa mundur të kalonte ditën sidomos tashmë që ishte dhe i plagosur. U ul me kujdes në një shkëmb aty pranë dhe hodhi vështrimin poshtë fshatrave të Maqellarës. Ja atje në afërsi të Drinit dukej fare qartë Allajbegia (Burimi), vendlindja e tij. Edhe njerëzit e tij do ishin zgjuar dhe sejcili kishte dalë në punë por ata nuk e dinin se Abazi ndodhet i plagosur në fshatin Obok, vetëm pak metra larg shtëpisë së tij. Jo as e dinin dhe as kishin se si ta dinin. Ata Abazin e dinin të arratisur matanë kufirit dhe pikërisht prej tij po vuanin luftën e klasave, një luftë e ashpër kjo që kudo që shkonin shikoheshin me një sy tjetër, si familje armike për sistemin. Familja Tonuzi, një ndër familjet më të mëdha në Allajbegi (Burim), familje fisnike u godit ashpër nga diktatura e proletariatit. Abazit i kishin pushkatuar babën Rexhep Tonuzin dhe vëllanë e tij Njazi Tonuzi. Jo vetëm kaq. i erdhi radha së fundit edhe intelektualit të njohur, ushtarakut me përvojë të gjatë Rruzhdi Tonuzi i cili pasi mbaroi shkëlqyeshëm liceun e Korçës, mbaroi dhe akademinë ushtarake në Itali. Fill pas kthimit nga Italia Rruzhdiu inkuadrohet në formacionet partizane me detyrën komisar brigade ku luftoi në Mal të Zi. Por nuk ishte e thënë që kariera e tij të kishte ngritje. Rruzhdiu ishte nip tek Hysni Dema, ish komandant i xhandarmërisë. Kushëriri tij Shehat Tonuzi ia mbush mendjen të largohet sa ma parë nga forcat partizane dhe në fakt kështu bëri, u largua nga lëvizja nacional-çlirimtare dhe u inkuadrua me forcat e Ballit kombëtar.Në shtator të vitit 1946 arrestohet në Topojan bashkë me Halil Keta,Kadri Kallçishta, Njazi Tonuzi,Zenel Çupi e Ismail Dema dhe pushkatohet pa gjyq. Këto pasoja, vite ma vonë do t'i paguante vëllai i tij Izet Tonuzi i cili ende jeton në fshatin Allajbegi . Pushkatime me gjyq e pa gjyq, dënime e internime për familjen Tonuzi. i dinte të gjitha këto Abazi tek kishte hedhur vështrimin poshtë vendlindjes dhe ndjente njëkohësisht mallë dhe dhembje për të afërmit e tij, se e dinte që u kishte shkaktuar dhembje arratisja e tij. Plaga filloi t'i dhemb e trupi i ishte mpirë sa këmbët nuk i bindeshin. Nuk mund të ecte asnjë hap ma shumë. Me këto kujtime për të afërmit e tij dhe fshatin e lindjes e kishte zënë gjumi në arën me misër. Kur u zgjua nata kishte rënë dhe fshatin e kishte pllakosur heshtja e plotë.Diku diku dëgjohej ndonjë e lehur qeni Abazi e kishte tepër të vështirë të lëvizte . Kishte derdhur shumë gjak nga plaga e marrë në shpatull një natë më parë. Bëri të ngrihej por e kishte të pa mundur. Shpresat i kishte humbur dhe ashtu siç ishte në agoni të plotë shikon një zhurmë dhe një dritë mes arës me misër që vinte drejt tij.Tashmë çdo gjë mori fund, më kapën, mendoi me vehte. Drita dhe zhurma sa vinte dhe afrohej por bashkë me të edhe një brazdë e madhe uji që kalonte në arën më misër.

-Abaz Tonuzi, të njoha,mos u tremb je në besën time- dëgjoj një zë fare pranë. Hapi me vështirësi sytë se nga i erdhi ky zë si i njohur dhe sipër tij me një fener në dorë dhe një shatë në krah pa obokasin Tahir Neziri, i cili ishte bashkë me gruan që kishin ardhur natën të vadisnin arën me misër.Mes dhimbjeve por dhe frikës Abazi bëri të ngrihej në këmbë por ishte i pamundur.Tahiri i dha shatin dhe fenerin gruas dhe e hodhi në shpinë Abazin i cili e kishte lëshuar totalisht veten tashmë. Nuk kishte pikë fuqie që të ecte vetë.Kur arritën në fshat qentë filluan të lehin e dritat e llampave me vajguri të shumtat ishin fikur. Oboku kishte rënë në qetësinë e natës.Vetëm shtëpia e Tahir Nezirit atë natë kishte dritë. Pasi e uli Abazin në një shtarat aty pranë sobës, bashkë me gruan në fillim skuqën në tigan ca vezë dhe ashtu ia vunë në plagë. E kishte dëgjuar nga të moshuarit se veza e skuqur plagës i bën mirë. Abaz Tonuzi më vonë u çlirua dhe kuptoj se kishte rënë në duar tëe sigurta.E njihte mirë Tahir Nezirin por nuk e dinte se është kaq besnik.Tahiri kishte vetëm një vit martesë dhe ende nuk kishte fëmijë.Tek po hanin darkë bashkë me Abazin i thotë gruas:

-Duke filluar që sonte e deri sa të shërohet Abaz Tonuzi do të jetë vëllai i yt. Do t'i shërbesh sikur të kishe vëllanë tënd të plagosur në shtëpi. Në këtë dhomë që po rrimë sonte bashkë nuk do futet askush. Edhe njerëzit e tu kur të vijnë do të futen në dhomën tjetër.Tahiri po i jepte këshilla gruas e Abazi tashmë edhe i ngopur por dhe i mjekuar e këputi një gjumë aty pranë sobës së zjarrit .Tahir Neziri njihej në fshat si njeri i qetë, puntor e bujar, njeri që dhe me pushtetin e kishte mirë.Të gjithë e respektonin Tahirin se ai ua imponte respektin me sjelljet e vyrtytet e mira që kishte. Askush nga pushteti nuk besonte se Tahir Neziri strehonte Abaz Tonuzin në shtëpi i cili kërkohej e ndiqej nga sigurimi si njeri me rrezikshmëri të madhe për shoqërinë dhe atdheun. Ditën vazhdonte punë rregullisht .Merrte pjesë në të gjitha aktivitet që zhvilloheshin në fshat dhe në darkë kthehej në shtëpi e bisedonte shtruar me Abazin. Kështu kaluan ditët dhe netët në shtëpinë e vogël të Tahir Nezirit. Abaz Tonuzi kaloi një muaj në këtë shtëpi dhe pas një muaj e mori vehten mirë sa që një ditë i lutet Tahirit t'i jap leje për të ikur. Një natë kur hëngrën darkë të gjithë tok si gjithmonë, Tahiri mori kalin e vuri Abazin në kalë dhe të dy bashkë iu ngjitën kufrit përpjetë. Kishin kaluar më shumë se pesëqind metra nga kufri shqiptar kur Tahiri ndalon e përqafon Abaz Tonuzin dhe i uron udhë të mbarë e fat në jetë. Kaluan më shumë se dyzet vjet.Tahiri vite më vonë kur shtëpinë e tij e kishte mbushur me fëmijë vdiq dhe sekretin e atij muaji që strehoi Abaz Tonuzin e mori me vehte në varr. Nuk i tregoi askujt, as Izet Tonuzit që takoheshin shpesh në qendër të Maqellarës. Vdiq me një peng të madh në zemër.Nuk mundi të takohej dhe njëherë të vetme me Abaz Tonuzin. Ngjarjet rrodhën krejt ndryshe . Pas viteve nëntëdhjet, Abaz Tonuzi tashmë i plakur ndoshta dhe para kohe pas një mërgimi të gjatë larg vendlindjes në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kthehet në atdhe. i pari që e priti në Rinas ishte Izet Tonuzi, i cili kishte vuajtur jo pak pas arratisjes së tyre. Një takim mbresëlënës pas një ndarje të gjatë, lot malli dhe gëzimi u derdhën atë ditë në Rinas.Të dy ishin mplakur si Abazi ashtu dhe Izeti, të dy kishin se çfarë t'i thonin njëri tjetrit pas një ndarje të gjatë gadi dyzet vjeçare. Kur makina arriti në Maqellarë dhe do të kthente për në Allajbegi , Abazi ia bëri me shenjë që të ngjiteshin më sipër.

-Do të shkojmë të pimë një kafe në Obok, i thotë Izetit, do të shkojmë ta pi kafen e parë tek familja e Tahir Nezirit.Kam qëndruar një muaj në atë familje i plagosur, më kanë mbajtur dhe mjekuar, më kanë shërbyer dhe më kanë dashur si njeri të familjes.Ju nuk e keni ditur se unë jam në Obok.Nuk mund t'ia harroi nderin dhe respektin që më kanë bërë në ato ditë familja e Tahir Nezirit. Në



Abaz dhe Izet Tonuzi

fakt kjo ishte diçka krejt e pa pritur për Izet Tonuzin.Kishte pirë kafe e bërë muhabet, kishte qëndruar në dasma e vdekje bashkë me Tahir Nezirin për dyzet vjet dhe këtë nuk e kishte marrë vesh se tek kjo shtëpi kishte qenë strehuar Abazi. Kishte kohë që Tahiri kishte vdekur, në shtëpi kishte lënë vetëm gruan me fëmijët tashmë të rritur.

-Do të shkojmë në Obok, kjo ishte fjala e Abazit, fjalë disi urdhëruese.E shikoi se je në mëndyshje.Ska gjë unë i kam marrë masat vetë për këtë vizitë surprizë që do t'i bëj kësaj familje.

-Po Tahiri nuk jeton, ka më shumë se dy tre vjet që ka vdekur.Në shtëpi ka lënë vetëm gruan me fëmijët – foli Izeti.

Abazi derdhi lot kur mori vesh se njeriu më i mirë që i kishte shpëtuar jetën para dyzet vjetëve nuk jetonte më. Fshiu lotët dhe ia bëri me shenjë shoferit të drejtoheshin për sipër. Në Obok shtëpia e Tahirit binte në sy.Një shtëpi ndryshe nga të tjerat, e thjeshtë, e vjetër. Izetin si bashkëfshatar e njohën edhe fëmijët edhe gruaja e Tahirit, Abazin nuk e njohu askush.F ëmijët jo e jo pasi ato në ato vite nuk kishin lindur por as gruaja jo.

-Më njeh mua, iu kthye Abazi?

- Jo, nuk kam se si të njoh, hera e parë shkel në shtëpinë time, ia ktheu gruaja e Tahirit.

-Kanë kaluar shumë vite që atëherë por kujto një natë korriku në arën me misër kur vadisje bashkë me Tahirin.

Për momentin ajo shtangu, pa edhe njëherë nga Abazi, fërkoi sytë dhe sakaq iu hodh në krah.

-Po tashmë të njoha.Ti je Abaz Tonuzi. Të kam thënë vëlla ato ditë e si vëlla të kam shërbyer por prapë unë vëlla të kam.Një skenë prekëse, të dy derdhën lot.Ishin lot gëzimi por Abazi qau më shumë se një mik i mirë, një njeri që i kishte shpëtuar jetën i kishte vdekur pa u parë më.

-Unë jam kthyer nga Amerika pas një mërgimi të gjatë.kafen e parë po e pi në shtëpinë tënde. Ende nuk kam vajtur në Allajbegi, dhe mbi tavolinë nxori një kuletë.

-Këto janë për ty dhe fëmijët e tu, me këto do të ndërtosh një shtëpi të re, të bukur, të kompletuar që kur të kthehem vitin tjetër tek motra ime në Obok të gjej një shtëpi më të bukur në të gjithë fshatin.Gruaja e mplakur qau përsëri.

-Janë pak këto, foli Abazi, jeta ime atëherë që ma shpëtove bashkë me Tahir Nezirin vlente më shumë. Nga ju e kam jetën sot. Unë gruaja dhe fëmijët e mi për ju do mbetemi borxhli gjithmonë. Pas dite vonë të dy bashkë Abazi dhe Izeti ranë në Allajbegi por ngjarja tashmë mori dhenë e sekreti i mbajtur peng për dyzet vjet doli sheshit. Besa dhe buajria e Tahir Nezirit i dha vlera më të mëdha të gjithë Maqellarës dhe pikërisht në ato vite të vështira.

JEPET ME QIRA

mjedis **300 m2,** pranë Kombinatit të Autotraktorëve.

E përshtatshme për çdo lloj aktiviteti. Lartësia e katit 5 m. Mjedis edhe për zyra! Linjë trefazore elektrike në dispozicion!

Rruga e shtruar me asfalt!

Të interesuarit të komunikojnë me tel: **069 20 68 603**

E deshti kombin më shumë se jetën

Nga **REXHEP TORTE**

Në organizim të Shoqatës së ish të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politik Shqiptar në Dibër, të hënën më 11 mars 2013, në kujtim të ditës së fillimit të demonstratave të studentëve në Prishtinë, në Qendrën për Kulturë në Dibër, në praninë e ish të burgosurve, dbranëve dhe mysafirëve nga Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria, u mbajt akademi përkujtimore me rastin e gjashtëvjetorit të vdekjes tragjike të ish të burgosurit politik dhe atdhetarit Petrit Bomova.

SHPËTIM POLLOZHANI, kryetar i SHBPPSH, me këtë rast tha se, " Vepra dhe kujtimi për Petritin bashkëjeton me ne. Petritin me shokët e Dibrës për herë të parë e takova në kazamatin e Idrizovës. Ishte shumë i qetë në sjellje por temperament në veprime , promotor i të gjithë aktiviteteve tona në burg, nismëtar dhe përkrahës i një qëndrmi më se stoik i të gjithë të burgosurve politik shqiptar. Ishte pjesë e strategjisë për injorim të drejtoris dhe të sigurimit të burgut dhe kundërshtar që asnjë i burgosur politik të mos bëjë ankesë ose lutje për ulje të dënimit. Ishte përkrahës i nismës tonë që të gjitha mjetet dhe ushqimet ti ndajmë në mënyrë të barabartë. Të kultivojmë dhe ruajmë moralin e të burgosurve politik. Ishte nismëtar i aktivitetit që të burgosurit të mos heqin kapelën dhe të mos çohen në këmbë kur pran tyre kalonin zyrtarë të burgut edhe pse drejtoria praktikonte dënime drakonike për ata që nuk e respektonin rendin shtëpiak të burgut.

Pas daljes nga burgu Petriti vazhdoi aktivitetet kombëtare në grumbullimin e ndihmave për vëllezërit kosovarë. i dhimbeshin puntorët e krahut nga Shqipëria të cilët vinin dhe punonin për të siguruar bukën e gojës. Ishte nismëtar dhe veprimtar për organizimin e një akademie përkujtimore për Nexhat Agollin duke grumbulluar edhe shumë materiale të cilat u shfrytëzuan për hartimin e një monografie. Më 28 nëntor 2001 dha propozim që në bulevardin e Dibrës të valviten 100 flamuj kombëtar shqiptar. Me nismën e Petrit Bomovës shoqata e të burgosurve politik shqiptar në vitin 2000 organizoi akademi përkujtimore për Xhafer Kodrën , si dhe grumbullimin e nënshkrimeve në Dibër për pavarsinë e Kosovës. Petriti thoshte " Duhet pa ndërprerë të shpohet ujku me shtiza në rast se jo nga plumbi do të ngordhë nga gjakderdhja ". Në organizim të shoqatës sonë dhe me angazhim të pakursyer të Petritit në vitin 2001 organizuam disa manifestime në shenjë përkujtimi të demonstratave të viti 1981 ku Petriti ishte pjesmarrës dhe ishte objekt i survejimit të shërbimeve sekrete. Ishte aktivist edhe për grumbullimin e mjeteve për vendosjen e shtatores së Skënderbeut në sheshin e Dibrës. Ishte nismëtar dhe realizues edhe në sttrehimin mjekimin dhe përcjelljen e luftëtarëve të palgosur të UÇK – së në vitin 2001 për në Shqipëri. Petriti ishte një model i sakrificës dhe i atdhedashurisë. Nuk kërkoi as edhe më të paktin shpërblim për atë që bëri për kombin. ", tha fund Shpëtim Pollozhani.

KASTRIOT HAXHIREXHA, ish i burgosur, veprimtar dhe shok i ngushtë i Petrit Bomovës, theksoi se, " Që në vitet e para të shkollës së mesme Petriti u kyç në lëvizjet revolucionare ilegale të asaj kohe që u kundërviheshin politikave shtypëse Jugosllave ndaj shqiptarëve – dhe proklamonin kërkesat për bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në ish Jugosllavi në një Republikë të vetme të Kosovës. Shtypja dhe padrejtsitë e regjimit sllavokomunist



dhe shpirti liridashë dhe guximtar i tij bënë që në janar të vitit 1976 të mbush korridoret e Gjimnazit të Dibrës ku mësonte me parulla revolucionare , akt që i tërboi agjentët e UDB – së e KOS-it, me çrast arrestohet duke pranua vetë se e ka bëë këtë akt për t'I shpëtuar shokët tjerë nga torturat policore. Dijti tu përballojë kërcënimeve , torturave dhe shantazheve si atdhetar i pamposhtur. Veprimtaria patriotike e Petritit nuk ndaloi por u intestifikua kur ai me shokët e tij studentë në Universitetin e Prshtinës Muharrem Dovolani dhe Bashkim Mashkulli kyçet në lëvizjet ilegale dhe furnizohet me materiale patriotke dhe liridashëse që vinin nga vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka, të cilat ua shpërndante shokëve dhe bashkëqytetarëve. Petriti u regjistrua në Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Prishtinë. ku u përfshi në lëvizjet revolucionare të asaj kohe duke krijuar lidhje të forta me grupin e Podujevës përmes Fehmi Berishës , prof Ramadan Bajrami , Arsim Sejdiu etj., si dhe me grupin e Deçanit përmes Naim Haradinajt dhe babait të tij. Më 11 mars 1981 në Pranverën Kosovare shpërtheu revolta shqiptare, që shënoi kthesën e ndarjes definitive të shqiptarëve të robëruar në ish Jugosllavi. Në shpirtin dhe zemrën e Petritit dhe të shokëve të tij kjo që po ndodhte ishte një mrekulli e cila çonte drejt lirisë dhe bashkimit kombëtar. Në këto demonstrata Petriti mori pjesë aktive duke u angazhuar edhe për fillimin e revoltës në Dibër. Pas kësaj Petriti arrestohet bashkë me shumë aktivistë të grupeve ilegale të Podujevës dhe Deçanit. Gjatë tërë kohës që kaloi në qelitë e burgjeve hetuese Petriti qëndroi i vendosur dhe i pathyeshëm, përkundrejt torturave dhe malltretimit nga ana e milicëve dhe agjentëve sllavë, duke mos nxjerrë asnjë nformatë për shokët e tij dhe mënyrën e organizimit ilegal. Ai dënohet 7 vjet burg të rëndë që i kaloi në burgjet e Tetovës , Shutkës dhe Idrizovës. Ishte përkrahës i pakursyer i Lëvizjes për çlirim dhe bashkim kombëtar. Pas daljes nga burgu ai vazhdoi veprimtarinë atdhetare duke mbajtur lidhje të ngushta me shokët e idealeve nga Shkupi , Kumanova , Tetova , Kërçova e Struga, me të cilët u njoh në burg.

I pakursyer dhe i palodhshëm Petriti u tregua edhe për luftën e Kosovës, ku ai shtëpinë e tij e bëri strehë të ngrohtë për shumë pjestarë dhe udhëheqës të UÇK-së sa herë që ata kalonin kufirin , por edhe si depo për shumë materiale që vinin nga Shqipëria në rrugë ilegale. Ndihmonte edhe në transportin dhe kalimin ilegal të shokëve të tij të idelait nga dy anët e kufirit. Petrit dha kontribut dhe ndihmë të pamohueshme edhe në luftën që zhvilloi populli shqiptar në 2001 në Maqedoni. Petriti në kujtimet tona do të mbetet gjithmonë luftëtar i paepur i lirisë dhe bashkimit kombëtar , simboli më i mirë i atdhetarit që e jetoi jetën denjësisht dhe u bë shembull dhe udhërrëfyes për brezat e rinj se si duhet luftuar dhe sakrifukuar për atdheun. Zoti ju dhashtë një shok siç e kisha unë Petritin. ", u shpreh Kastriot Haxhirexha.

TAHIR HANI, ish i burgosur dhe veprimtar, para të pranishëmve, u shpreh se,

"Unë dhe shokët e mij , fëmijët e mij dhe fëmijët e shokëve të mij dhe fëmjët e Petritit do të jemi krenarë dhe do të përcjellim krenarinë ndër breza se patëm një shok ideali dhe një prind siç ishte Petriti , njeriun e idealeve, njeriun e përkushtuar për të sakrifikuar jetën për çështjen kombëtare shqiptare. Në takime të këtilla kujtojmë rrugëtimin tonë të përbashkët në të bërit e historisë kombëtare në ditët më të vështira të totalitarizmit jugosllav me një sistem represiv ndaj shqiptarëve. Është kënaqësi e veçantë që në emër të shokëve përkujtojmë momentet më të lumtura , bashkëbisedimet, ëndrat tona për një Shqipëri siç e kanë dashur ndër breza , ndër luftëra , vuajtje dhe sakrifica shqiptarët atdhe dashës. Petriti ishte atdhetar i urtë , që jetën e çmoi më pak se lirinë , se dhimbjet ishin më të vogla se vuajtjet e popullit nën robëri , se ëndrrën e kishim të përbashkët për lirinë. Petriti ishte sinonim i një brezi dhe i një kohe të vështirë por krenare. Në vitet e 80-ta studentët shqiptarë në përgjithësi dhe ato dibranë në veçanti shkonin nga tre muaj verës për të punuar jashtë. Në vitin 1979-80 Muharrem Dovolani me shokët dibran gjatë qëndrimit në Gjermani bie në kontakt me Jusuf Gërvallën, ideologun E Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe themeluesin e Organizatës Fronti i Kuq Populllor. Studentët Kastriot Haxhirexha , Petrit Bomova , Bashkim Mashkulli dhe Qazim Qormemeti bashkëveprojnë me veprimtarin Fehmi Berisha dhe Ramadan Dibranin , antarë të grupi të Podujevës. Nga Gjermania sjellnin gazetat ilegale "Bashkimi", " Liria" dhe "Lajmëtari i Lirisë" dhe së bashku edhe me grupin e Pejës vepronin duke përdorur metodën e treshit. Në korrik të viti 1981 fillojnë arrestimet të antarëve të Lëvizjes Ilegale Dibrane, të cilët u përballën me ashpërsinë e pushtetit jugosllav. Kastriot Haxhirexha dënohet me 8 vjet burg, Petrit Bomova me 7 , BAshkim Mashkulli me 6 , Qazim Qormemti me 5 dhe Muharrem Dovolani me 4 vjet burg. Unë gjithmonë kam në kujtesë kontaktin tim të parë me të burgosurit politik shqiptarë në burgun e Idrizovës, takim që më dha moral dhe forcë të pathyeshme të atdhetarëve. Ata më pritën krahëhapur dhe më pranuan në familjen e përbashkët që kishin organizuar në burg. Të burgosurit nga Dibra kishin qëndrim të pathyeshëm përballonin me moral të lartë dhe dinjitet edhe ndëshkimet më të rënda nga udhëheqësia e burgut në qelit e vetmis , sepse qelitë e vetmisë ishin në katin më të lartë dhe se mund të shikoje vetëm sorrat. Në këto takime kujtojmë atdhetarët që vijuan rrugën e rilindasve tanë më vonë me luftërat çlirimtare të Kosovës , UÇPMB-së dhe në fund ushtria çlirimtare kombëtare duke krjuar realtitete të reja për shqiptarët që ishin nën thundërën e ish Jugosllavisë. Brezave që vinë pas u mbetet detyrë të kujtojnë faqet e ndritura të historisë dhe të protagonistëve të tyre.

" Petritin e njoha në burgun e Idrizovës. Ishte patriot i vërtetë , i qetë dhe dashamirës. Përpiqej që jeta jonë në burg të jetë solidare kishte moral të lartë për veprimtarinë kombëtare në kuadër të grupit të Dibrës duke qenë optimist dhe i pathyeshëm i bindur se lufta e shqiptarëve për një realitet të ri të jetës së tyre në trojet shekullore do të ngadhënjejë. Vitet e burgut kaluan dhe shokët e idealeve gjithmonë janë në ballë të proceseve të mbrojtejes së interesave kombëtare. Hallet dhe vështirësit e jetës i kishte edhe Petrit për të siguruar kushte më të mira për fëmijët dhe familjen. Kjo e shtyri Petritn për të udhëtuar në SHBA, në këtë udhëtim pa kthim që ndërpreu jetën e tij për fëmijët , familjen dhe shokët. Por jeta e Petritit mbetet udhërrëfim për brezat që vijnë. ", tha Tahir Hani.

MAZLLUM LLESHI, drejtor i NKP "Standard" në Dibër, ku Petriti punoi m tha se, " Ndjej pë obligim që me këtë rast të flas për personalitetin e Petritit s i punësuar në mesin e kolektivit tonë, i cili la kujtime dhe mbresa të paharruhara në mendjet dhe zemrat e çdo të punësuari praë kësaj ndërmarrje. Qëndrimi i tj korrekt dhe professional në zbatimin e detyravë tq punës ishte shembull poztiv dhe mobilizues për të tjerët për të punuar me devotshmëri për të mirën e ndërmarrjes, tonë. Ky angazhim i Petritit në kryerjen sa më efikase të të detyrave të punës ndjehej edhe në në qëndrimin e marrëdhënieve korrekte dhe të ngrohta që krijonte me qytetarët, gjë që pasqyrohej me rezultatet maksimale që arrinte në punën e tj.. Puna e tij në dorëzimin dhe realizimin e faturave për shërbimet tona ndaj qytetarëve ishte e një rëndësie të madhe për grumbullimin e të ardhurave për mbarëvajtjen e punës së ndërmarrjes sonë.

Vdekja tragjike e të ndjerit Petrit Bomova i pikëlloi të gjithë të punësuarit në kolektivin tonë , i cili pas këtij momenti tragjik i ndenji afër dhe e ndihmoi familjen e tij. i përjetshëm qoftë kujtimi i tj, dhe do të mbetet i paharruar dhe shëmbull pozititv për çdo të punësuar në kolektivin tonë. Për tërë konreibutin e të ndjert Petrit gjatë tërë jetës së tj lusim Zotin ee madhërishëm atë ta ketë pranuar në Parajsë.". u shpreh Mazllum Lleshi.

XHEVAT ADEMI, ish i burgosur dhe veprimtar, duke fplur për personalitetin e Petrit Bomovës, shtoi se, "Jeta e Petritit është shumë më e madhe se sa u shpalos këtu. Dhe nuk kishte si të ishte ndryshe, sepse ai ishte i gatshëm të sakrifikohet në çdo kohë, dhe sado që t'i kërkojë njeri fjalët nuk ka si të shpreh shpirtin e madh luftarak të Petritit dhe shpirtin e madh të tj , për të cilin folën Shpëtimi, Kastrioti, Tahiri. Të gjithë e dijmë se çfarë ka bërë Petriti për nënën e vet, se sa Petrit Bomova është kujdesur për nënën e vet. Unë për herë të parë Petritin e kam takuar në burgun e Idrizovës, në kampin ku ishin madhorët dhe të miturit.Pastaj e kam takuar Petritin në shtëpinë time kur ishte zgjuar herët sepse duhej të ishte herët përpara ambasadës së SHBA-ve për të aplikuar për vizë.I ishte bërë fiskim për të vajtur atje , dhe populli ka të drejtë kur thotë exheli të pret, të kërkon. Asaj here Petriti nuk mori vizë. Duke shpejtuar kishte harruar një paketë cigare dhe një shkrepëse. Jeta ka qenë e pamëshirshme për ne shokët e Petritit dhe për Petritin. Ajo gjeneratë jetën e ka jetuar vertikalisht në sytë e Shpëtimit, Kastriotit e të tjerëve. Shumë shkurt me Petritin isha në Idrizovë. Në burgun në Pozharevc u takova me shokë të tjerë që me krenari më flisnin për Petritin, prandaj ndihem keq sepse Petriti na mungon, na mungon të gjithë neve. Është një fjalë goje të thuash se Petriti dha gjithçka për popullin e vet, dhe unë jam dëshmitar jo vetëm të plagosurit, luftëtarët e parë të Ushtrisë

homazh

Çlirimtare të Kosovës që kanë kaluar kufirin Shqipëri -Maqedoni i ka pritë e i ka përcjellë Petriti. Unë jam dëshmitar sepse mua mi ka dorëzuar. Fjalët janë të pafuqishme, andaj më lejoni të gjitha ato që nuk mundem t'i them për Petritin t'i mirëkuptojmë. Lavdi Petritit dhe respekte për familjen", shtoi Xhevat Ademi.



YLLNDRIT BOMOVA, djal i Petritit, duke përshëndetur të pranishmit , deklaroi se, "

'Të nderuar të pranishëm, miq dhe bashkëpuntorë të babait tim. Ju falenderoj përulësisht në emër të familjes, për mbështetjen dhe kurajon e jashtëzakonshme që na jepni. Fjalët tuaja ishin prekëse dhe më ndihmuat të mësoja të vërteta , ngjarje e histori që ndoshta edhe nuk i dija. Në këto 6 vite kemi patur ndihmë morale të shumkujt nga ju , dorën mbi shpatull apo bisedat shpresëdhënëse. Unë , vëllau im dhe nëna jonë do të mbajmë mend deri në fund nderin që na keni bërë nga dita e parë e deri më sot. jam i lumtur teksa shoh që shumë nga idealet prej të cilave babai im vuajti janë të jetësuara dhe frytet e saj mund ti shijoj edhe unë , biri i tij, por edhe pse ndoshta nuk jamë njeriu më i përshtatshëm , do të doja të ndaja me ju disa mesazhe të ndjera. Përvjetorët janë momente shumë të rëndësishme dhe janë sa një kohë për të parë pas , aq edhe një kohë për të parë përpara. Ka diçka edhe më të madhe se kjo , se tërësia e pamjeve dhe e kujtimeve që vijnë deri te ne përmes imazheve ose mbresave të shkruara. Kjo është forca e idealizimit që brezi i ri e përceptojmë nga ju paraardhësit tanë. Forca e idealizmit të një grushti njerzish , siç ishte brezi i juaj , që në kohra shumë të vështira , dhe ende më të vështra për tu imagjinuar sa të vështira ishin , morën në sy një rrezik që ne sot nuk jemi në gjendje ta kuptojmë se sa i madh ishte. Vunë "bast " gjithëçka , jetën e tyre , pasurinë e tyre , familjen , për një ëndërr. Ju bashkë me tim atë zgjodhët të përfshiheni që ta sfidoni realitetin që thoshte " Ska asnjë shans, asnjë mundësi që gjërat të ndryshojnë " , arritët ti ndryshoni gjërat. Unë shpreh një dëshirë zemre , që e ardhmja e ime apo e bashkëmoshatarëve të mij , t'i ngjaj idealeve të rinis së babait tim , e jo idealeve të rrejshme të fundit të jetës së tij , idealet të cilat u modifikuan nga ndërtimi i të ardhmes në tokën tënde , tek hedhja e syve matan oqeanit , për të nisur një rrugë pakthim , ashtu siç shumë dibranë vazhdojnë ta marrin , vazhdimisht e çdo ditë , sepse varfëria , papunësia i detyron me dhunë për të marrë një hap të këtillë. Ky qytet do të jetë këtu edhe kur ne mos jemi më këtu. Por sa kohë ne jemi këtu , kemi jo vetëm të drejtën po edhe detyrimin të kemi ëndrrat tona dhe të luftojmë për ëndrrat tona , indivualisht dhe sëbashku në mënyrë që atyre që vijnë pas t'u lëmë një të ardhme më të mirë se ky realitet që kemi , ashtu siç ata që erdhën para nesh na lanë një gjendje më të mirë se ajo që gjetën.

Ju falemnderoj edhe njëherë personalisht secilit dhe në mënyrë figurative ju shtrëngoj dorën në shenjë respekti", u shpreh. Yllndriti.

Gjatë kësaj aksdemie përkujtimore nxënës të gjimnazit recituan poezi shkruar nga Ukshin Hoti.

Me rastin e 35-vjetorit të vdekjes

Në kujtim të Llukmanit

Ditën e paraqitjes në punë më 18 Gusht 1973 në Shkollën e Mesme të Bulqizës morëm njoftim për një mbledhjë në kinemanë e qytetit. Të nesërmen bashkë me kolegët zumë vend në rradhët e para të sallës. Në presidium erdhën drejtuesit e qytetit midis tyre edhe drejtori i minierës në ato vite Todo Manço. U fol për problemet e Bulqizës, pa harruar ato të edukimit të fëmijëve. Për sjelljet dhe përparimin e nxënësve në shkollë të merret shembull nga qytetarët si: Llukmani, Hamit Koçi, Ferit Alla, Imer Stojku etj. Kurioziteti ynë për të ditur se kush është Llukmani u zgjidh shpejt sepse i madh e i vogël, Bulqiza me këtë emër njihte Shaqir Canin, shofer në Ndërmarrjen Gjeologjike. Nga Anglishtja Llukman (njeri krijues) por që shqiptarët e trajtojnë edhe si njeri me zemër të madhe, bujar e human. Kjo lidhej edhe me një koeçidencë tjetër, Shaqiri ishte njohur gjatë luftës me një doktor në Dibër të Madhe i quajtur Llukan. Ai bënte shërbime të shumta, ishte i papërtuar njeri me zemër të gjerë e humane që i kish lënë shumë mbresa e kujtime Shaqirit aq sa shpesh kishte dëshirë të bëhej si doktori dhe thoshte: "Jam Llukman"!

Shumë njerëz në veprimtarinë e tyre humane dhe njerëzore bëjnë emër e marrin pseudonime që i shoqërojnë gjatë gjithë jetës. Për të arritur këtë duhet shumë mund, djersë, sakrifica e angazhime shoqërore e qytetare. Për Shaqir Canin ja vlen të shpjegohemi:

Lindi më 1919 në Sofraçan në një familje patriote të Grykës së Madhe. Gjyshi i tij Jakup Cani kish dhënë një kontribut të çmuar në luftën për pavarësi e shkollë shqipe në Grykën e madhe, Grykën e Vogël e më gjërë në Maqedoni e Kosovë. Bshkëluftëtar i Mersim Demës, Sul Shehut, Ramiz Dacit, Mehmet Duriqit, Ramiz Dibrës, Halit Lleshit, Aqif Lleshit etj. Pjesëmarrës në shumë tubime e takime të krerëve të kryengritjeve shqiptare me autoritetet Turke (shpesh here edhe si përkthyes), Jakup Cani njihej në rrethet patriotike edhe si Jakup Sofraçani. Babai, Sulejmani, mori pjesë në luftë për ruajtjen e tërësisë territorial shqiptare kundër serbëve në mbrojtje të Qeverisë së S. Delvinës, në Lan Lurë krahas Elez Isufit. (1921) Shkollën fillore e kreu pranë miqëve të familjes së Demajve në Homesh për të vazhduar Internatin e Kastriotit dhe dy klasë në Normalen e Elbasanit (1934 – 1935). Si një i ri me një zhvillim të mirë fizik zgjidhet për të vazhduar shkollën e aviatorëve në Milano të Italisë. Pas mbarimit të kursit të shoferave (detyrim nga ana e shkollës) krahas studimeve për pilot, një aksident gjatë hedhjes me parachute, doli i paaftë për të vazhduar pregatitjen për aviator. Megjithatë mësoi gjuhen italiane, njohu mënyrën e jetesës europiane pas krizës Botërore të vitit 1933. U kthye në Atdhe, i cili rënkonte nën zgjedhën italiane si rezultat i pushtimit të Shqipërisë më 7 Prill 1939. Më 1941 u punësua si shofer në kuesturën e Dibrës së Madhe, pa shkëputur lidhjet me drejtuesit e Lëvizjes Nacional Çlirimtare në Dibër si: Haxhi Lleshi, Sulejman Baholli, Jashar Mezelnxhiu, Eshref Palikuqi etj.

Kuestura Mbretnore e Tiranës më 15.08.1943 do të vlerësonte si "shumë të rrezikshëm Shaqir Canin, Rakip Lamin e Esat Sinanin si personel të Kuesturës së Dibrës, sepse u bëjnë përkrahje njerëzve të çetës së Haxhi Lleshit, Nexhat Agollit, Nexhmedin Shehut etj që kanë organizuar Partinë Komuniste në Dibër" (arkivi i MPB dosje Nr 169). Ishin këto arsyet që e detyruan Shaqirin të largohej nga kuestura dhe të kaloj në ilegalitet në malet e Dibrës.

Në Korrik 1944 u vra nga gjermanët xhaxhai, Ramadan Cani, u dogj i gjithë fshati duke përfshirë edhe shtëpinë e Shaqirit e cila një fat të tillë e kishte pësuar edhe nga turqit, serbët, austriakkët dhe së fundi gjermanët. Në vjeshtën e këtij viti u martua me Dane Kasem Gjokën nga Peladhia. Si një heroinë e vërtet përkrah Shaqirit ajo do të përballonte fortunat e luftës dhe vështirësi të tjera pas çlirimit për rritjen e fëmijëve dhe rimëkëmbjen ekonomike të familjes.

Në vitin 1945 filloi punë në Parkun e Durrësit por shpejt dhe pa dëshirën e tij u transferua në Sarandë, gjatë një shërbimi për në Konispol një difekt i makinës e çoi Shaqirin në pranga me akuzën "Sabotim me dashje" (31.08.1946). Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës më 6.11.1946 i jep dënimin me vdekje. Pas një ankimi në Gjykatën e Lartë ajo i fal jetën dhe i ul dënimin me 15 vjet heqje lirie (Vendim Nr 170, datë 13.11.1946), humbjen e të drejtave civile dhe konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Llukmani kishte një karakter të fortë, asnjeherë nuk u ligështua në burg edhe pse u dënua me vdekje. Kadri Demiri ish bashkëvuajtës me Shaqirin në burgun e Gjirokastrës në kujtimet e tij thotë se: ishte gjithnjë optimist e iu jepte shokëve kurajo në ato kushtë mjaft të vështira të mungesës së lirisë. Burgu i Gjirokastrës ashtu si dhe ai i Burrelit kishte hyrë në memorjen e popullit si një burg i vështirë dhe më pasoja për jetën e njeriut. Në Prill 1949 del nga burgu dhe vjen në fshat në një gjëndje të rënduar shëndetësorë që iu dëshën disa vite për ta marrë veten.

Shaqir Cani ishte ndër shoferët e vjetër të Dibrës, si profesionist e njeri i besuar, punoi disa vite në administratën e re të porsa krijuar të Peshkopisë (qendër e Rrethit Dibër) 1954 – 1957 për tu sistemuar përfundimisht në Ndërmarrjen Gjelogjike të Bulqizës më 1958. Në Ndërmarrjen e Gjeologjisë Shaqir Cani ishte ndër më të dalluarit. Ajo nga një kantier i vogël u shndërrua në një ndërmarrje të madhe me shumë punëtor, personel inxhiniero teknik, fronte të reja pune etj. Së bashku me Met Jakupin, Ahmet Lazrin, Luan Çorlazen e Hysen Koçin furnizuan pikat e Gjeologjisë në gjithë malet e Dibrës nga Lura në Martanesh, Maja e Lepurit, Balgjaj e deri në Korab. Kudo dhe kurdoherë në kohë me diell shi e borë ishte i gatshëm të çaj akullin e acarin për të furnizuar më mjetet e domosdoshme për punë e jetesë ekipet Gjeologjike të ndërmarrjes. Çdo kapje e re (minerali) prej sondave që punonin në vendburimin e Bulqizës ishte festë për të gjithë qytetarët e saj. Siç na pohon gjeologu i vjetër Nexhat Lami, pas festës pranë sondave ajo transferohej në



familjet tona në qytet. Ishin këto njerëz të mirë e mjeshtra të zot që i kthenin ngjarje të tilla metë vërtetë emocionuese dhe me mbresa të forta. Bulqiza ishte nje familje e madhe, preokupacionet që kishte një qytetar, banor ose jo i Buqlizës, ishte problem i të gjithëve. Kjo lidhet me dashurinë, respektin, ndjenjën e solidaritetit, unitetin vëllazëror që kishin ata njerëz bujar e me zemër të madhe. Këto tradita për fat të mirë i gjejmë të shfaqen edhe sot në mes të atyre njerëzve të lodhur, të vuajtur por krenar, me shpirt të pastër e të sinqert. Në këtë ambient të ngrohtë u rritën dhe krijuan familje lindën e rritën fëmijët shumë Llukman sikurse njihej dhe Shaqir Cani, Bujar Pata, Nazmi Përkola, Selim Marku, Ramiz Gjoka, Skënder Sharku, Fadil Alliu etj. Ata ishin të rinjë kur lindi qyteti. U rritën bashkë më të, u bënë familje të mëdha. Kështu Shaqiri sëbashku me Danen lindën e rritën 9 fëmijë, me sjelljen e tyre lanë mbresa shumë të mira duke gëzuar respekt nga i gjithë qyteti minator. Rezultatet që arritën në shkolla përbënin një motiv tjetër për tu admiruar, ata u bënë inxhinierë, ekonomistë, mësues duke shërbyer në mjaft qytete e rrethe të Shqipërsë.

Kjo i jepte kënaqësi dhe energji Shaqir Canit. Llukmani ishte energjik e impulsiv. Nuk pajtohej me padrejtësinë, shpeshherë revoltohej, por edhe "rebelohej". Rebelimet nuk i shkaktonin zarare Shaqirit sepse autoritetet lokale njihnin temperamentin, shpirtgjerësinë e mbi të gjitha ndershmërinë e karakterin e tij.

Ishte njeri me vullnet, kërkonte të përmirësonte jetën jo vetëm në familjen e tij por edhe në qytet. Përqafonte të renë falë edhe kulturës që mori në një moshë të re në Europën Perëndimore.

Me pasion diskutonte me njerëzit, kishte dëshirë të nxisë e inkurajojë pasionin për punën, profesionin, dashurinë për fshatin, njerëzit dhe mjedisin që e rrethonte.

Shokët, miqtë, bashkëqytetarët krenoheshin me Llukmanin. Ndarja prej tij, 35 vjet më parë (23 Shkurt 1978) në një moshë relativisht të re, ishte një humbje e një njeriu me vlera të dashur e të respektuar. Është mirë që brezi i ri ti njohë vlerat e këtyre njerëzve që nuk janë pak. Sa më shumë Llukman, aq më shumë gëzim e lumturi në familje e shoqëri.

Zabit Lleshi

Tiranë më, 20.02.2013

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >



Bashkim Rama
BALLKANI PAS RËNIES SË MURIT TË BERLINIT – VETËVENDOSJA "VERSUS" TËRËSIA TERRITORIALE
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-03-7
Çmimi: 1250 lekë

...Sot rajoni ka arsye të njohura për të tejkaluar stereotipat historikë të fenomenit të ndërlikuar të "ballkanizimit" dhe të bëhet pjesë e integruar e kontinentit europian. Padyshim, tashmë BE-ja ka marrë përsipër përgjegjësinë për stabilizimin e situatës në rajon, d.m.th. sigurinë e tij dhe modernizimin e thellë politik, ekonomik dhe social. Por, për të fituar një "shans" të tillë, është e nevojshme të kërkosh, para së gjithash, zgjidhje kompromisi në drejtim të kapërcimit të konflikteve ndëretnike, të arrish demokraci të brendshme, prosperitet ekonomik e kulturor, të pranosh në nivel të ndërgjegjes shoqërore tolerancën karakteristike të popujve modernë të Europës...

Shumë nga problemet e sotme të ndërlikuara të rajonit të mbipopulluar të Ballkanit mbartin karakter objektiv. Në Ballkan, prej kohësh, kryqëzohen dhe bashkëjetojnë ortodoksia, katolicizmi dhe islami, duke gjeneruar, herë pas here, konflikte të ashpra fetare. Harta etnike e Ballkanit është e pakrahasueshme me ndonjë rajon tjetër të Europës, për nga larmia e prezencës etnike, rrjedhojë e migrimit masiv të grupeve të shumëllojta etnike përgjatë dy mijëvjeçarëve të fundit.

Duke qenë, për një kohë tepër të gjatë, nën sundimin e perandorive osmane e austro-hungareze dhe nën trysninë e vazhdueshme të politikave agresive të perandorisë ruse, popujt e gadishullit të Ballkanit u formuan nën ndikimin e kushteve natyrore-ekonomike, historike e kulturoro-politike kundërthënëse.

Gjatë shekullit XX në Ballkan ndodhën përplasje të fuqishme, të lindura nga civilizimet dhe ideologjitë politike të fashizmit, të komunizmit dhe të nacionalizmit, gjë që e fuqizoi akoma më shumë potencialin konfliktual të rajonit.

Në këtë mënyrë, pjesa më e madhe e problemeve dhe e shqetësimeve aktuale të rajonit, si dhe karakteri i tyre, i kanë rrënjët tek e kaluara. Formësimi i multietnicitetit të ndërlikuar historik, krijimi i vonuar i kombeve e i shteteve, ndryshimi i shumëhershëm, me forcë, i kufijve, lufta e gjatë kundër shteteve pushtuese dhe, si rrjedhojë e gjithë këtyre arsyeve - prapambetja e stërzgjatur ekonomike – qëndron në bazë të tyre.

Ndryshime radikale në raportin e forcave në Ballkan solli përmbysja e regjimeve autoritariste e totalitare në Rumani, Bullgari e Shqipëri dhe hyrja e këtyre vendeve në bashkëpunim me grupimet euroatlantike.

Megjithatë, në vitet '90 të shekullit të kaluar, rajoni ra në një depresion të thellë, duke u tensionuar nga një "hark" i ri destabilizimi, si rezultat i rënies dhe fragmentarizimit të Jugosllavisë dhe i shpërthimit të një vargu konfliktesh të armatosura, në territorin e saj, që do të thotë dhe në hapësirën e gadishullit.

Në kufirin e mijëvjeçarit të ri, rajoni filloi, dalëngadalë, t'i kthehet normalitetit dhe të shkëputet përfundimisht nga e kaluara, duke hyrë në rrugën e re, të integrimit euroatlantik të Ballkanit.




Prof. Dr. Bashkim Rama është Rektor i Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, Profesor i Shkencave Politike, i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, i Teorisë e Praktikës Diplomatike, i Studimeve të Sigurisë, pranë Universitetit të Tiranës dhe në disa Universitete të tjera të vendit dhe Rajonit.

Ka mbaruar studimet pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, ku ka vijuar studimet pasuniversitare për Filozofi. Ka mbaruar Kursin e Diplomacisë. Ka përfunduar jashtë shtetit studimet "Master" për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci ku ka mbrojtur gradën Doktor i Shkencave (PhD) për "Diplomaci dhe Siguri".

Është diplomat karriere dhe ka punuar për më shumë se dy dekada në Shërbimin e jashtëm të Shqipërisë, ku ka kryer disa detyra dhe misione diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme; Sekretar i Parë i Ambasadës së Shqipërisë në Berlin; i Ngarkuar me Punë a.i. i Shqipërisë në Sofje; Ambasador i Shqipërisë në Bullgari, si dhe Ambasador i Shqipërisë në Kosovë.

Është autor i artikujve, librave dhe teksteve për marrëdhëniet ndërkombëtare, diplomacinë dhe sigurinë, të botuara brenda dhe jashtë vendit.



Këto libra mund t'i gjeni pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.

Librin HISTORIA E DIBRËs të Kristo Frashërit mund ta gjeni:

Në PESHKOPI: **Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.**

Në DIBËR TË MADHE: **Rexhep Torte. e-mail <diars@t-home.mk>**

Në DURRËS: **Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353**

Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603 / 068 65 08 441 / 067 30 73 265
***E-mail*: <mbbotime@gmail.com>**

cyan magenta yellow black